



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 433 Akti**

**Nr. 546 Vendimi**  
**Tiranë, më 30.6.2022**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

|                           |                 |
|---------------------------|-----------------|
| <b>Lulzim Hamitaj</b>     | <b>Kryesues</b> |
| <b>Genta Tafa (Bungo)</b> | <b>Relatore</b> |
| <b>Suela Zhegu</b>        | <b>Anëtare</b>  |

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 27.6.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Arben Sharra**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

**1.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për

disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**2.** Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Sharra, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**3.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Arben Sharra do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Alma Faskaj. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).

**4.** Në mbledhjen e datës 19.12.2019 u caktua me mirëkuptim kryesues z. Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Arben Sharra.

**5.** Me vendimin nr. 11, datë 10.5.2022, të Komisionit u vendos zëvendësimi i komisioneres Alma Faskaj, për shkak të mungesës për arsye shëndetësore. Me anë të shortit, anëtar zëvendësues u zgjodh komisionere Suela Zhegu, e cila deklaroi menjëherë mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin.

**6.** Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Arben Sharra nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

**7.** Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

**8.** Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**9.** Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**10.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

**11.** Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Arben Sharra. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

a) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.9.2018.

- b) *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**12.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, ka dërguar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, raportin<sup>2</sup> e vlerësimit të figurës.

**13.** Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**14.** Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: të vlerësimit të pasurisë; të kontrollit të figurës; dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

**15.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 20.5.2022 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit Arben Sharra, si dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

**16.** Subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike të datës 23.5.2022 mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni.

**17.** Subjekti, në datën 6.6.2022, paraqiti kërkesën për zgjatjen e afatit për dorëzimin e shpjegimeve dhe provave në lidhje me rezultatin e hetimeve paraprake për shkak të pamundësisë objektive për sigurimin e tyre, për një periudhë 2-javore. Komisioni miratoi kërkesën e subjektit, duke shtyrë afatin e dorëzimit të shpjegimeve dhe provave deri më 13.6.2022.

**18.** Subjekti ka depozituar provat dhe shpjegimet e tij në datën 13.6.2022, nëpërmjet postës elektronike, si dhe në datën 14.6.2022 i ka depozituar pranë zyrës së protokollit të institucionit.

**19.** Pas administrimit të parashtrimeve të subjektit, provave dhe dokumentacionit, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

**20.** Subjekti i rivlerësimit, pas dërgimit të njoftimit për seancë dëgjimore në datën 14.6.2022, paraqiti kërkesën për shtyrjen e seancës për arsye shëndetësore, duke depozituar edhe raport për paaftësi në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi, për periudhën 13.6.2022 – 27.6.2022.

**21.** Komisioni pranoi kërkesën për shtyrjen e seancës, duke e njoftuar subjektin se seanca e radhës do të zhvillohej në datën 27.6.2022 dhe se subjekti duhet të merrte masa për praninë e tij ose të një përfaqësuesi të caktuar prej tij.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**22.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail* në datën 14.6.2022.

<sup>2</sup> Deklasifikuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.5.2021, të KDZH-së.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2021.

23. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 27.6.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

24. Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Sharra, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

### III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

25. Në vlerësimin e përgjithshëm, Komisioni konstaton se z. Arben Sharra nuk ka qenë plotësisht bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Ai është përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, por përgjigjet e tij nuk kanë qenë të plota për sa i përket një banese të ndodhur në Njësinë Administrative Shëngjergj, e cila ndodhet ngjitur me tokat bujqësore në posedim të subjektit dhe të përfutur prej tij dhe familjarëve nëpërmjet ligjit nr. 7501, “Për tokën”. Subjekti ka tentuar të paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri, si dhe nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit foto të pamjes së brendshme dhe të jashtme të ndërtimeve që ndodhen përreth banesës apo foto panoramike të të gjithë pasurisë, ku të dilnin qartë të gjitha ndërtimet nga jashtë dhe pozicionimi i tyre me rrugën, duke u bërë pengesë për Komisionin për një vlerësim të gjendjes faktike të banesës dhe tokës bujqësore përreth saj në posedim të subjektit. Trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti ka pasur për qëllim që procesi i kontrollit të verifikimit të pasurisë, të prodhonte një rezultat në favor të tij. Kjo mungesë bashkëpunimi, për të cilën është kryer një vlerësim i posaçëm në vijim, e ka vendosur Komisionin në kushtet e pamundësisë për kryerjen e plotë dhe të detajuar të procesit të rivlerësimit.

### IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

26. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

27. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>4</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

28. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e)

---

<sup>4</sup> “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i papabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; si dhe (g) shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura gjatë seancës dëgjimore.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**29.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se posedojnë këto pasuri:

**30. Shtëpi banimi**<sup>5</sup>, kati i parë, me sipërfaqe 134.5 m<sup>2</sup>, kati i dytë + papafingo është pronë e babait të subjektit, për të cilën ka bërë deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 3.12.2009, dorëzuar në Drejtorinë e ALUIZNI-t me nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2009. Bërë marrëveshje verbale për shitjen e shtëpisë me shtetasin I.L në vitin 2014. Pjesa takuese: 100%.

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** kati i parë dhuruar nga babai me kontratën nr. \*\*\*, datë 8.1.1997, në K-K, Tiranë.

### **Konstatimi i ILDKPKI-së:**

- a) Fshehje nga ana e subjektit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005 e kërkesës për legalizim në K-K, rrjedhimisht, edhe e investimit të kryer në banesën e dhuruar nga babai në vitin 1997. Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në vitin 2003 është deklaruar dhurimi nga babai i banesës me sip. 90 m<sup>2</sup>, e përbërë nga katër dhoma, e cila ka qenë e regjistruar që në atë vit në ZVRPP, ndërsa referuar ALUIZNI-t është bërë legalizimi i një banese me dy kate + papafingo me sipërfaqe totale ndërtimi 364 m<sup>2</sup>.
- b) Fshehje e vlerës së investuar dhe mungesë burimesh të ligjshme financiare për ndërtimin e godinës me dy kate + papafingo në K-K, si dhe mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me shpenzimet e ndërtimit.
- c) Mosdeklarim në deklaratën e interesave private të vitit 2009 të kërkesës së paraqitur pranë ALUIZNI-t për legalizimin e katit të parë të banesës në K-K në emër të tij dhe të katit të dytë + papafingo në emër të babait. Në përfundim të marrjes së lejes së legalizimit dhe të regjistrimit në ZVRPP, kjo kërkesë nuk është reflektuar.
- d) Deklarim i rremë nga ana e subjektit në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë 2015, sa i përket banesës në K-K, pasi subjekti ka deklaruar regjistrimin në ZVRPP të katit të parë, dhuruar nga babai në vitin 1997, ndërsa referuar certifikatës së pronësisë dhe kartelës së pasurisë së vitit 2015 në pronësi të z. Arben Sharra është regjistruar gjithë godina me sipërfaqe totale ndërtimi 364 m<sup>2</sup> dhe truall me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup>.
- e) Sipas ZVRPP-së Tiranë, në qershor të vitit 2017 është shitur godina dy kate + papafingo me sipërfaqe totale ndërtimit 364 m<sup>2</sup> dhe truall me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup> kundrejt çmimit 150.000 euro. Referuar kontratës së shitjes, paraqitur në ZVRPP-në Tiranë, shuma 50.000 euro është marrë paradhënie në vitet 2014 dhe 2015, shuma 25.000 euro do të kalojë në llogari të subjektit Arben Sharra dhe 75.000 euro do të kalojnë në llogarinë e nënës së subjektit H. Sh, e cila ka një pjesë të pronës.

### **Hetimi<sup>6</sup> dhe analiza financiaro-juridike e kryer nga Komisioni**

<sup>5</sup> Subjekti ka depozituar: kontratë dhurimi nr. \*\*\*, datë 8.1.1997; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 3.12.2009; certifikatë për vërtetim pronësie; si dhe kartelë pasurie.

<sup>6</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.01.2020, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2020, e ASHK-së Tirana Rurale 1; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2020, e ASHK-së Tirana Veri; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2021, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2021, e ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2021, e ASHK-së Tirana Veri; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2021, drejtuar ASHK-së Tirana Veri;

**31.** Subjekti i rivlerësimit, me kontratë dhurimi nr. \*\*\*, datë 8.1.1997, ka përfituar nga babai i tij një shtëpi të ndodhur në K-K, e përbërë nga katër dhoma. Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, babai i subjektit, në datën 12.6.1996 ka paraqitur kërkesë pranë kësaj gjykate, me objekt “vërtetim fakti të pronësisë së banesës të ndërtuar prej tij që para 5 vjetësh në Njësinë Administrative Nr. \*\*\*”. Në këtë kërkesë babai i subjektit deklaroi se banon prej 6 vjetësh në Njësinë Administrative Nr. \*\*. Për nevoja strehimi, në pamundësi për t’u strehuar nga organet kompetente shtetërore, ka ndërtuar në vitin 1990 një banesë të përbërë nga katër dhoma dhe korridor, me shpenzimet e tij.

Në datën 21.6.1996, me vendimin nr. \*\*\*, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, sipas objektit më lart.

**32.** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se banesa përbëhet nga 2 kate + papafingo dhe ai është pronar i katit të parë.

**33.** ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Veri ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen e plotë të legalizimit të kësaj banesë, nga ku rezultojnë se:

- i. Subjekti, në datën 23.3.2005, ka plotësuar vetëdeklarimin për legalizim, protokolluar me nr. \*\*\* prot., duke deklaruar ndërtimin e një objekti informal të ndërtuar mbi fabrikën e tullave nr. \* në afërsi të repartit ushtarak, me sipërfaqe ndërtimi 130 m<sup>2</sup>, i përbërë nga 3 kate mbi tokë. Data e ndërtimit është deklaruar 25.10.1990.
- ii. Bazuar në procesverbalin për verifikimin në terren të të dhënave të ndërtimit pa leje/shtesës në ndërtim me leje rezultojnë se sipërfaqja e bazës së banesës është 107.6 m<sup>2</sup>, numri i kateve 3, sipërfaqja që shfrytëzohet për banim 364 m<sup>2</sup> e ndarë në kate: kati përdhës ka sipërfaqe 134.5 m<sup>2</sup> (sipërfaqe ndërtimi 107.6 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe verande 26.9 m<sup>2</sup>); kati i parë ka sipërfaqe 134.5 m<sup>2</sup>; dhe kati i dytë ka sipërfaqe 95 m<sup>2</sup>.
- iii. Subjekti, në datën 14.11.2014, ka paraqitur një kërkesë pranë ALUIZNI-t, ku ka deklaruar: “Në zbatim të kërkesave të ligjit për legalizimin e banesave informale me datë 23.5.2005 kam bërë vetëdeklarimin për legalizimin e banesës time... Unë kërkoj spostimin fizik të parcelës në anën lindore në një sipërfaqe prej 100 m<sup>2</sup>, duke ruajtur sipërfaqen e parcelës ndërtimore të miratuar prej 500 m<sup>2</sup> me VKM-në nr. 1038, datë 14.10.2009, ku sipërfaqja pranë banesës në këtë anë posedohet nga ana ime...”.
- iv. Në datën 1.7.2015 subjekti ka lidhur me ALUIZNI-n kontratën nr. \*\*\* “kalim të pronësisë së parcelës ndërtimore”, nëpërmjet së cilës i ka kaluar në pronësi parcela ndërtimore me sip. 500 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, ndodhur në z. k. \*\*\*.

Çmimi i shitjes është 860.000 lekë, ku 500.000 lekë janë paguar me bono privatizimi sipas mandatit të datës 1.7.2015, të “Credins Bank” dhe 360.000 lekë është paguar me mandatin e datës 1.7.2015 të kësaj banke. Këto pagesa janë kryer nga subjekti i rivlerësimit.

Subjekti nuk rezultojnë të ketë deklaruar në deklaratën *Vetting* faktin se i ka kaluar në pronësi parcela ndërtimore me sip. 500 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, ndodhur në z. k. \*\*\*, në të cilën është ndërtuar banesa e legalizuar, por ka deklaruar vetëm pronësinë mbi katin e parë të saj.

- v. Në datë 3.7.2015 është lëshuar leja e legalizimit nr. \*\*\* në emër të subjektit të rivlerësimit, e cila ka shërbyer për regjistrimin e pasurisë në ZVRPP-në Tiranë.
- vi. Bazuar në kartelën e pasurisë rezultojnë se subjekti është pronar i vetëm i pasurisë së llojit “truall” me sip. 500 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, nga të cilat 107.6 m<sup>2</sup> është ndërtesë. Te përshkrimi i veçantë është

---

shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2021, e ASHK-së Tirana Veri; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” sh.a.; shkresë kthim përgjigjeje nr. K-\*\*\* prot., datë 3.2.2020, e UKT-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2020, e OSHEE-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2021, drejtuar OSHEE-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2021, e OSHEE-së.

shënimi “godinë banimi 3 kate, kati përdhes 107.6 m<sup>2</sup> dhe 26.9 m<sup>2</sup> verandë, kati i parë 134.5 m<sup>2</sup>, kati i dytë 95 m<sup>2</sup>, sipërfaqe totale ndërtimi 364 m<sup>2</sup>”.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka ndjekur të gjitha procedurat për legalizimin dhe regjistrimin e pasurisë në emër të tij, si dhe është pronari i vetëm i saj.

**34.** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.10.2021<sup>7</sup>, në lidhje me këtë konstatim, ka sqaruar se për sa i përket aplikimit pranë ALUIZNI-t të bërë prej tij, ai ka aplikuar vetëm për pjesën që i është dhuruar nga babai, ku në vetëdeklarimin për legalizim ka cituar sipërfaqen 130 m<sup>2</sup> dhe nuk ka cituar sipërfaqen e gjithë objektit.

Subjekti ka pretenduar se në datën 31.5.2010 ka depozituar në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Tiranë një kërkesë, duke i shprehur, ndër të tjera, se me deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.12.2009, ka deklaruar se është plotësisht dakord që legalizimi i katit të parë të godinës dykatëshe + papafingo të bëhet në emrin e tij, ndërsa kati i dytë + papafingo të bëhet në emër të babait të tij S. Sh. Por edhe pas deklaratës dhe kërkesës të depozituar, ALUIZNI ka legalizuar objektin në emrin e tij, ku, referuar lejes së legalizimit, ka dalë edhe certifikata e pronësisë në emër të tij.

**35.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar nga ana e tij, konstaton se ato nuk përputhen me hetimin e kryer, pasi rezulton se pronar i vetëm i banesës 2 kate + papafingo është subjekti i rivlerësimit, i cili e ka fituar pronësinë mbi këtë pasuri në datën 3.7.2015 nëpërmjet lejes së legalizimit nr. \*\*\*. Në këto kushte, subjekti kishte detyrimin ligjor për të deklaruar në deklaratën *Vetting* se ishte pronar i vetëm i kësaj pasurie.

**36.** Nga verifikimi i deklarimeve periodike rezulton se subjekti këtë pasuri e ka deklaruar si më poshtë vijon:

- Në DPV/2003 subjekti ka deklaruar shtëpi private me sip. 90 m<sup>2</sup>. Pjesa takuese: 17%. Burimi: dhuruar nga babai.
- Në DPV/2015 subjekti ka deklaruar: (a) shtëpi banimi në K-K, dhuruar nga babai, pjesa takuese kati i parë; (b) pagesë për legalizimin e banesës në K-K.

Për sa më sipër konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar në të gjitha deklaratat periodike faktin se ka aplikuar për legalizimin e një banesë 2 kate + papafingo, si dhe nuk ka deklaruar në DPV/2015 pronësinë e tij mbi këtë banesë dhe të truallit me sip. 500 m<sup>2</sup>.

**37.** Në lidhje me ndërtimin e kësaj banese dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave, subjekti ka sqaruar se<sup>8</sup> banesa është ndërtuar në periudha të ndryshme, duke filluar nga viti 1990 e në vazhdim. Ai nuk disponon dokument provues për shkak se në atë kohë ka qenë nxënës në shkollë të mesme dhe nuk është marrë me ndërtimin e saj, si dhe nuk ka dijeni për koston totale të shpenzimeve. Burimi i të ardhurave<sup>9</sup> për ndërtimin e kësaj banese nga babai i tij i ndjerë kanë qenë kursimet gjatë jetës dhe të ardhurat e nënës nga: puna; toka bujqësore, ku nëna ka paguar edhe kontributet e sigurimeve shoqërore si bujk privat; pemëtaria; blegtoria; bletaria; si dhe një pjesë nga trashëgimia e lënë pas vdekjes nga familja e tij.

**38.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, ka kryer një analizë të plotë financiare për këtë banesë, duke e konsideruar babain e tij si person tjetër i lidhur, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për sa i përket kontributit të tij financiar në ndërtimin kësaj banese.

<sup>7</sup> Subjekti, së bashku me pyetësorin, ka depozituar: deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 3.12.2009 (e cila ka një shënim prot. \*\*\*/10.12.2009); kërkesë datë 21.5.2010, ku ka kërkuar që legalizimi të bëhet në emër të tij dhe të babait sipas pjesëve të shprehura në deklaratën noteriale.

<sup>8</sup> Pyetësori i datës 7.10.2021.

<sup>9</sup> Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacionin e mëposhtëm: vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2021, lëshuar nga DRSSH-ja Tiranë, sipas së cilit znj. H. Sh trajtohet me pension pleqërie duke filluar nga data 3.7.1994; vërtetim datë 15.6.1994, nga Komuna Shëngjergj, sipas së cilit znj. H.Sh ka paguar kontribute të sigurimeve shoqërore si bujk privat për periudhën 1.1.1993 – 31.12.1993 në shumën 1.620 lekë dhe për periudhën 1.1.1994 – 10.6.1994 në shumën 823 lekë; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2021, lëshuar nga DRSSH-ja Tiranë, sipas së cilit z. S.Sh trajtohet me pension pleqërie, duke filluar nga data 7.9.1989 – 30.11.2016.

39. Duke qenë se subjekti nuk ka saktësuar kohën e ndërtimit të banesës, Komisioni iu referua ortofotove dixhitale të administruar nga ASIG për llogaritjen e vlerës së kësaj banese, si vijon:

- a. Në vitin 1994 kati i parë i shtëpisë nuk ka qenë ende i ndërtuar dhe si vit i përfundimit të ndërtimit për këtë kat do të merret viti 1996, kohë kur është paraqitur kërkesa në gjykatë nga babait i subjektit për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë të banesës.

Ky konstatim përforcohet duke marrë në konsideratë edhe faktet e mëposhtme:

- Babai i subjektit ka paguar rregullisht deri në vitin 1995 pranë arkës së Komunës Shëngjergj detyrimin për energjinë elektrike, provuar me librezën e energjisë elektrike të depozituar nga subjekti së bashku me pyetësozin e datës 13.1.2022.
  - Njësia Bashkiake<sup>10</sup> Nr. \* ka informuar se referuar regj. \*\*\* z. Arben Sharra është vendosur në këtë regjistër nga Zyra e Gjendjes Civile Vërrri, Tiranë (e cila mbulonte edhe fshatin Shëngjin) në shkurt të vitit 1995 dhe është larguar nga ky regjistër me transkriptim në Njësinë Bashkiake Nr. \*, regj. Q. G nr. \*\*\*, datë 17.5.2004.
  - Njësia Bashkiake<sup>11</sup> Nr. \* ka informuar se z. S.Sh është vendosur në këtë njësi në datën 18.10.1993 nga Zyra e Gjendjes Civile Vërrri, Tiranë.
- b. Përfundimi i ndërtimit të dy kateve të tjera në vitin 1999.

40. Për llogaritjen e vlerës së ndërtimit të kësaj banese, Komisioni do t'u referohet çmimeve të përcaktuara nga Enti Kombëtar i Banesave për vitet 1996 dhe 1999, duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar dhe dokumentuar vlerën totale të ndërtimit.

41. Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave, Komisioni do të përfshijë në analizë financiare vetëm të ardhurat e nënës dhe babait të subjektit, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Për sa i përket pretendimit të subjektit se si burim kanë shërbyer: (i) një pjesë e të ardhurave të nënës së tij nga toka bujqësore; si dhe (ii) një pjesë nga trashëgimia e lënë pas vdekjes nga familja e tij, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e pretenduara të përfituara nga nëna e tij nga toka bujqësore, shoqëruar me pagesën e detyrimeve tatimore, si dhe nuk depozitoi dokumentacion provues në lidhje me trashëgiminë e pretenduar të përfitur nga prindërit e tij, duke mos specifikuar as se cilit person i referohej, Komisioni nuk i ka përfshirë në analizën financiare këto të ardhura.

## 42. Analiza financiare

- i. Ndërtimi i katit përdhes të godinës me sip. 107.6 m<sup>2</sup> dhuruar subjektit të rivlerësimit.

Çmimi për njësi për sipërfaqen e ndërtimit në vitin 1996, sipas EKB-së, është 16.567 lekë/m<sup>2</sup>.

**Tabela nr. 1.**

| <b>Godinë, kati përdhes, viti 1996</b>               | <b>Kumulative 1989 - 1996</b> |
|--|-------------------------------|
| <b>Pasuri</b>  | <b>1,336,956.90</b>           |
| Godinë 2-katëshe, sip. ndërtimi 107.6 m <sup>2</sup> | 1,336,956.90                  |
| <i>Ndryshim likuiditeti (shtesa/pakësime)</i>        | 0.00                          |
| <b>Detyrime</b>                                      | <b>0.00</b>                   |
| Detyrime   | 0.00                          |
| <b>Pasuri neto</b>                                   | <b>1,336,956.90</b>           |
| <b>Të ardhura</b>                                    | <b>533,708.55</b>             |
| Të ardhurat e znj. H. Sh                             | 48,249.33                     |
| Të ardhurat e z. S. Sh                               | 485,459.22                    |
| Të ardhurat e subjektit                              | 0.00                          |
| Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit             | 0.00                          |

<sup>10</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.3.2022.

<sup>11</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.3.2022.



|                        |                      |
|------------------------|----------------------|
| <b>Shpenzime</b>       | <b>352,247.64</b>    |
| Shpenzime jetike       | 352,247.64           |
| Shpenzime mobilimi     | 0.00                 |
| <b>Mundësi kursimi</b> | <b>-1,155,495.99</b> |

Nga analiza financiare rezulton se babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 1.155.495,99 lekë për ndërtimin e katit përdhes të godinës në vitin 1996.

- ii. Ndërtimi i dy kateve të sipërme të godinës me sip. 229.5 m<sup>2</sup>.

**Tabela nr. 2.**

| <b>Godinë 2-katëshe, viti 1999</b>                | <b>Periudha 1.1.1997 – 8.1.1999</b> |
|---|-------------------------------------|
| <b>Pasuri</b>                                     | <b>3,448,180.13</b>                 |
| Godinë 2 kate, sip. ndërtimi 229.5 m <sup>2</sup> | 3,448,180.13                        |
| <i>Ndryshim likuiditeti (shtesa/pakësime)</i>     | <i>0.00</i>                         |
| <b>Detyrime</b>                                   | <b>0.00</b>                         |
| Detyrime  | 0.00                                |
| <b>Pasuri neto</b>                                | <b>3,448,180.13</b>                 |
| <b>Të ardhura</b>                                 | <b>164,137.39</b>                   |
| Të ardhurat e znj. H.Sh                           | 26,222.84                           |
| Të ardhurat e z. S.Sh                             | 137,914.55                          |
| Të ardhurat e subjektit                           |                                     |
| Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit          |                                     |
| <b>Shpenzime</b>                                  | <b>108,330.68</b>                   |
| Shpenzime jetike                                  | 108,330.68                          |
| Shpenzime jetike                                  | 0.00                                |
| <b>Mundësi kursimi</b>                            | <b>-3,392,373.41</b>                |

Nga analiza financiare rezulton se babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 3.392.373,41 lekë për ndërtimin e dy kateve të sipërme të godinës në vitin 1999.

**43.** Për sa më sipër, në lidhje me këtë pasuri, rezulton se babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për ndërtimin e saj, në total në shumën 4.547.869,41 lekë.

**44.** Në datën 16.6.2017, me kontratën nr. \*\*\*, subjekti ia ka shitur këtë pasuri në shumën 150.000 euro shtetasve I.L dhe H.L. Në kontratë është përcaktuar se çmimi është likuiduar në këtë mënyrë:

- 50.000 euro në dy këste, sipas një marrëveshjeje verbale (deklaratë personale dore, datë 1.10.2014, për shumën 20.000 euro dhe datë 19.6.2015 për shumën 30.000 euro);
- 100.000 euro nëpërmjet sistemit bankar, ku 25.000 euro do të kalojnë në llogarinë bankare të z. Arben Sharra dhe 75.000 euro do të kalojnë në llogari të znj. H.Sh, si person që ka një pjesë të pronës.

Përcaktimi në kontratë që znj. H.Sh ka një pjesë të pronës nuk përputhet me hetimin administrativ nga ku rezulton se subjekti ka qenë pronar i vetëm i kësaj pasurie.

**45.** Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, si dhe gjatë hetimit, për të provuar pagesën e shumës 150.000 euro nga blerësi, ka vënë në dispozicion:

- i. Njoftim debitimi datë 21.6.2017, të “Raiffeisen Bank”, ku blerësi I.L ka depozituar shumën 100.000 euro në llogarinë e noteres G.B.
- ii. Kopje deklarate dore, ku z. I.L deklaron se në datën 1.10.2014 i ka dhënë subjektit shumën 20.000 euro si paradhënie për blerjen e banesës në K-K.

Në lidhje me këtë shumë, subjekti, bazuar në procesverbalin e datës 25.1.2016<sup>12</sup>, “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive” në ILDKPKI ka deklaruar se një pjesë të shumës 20.000 euro, shumën prej 17.040 euro e ka përdorur për të shlyer kredinë në NBG Bank.

iii. Kopje deklarate të thjeshtë, ku z. I.L deklaron se në datën 19.6.2015 i ka dhënë subjektit shumën 30.000 euro si paradhënie për blerjen e banesës në K-K.

**46.** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.10.2021<sup>13</sup> në lidhje me pagesat e shumës 20.000 euro dhe 30.000 euro të kryera *cash* nga blerësi përpara se të lidhej kontrata e shitjes, ka sqaruar se për shitjen e banesës midis tij, (të ndjerit) babait të tij dhe z. I.L është bërë paraprakisht një marrëveshje verbale, pasi nuk dispononin certifikatë pronësie të banesës dhe, për pasojë, nuk mund të nënshkruanin kontratë paraprake për shitje me këste. Ai ka pretenduar se detyrimi tatimor në lidhje me shumën 20.000 euro dhe 30.000 euro të marra paradhënie, si dhe shumën 100.000 euro të kaluara me bankë, është paguar nga ana e tij në momentin e shitjes së banesës, ku është tatuar dhe ka paguar për llogari të ZVRPP-së pagesën e rivlerësimit të banesës. Për burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. I.L, subjekti ka pretenduar të ardhurat nga puna e djemve të tij që jetojnë dhe punojnë prej shumë vitesh në Angli (shitje prone).

**47.** Bazuar në dokumentacionin e mësipërm, Komisioni e ka pasur të paqartë se si z. I.L i ka dhënë një shumë të konsiderueshme prej 50.000 euro subjektit në vitet 2014 - 2015, për një veprim që do të kryhej në të ardhmen, që në fakt është realizuar në vitin 2017 dhe pa një akt noterial, qoftë edhe deklaratë noteriale. Në këto kushte, Komisioni e ka përfshirë me rezervë në analizë financiare shumën 50.000 euro, duke i kaluar subjektit barrën e provës: (i) për të dhënë shpjegime dhe të paraqesë dokumentacion provues bindës për përfitimin e kësaj shume; si dhe (ii) nëse shuma 50.000 euro nuk përfshihet në analizë financiare për periudhën 2014 - 2015 subjekti do të kishte një rezultat negativ në shumën 9.380.775,54 lekë.

**48.** Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, parashtroi<sup>14</sup> të njëjtat pretendime si gjatë hetimit administrativ, duke shtuar se në kontratën e shitblerjes së banesës dy kate + papafingo është qartësuar marrja e shumës 50.000 euro në vitet 2014 dhe 2015, sepse ky fakt është element i rëndësishëm me efekt vlefshmërie në kontratën e shitjes. Fakti që banesa i është lënë në dorëzim blerësit përpara lidhjes së kontratës dhe kryerjes së plotë të pagesës, nuk është element i nevojshëm apo i domosdoshëm i kontratës së shitblerjes. Mospasqyrimi në kontratë i këtij fakti nuk tregon se banesa nuk i është dorëzuar z. I.L në vitin 2014. Subjekti, në përfundim, pretendon se dokumentet janë përpiluar në momentin që kanë ndodhur pagesat dhe jo përgjatë procesit të *Vetting*-ut.

**49.** Komisioni, në lidhje me këto të ardhura, vlerëson që të jenë të përfshira në analizë financiare, pavarësisht faktit që mbetet e dyshimtë se si subjekti ka marrë një shumë të konsiderueshme të hollash, pa një dokument për të provuar marrjen e tyre, si dhe nuk është provuar që z. I.L kishte në posedim këtë banesë që në vitin 2014. Ky vlerësim i Komisionit mbështetet në faktin se nga dokumentacioni i kohës i depozituar nga subjekti është provuar që i ka deklaruar si burim këto të ardhura në institucione bankare, si dhe përfshirja e shumës 50.000 euro nuk ndikon në rezultatin përfundimtar të analizës financiare të subjektit.

**50.** Në lidhje me shlyerjen e vlerës së banesës, nga hetimi ka rezultuar se:

- i. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 29.6.2017 është transferuar shuma 24.998,8 euro nga noteri publik G.B.
- ii. Nga nxjerrja e llogarisë së nënës së subjektit në “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 29.6.2017 është transferuar shuma 74.998,8 euro nga noteri publik G.B.

<sup>12</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2021, e ILDKPKI-së.

<sup>13</sup> Subjekti ka depozituar: (i) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 19.10.2021, të shtetasit I. L; (ii) mandatarkëtimin e shumës 15.550 euro në datën 7.11.2014 në NBG Bank; (iii) mandatarkëtimin e Union Bank, datë 19.6.2015; (iv) një dokument në gjuhën anglezë të datës 26.2.2014, për shitjen e një pasurie të paluajtshme nga shtetasi V. L në shumën 328.300 £ nga të cilat do të përfitonte shumën 132.558,88 £.

<sup>14</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022 dhe në seancë.

Nga verifikimi i kartelës së pasurisë së banesës, në seksionin e qirave, në përdorim etj., ka shënim “pasuria rivlerësohet në shumën 36.972.500 lekë, me aplikimin nr. \*\*\*, datë 5.5.2017”.

**51.** Në përfundim të hetimit në lidhje me pasurinë shtëpi banimi, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, si vijon: (i) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se është pronar i vetëm i kësaj pasurie; (ii) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pronësinë mbi parcelën ndërtimore me sip. 500 m<sup>2</sup>, mbi të cilën është ndërtuar ndërtesa e legalizuar, por vetëm katin e parë të kësaj banese; (iii) subjekti nuk ka deklaruar në të gjitha deklaratat periodike faktin se ka aplikuar për legalizimin e një banesë dy kate + papafingo, si dhe nuk ka deklaruar në DPV/2015 pronësinë e tij mbi këtë banesë dhe të truallit me sip. 500 m<sup>2</sup>; (iv) subjekti nuk ka deklaruar në DPV/2015 pronësinë e tij mbi një banesë dy kate + papafingo; (v) babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për ndërtimin e kësaj banese, në total në shumën 4.547.869,41 lekë; (vi) subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të ardhurave të babait të tij për ndërtimin e kësaj banesë; si dhe (vii) subjekti nuk ka deklaruar gjatë hetimit administrativ kohën e ndërtimit të kësaj banese.

**52.** Pas kalimit të barrës së provës<sup>15</sup>, subjekti parashtrroi<sup>16</sup> në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon:

i) Banesa në K-K është ndërtuar e gjitha nga babai i subjektit (i ndjeri) S.Sh, dhe se ai ka përfituar me dhurim vetëm katin e parë të ndërtesës, sipas kontratës noteriale të dhurimit nr. \*\*\*, datë 8.1.1997. Subjekti vijoi t'i qëndronte deklaratimit<sup>17</sup> të tij të mëparshëm në lidhje me kërkesën që ka paraqitur pranë ALUIZNI-t Tiranë në vitin 2009. Ai ka pretenduar se e ka përsëritur këtë kërkesë edhe në datën 31.5.2010. Sipas subjektit, kryerja e detyrës në kundërshtim me ligjin nga punonjësit e ALUIZNI-t nuk mund ta ngarkojë me përgjegjësi.

Subjekti ka parashtruar se legalizimi dhe më pas pajisja me certifikatë pronësie 100% në emrin e tij nga ALUIZNI Tiranë, në vitin 2015, ka ardhur si rezultat i shkeljeve në kryerjen e detyrës nga punonjësit e këtij institucioni dhe në asnjë moment si rezultat i ndonjë rrethane të lidhur me të.

ii) Në lidhje me kohën e ndërtimit, subjekti ka theksuar se kati i parë i kësaj ndërtese është ndërtuar në vitin 1990, kohë kur ai ka qenë në moshën 17-vjeçare (1973 - 1990). Ky fakt vërtetohet plotësisht me kërkesën që babai i tij ka paraqitur në datën 12.6.1996 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “vërtetim fakti të pronësisë së banesës së ndërtuar prej tij që para 6 viteve”, e cila, me vendim gjyqësor të formës së prerë, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit më lart. Ndërsa kati i dytë është ndërtuar gjatë viteve 1997 - 1998.

iii) Në lidhje me burimin, subjekti ka dhënë të njëjtat deklaratime si gjatë hetimit administrativ, duke shtuar se për ndërtimin e kësaj banese kanë ndihmuar edhe familjarë të babait dhe nënës së tij.

---

<sup>15</sup> Subjekti ka depozituar: deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 5.6.2022, të shtetasve Xh dhe A.A, të cilët deklarojnë që në vitin 1990 daja i tyre S.Sh ka nisur të ndërtojë një shtëpi dhe ata kanë kontribuar si punëtorë; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 6.6.2022, të shtetasve M dhe S.D, të cilët deklarojnë që në vitin 1990 teza e tyre H.Sh bashkë me bashkëshortin S.Sh kanë ndërtuar një shtëpi dhe ata kanë kontribuar si ustallarë; vërtetim datë 15.6.1994, nga Komuna Shëngjergj, i cili ka qenë pjesë e dosjes së hetimit të Komisionit; procesverbal datë 18.10.2021, i cili ka qenë pjesë e dosjes së hetimit të Komisionit; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2021, e cila ka qenë pjesë e dosjes së hetimit të Komisionit; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2021, për të ardhurat nga pensioni të z. S.Sh; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2020, për të ardhurat nga pensioni të znj. H.Sh; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2022, e AREB; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 30.5.2022, e ISSH-së në lidhje me punësimin e motrave të subjektit; vërtetim nr. A-\*\*\* prot., datë 26.1.2022, i Bashkisë Tiranë, i cili ka qenë pjesë e dosjes së hetimit të Komisionit; vërtetim nr. \*\*\*, datë 12.5.2022, i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2022, e Njësisë Administrative Shëngjergj; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, e cila ka qenë pjesë e dosjes së hetimit të Komisionit; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.5.2022, e ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Veri; raport vlerësimi për llogaritjen e të ardhurave nga toka bujqësore, datë 10.6.2022; raport vlerësimi teknik, sipas së cilit kati i parë i banesës së subjektit është ndërtuar në vitin 1990 me vlerë 22.174 lekë dhe kati i dytë dhe papafingo janë ndërtuar në vitet 1997 - 1998 me vlerë 2.101.784,31 lekë; raport vlerësimi financiar; dosje e vendimit të vërtetimit të faktit të banesës. Në seancë subjekti depozitoi edhe: raport vlerësimi për llogaritjen e të ardhurave nga parcela nr. \*\*\*, deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 21.6.2022, e shtetasit N.S; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 22.6.2022, e shtetasit F.B; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 24.6.2022, e shtetasit S.Rr.

<sup>16</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022 dhe në seancë.

<sup>17</sup> Shihni pikën 34 të këtij vendimi.

iv) Në lidhje me shpenzimet e jetesës për periudhën 1989 – 2004, subjekti ka kërkuar që shpenzimet jetike duhet të përlogariten të paktën në masën 50% të pagave, duke marrë në konsideratë edhe faktin që kishin në shfrytëzim tokën bujqësore.

**53.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e vëna në dispozicion prej tij, vlerëson se ato nuk janë bindëse, për sa i përket kohës së ndërtimit të banesës dhe burimit të ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e saj.

i) Komisioni, duke u bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>18</sup> në lidhje me deklaratat noteriale, vlerëson se megjithëse nuk janë të pavlefshme, në kuptim të legjislacionit për noterinë, ato nuk kanë fuqi provuese në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe, e parë në raport me të dhënat e tjera, nuk mbështeten nga rrethanat dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes, në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, çka të krijon bindjen se janë konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështeten nga provat e tjera të administruara në këtë proces.

ii) Në lidhje me pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve jetike, duke qenë se familja e tij mund të ketë shfrytëzuar tokën bujqësore, pavarësisht se nuk ka asnjë dokument provues, duke u bazuar në vendimin nr. 15/2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se për periudhën 1992 – 1999 nuk ekzistojnë vlera të përcaktuara nga organi shtetëror i ngarkuar posaçërisht me matjen e nivelit të jetesës në vend, shpenzimet jetike do të llogariten në masën 50%, sikundër u kërkuar nga subjekti.

iii) Ndërkohë, në lidhje me pretendimet e subjektit për sa i përket kohës së ndërtimit të katit të parë në vitin 1990, Komisioni vlerëson të mos e marrë në konsideratë, sepse akt ekspertimi i depozituar nga subjekti nuk është bazuar në të dhënat e kohës. Nga ana tjetër, nga ortofotot e vëna në dispozicion nga ASIG-u del qartë se kati i parë nuk ka qenë i ndërtuar përpara vitit 1994. Referuar ortofotos së vitit 1994 në parcelën në të cilën është ndërtuar banesa e subjektit nuk ka asnjë ndërtim të përfunduar apo mure rrethues, ndërkohë, në parcelat përballë parcelës së subjektit, si dhe në të gjithë zonën, ndërtimet dallohen lehtësisht goftë edhe ato pa çati apo në themel.

iv) Në lidhje me të ardhurat të deklaruara nga subjekti me burim blegtorinë dhe tokën bujqësore, si dhe të ardhurat nga trashëgimia, Komisioni vlerëson të mos i përfshijë në analizë financiare. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues për të provuar të ardhurat nga trashëgimia, si dhe nuk ka depozituar dokumentacion provues që prindërit e tij kanë prodhuar produkte bujqësore, i kanë shitur ato dhe kanë paguar detyrimet tatimore përkatëse. Për më tepër, subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues për pagimin e taksës së tokës për periudhën 1992 – 2007.

v) Në lidhje me aktekspertimin mbi të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore vënë në dispozicion nga subjekti, duke iu referuar deklarimeve të ekspertes, ai është bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti dhe për këtë arsye mbetet i karakterit deklarativ. Në këtë raport llogaritja e të ardhurave të përfituara nga toka bujqësore është kryer me çmimet e vitit 2021 dhe jo duke bërë referencë në çmimet përkatëse të vitit kur janë përfituara këto të ardhura. Për pasojë, Komisioni nuk do të marrë në konsideratë këtë raport, sepse nuk është i bazuar në dokumentet e kohës apo në çmime dhe situata faktike.

vi) Gjithashtu, Komisioni nuk do të përfshijë në analizë financiare të ardhurat e pretenduara nga motrat e subjektit, pasi ato nuk i përkasin periudhës 1995 e në vijim, por edhe sikur hipotetakisht këto të ardhura të përfshiheshin, sërish prindërit e subjektit nuk do të kishin të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e katit të parë nga babai i tij.

vii) Në lidhje me kostot e ndërtimit Komisioni i është referuar vendimit nr. 15/2019 të Kolegjit, duke e llogaritur vlerën e banesës sipas EKB-së dhe më pas ka reduktuar 25% të kësaj vlere në analizën financiare. Kjo llogaritje e Komisionit nuk është në përputhje me jurisprudencën aktuale të Kolegjit, ku në vendimin

---

<sup>18</sup> Vendim nr. 6/2018(JR), datë 12.9.2018, paragrafët 35 dhe 36; vendim nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, paragrafi 27.12.1; vendim nr. 34/2019(JR), datë 2.12.2019, paragrafi 85.2; vendim nr. 23/2020 (JR), datë 25.9.2020, paragrafi 26.2 dhe vendim nr. 11/2021(JR) datë 31.03.2021

nr. 7/2022 vlera e reduktuar është 8.83%. Komisioni, për të mos rënduar pozitën e subjektit, do të llogarisë vlerën e banesës, sikundër i është dërguar në rezultatet e hetimit.

viii) Komisioni kreu edhe një herë analizën financiare, duke pranuar pretendimet e subjektit në lidhje me vlerën 50% të shpenzimeve jetike, ndërsa në lidhje me vlerën e pensioneve të babait pretendimi i subjektit nuk do të pranohet për të mos rënduar pozitën e tij, pasi nga dokumentacioni i depozituar prej tij shumat e përfituar nga babai nga pensioni janë në një vlerë shumë më të ulët se ajo e përfshirë në analizën financiare<sup>19</sup>.

ix) Nga analiza financiare rezulton se prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për ndërtimin e katit të parë në shumën 977.222,06 lekë dhe për ndërtimin e katit të dytë + papafingo në shumën 3.296.389,63 lekë.

**54.** Komisioni vlerëson të ndalet në lidhje me faktin e krijimit të kësaj pasurie përpara fillimit të detyrës. Bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit<sup>20</sup>, rivlerësimi është analizë e së shkuarës së një funksionari publik, duke mbajtur në konsideratë që objekt kontrolli është pasuria dhe, për këtë shkak, institucionet e rivlerësimit kontrollojnë burimin në të shkuarën për të cilin është krijuar kjo pasuri dhe rivlerësimi kalimtar *Vetting* mund të përkufizohet si vlerësim i integritetit për të përcaktuar përshtatshmërinë për funksione publike. Legjislacioni i posaçëm për rivlerësimin kalimtar nuk vendos kriteret kohore lidhur me provueshmërinë e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive në pronësi apo përdorim, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Në një interpretim të dispozitave të zbatueshme lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurive, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, të përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka arritur në konkluzionin se nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj. Në këtë proces, subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij dhe organet e rivlerësimit kanë si qëllim që të identifikojnë ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

**55.** Në lidhje me faktin se kjo pasuri është shitur, si dhe nëna e subjektit ka përfituar vlerën 75.000 euro, për Komisionin, bazuar edhe në vendimin nr. 11/2022 të Kolegjit, ky fakt nuk përbën shkak për përjashtimin e kësaj pasurie nga procesi i rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit. Prindërit e subjektit, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>21</sup>, duhet të trajtohen si persona të tjetër të lidhur, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për sa i përket kontributit të tyre financiar në ndërtimin e banesës. Ky përcaktim merr rëndësi për shkak të statusit ligjor dhe regjimit të të drejtave pasurore që subjekti i rivlerësimit ka fituar me legalizimin e kësaj pasurie, duke qenë se i gjithë objekti është legalizuar dhe regjistruar si pasuri vetëm e subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe katet për të cilat pretendon se janë të babait të tij. Gjithashtu, edhe sikur hipotetikisht kjo pasuri të mos konsiderohej në vlerësimin e subjektit, vendimi final i Komisionit nuk do të ndryshonte për sa i përket kriterit të pasurisë.

**56.** Në përfundim, Komisioni çmon se: (i) subjekti ka kryer deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me këtë pasuri; (ii) subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e kësaj pasurie në shumën 4.273.611,69 lekë.

<sup>19</sup> Nëse në analizë për vitet 1997 - 1999 vlera e pensionit është llogaritur 270.534,6 lekë realisht babai i subjektit ka përfituar 182.969 lekë.

<sup>20</sup> Vendimet nr. \*\*/2019, nr. \*\*/2019, nr. \*\*/2019 dhe nr. \*\*/2020.

<sup>21</sup> Vendim nr. \*, datë 16.4.2019 dhe nr. \*\*, datë 17.7.2019.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

**57.** Bazuar në ortofotot dixhitale<sup>22</sup> për vitet 2007 - 2018 ka rezultuar se në të njëjtën parcelë ku është ndërtuar banesa e mësipërme ndodhet një ndërtim tjetër, gjithashtu edhe në parcelën ngjitur ndodhet ndërtim, të cilët duket se janë ndërtuar pas vitit 2015.

**58.** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 13.1.2022, në lidhje me këto ndërtime, ka sqaruar se deri në vitin 2014, kur ai dhe babai kanë bërë marrëveshjen verbale me z. I.L për shitjen e banesës dhe ia kanë dorëzuar fizikisht banesën këtij shtetasi, në parcelën ndërtimore dhe brenda murit rrethues të saj nuk ka pasur asnjë ndërtim tjetër. Për të provuar këtë, ai ka depozituar deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 29.1.2022, të z. I.L, i cili deklaron se banon në këtë banesë që nga viti 2014 dhe se në pjesën anësore brenda murit rrethues ka ndërtuar një shtëpi të vogël përdhese pas vitit 2014. Duke qenë se banesa ishte brenda murit rrethues, për të mos pasur ndonjë pengesë për legalizimin e saj, ka biseduar me z. S.Sh që kërkesën për legalizim ta bënte ai.

**59.** Komisioni konstaton se deklaramet e subjektit dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk përputhen me hetimin, pasi:

- i. Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2021, të ASHK-së Tirana Veri, konstatohet se: a) babai i subjektit ka plotësuar në datën 10.9.2015 “Deklaratën për përfshirje në procedura legalizimi të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesë në ndërtim me leje”, protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2015, duke deklaruar se ka ngritur një ndërtim në vitin 2011 me vendndodhje K-K, Njësia Administrative Nr. \*\*, Tiranë. Në këtë deklaratë si numër kontakti rezulton numri \*\*\*, i cili është numri i telefonit i subjektit të rivlerësimit, i deklaruar në deklaratën *Vetting*; b) bazuar në dokumentin skicë fushore të datës 17.2.2016, i cili është pjesë e dokumentacionit të ALUIZNI-t, numri i telefonit në këtë dokument është numri \*\*\*, i cili është numri i telefonit i subjektit të rivlerësimit. Në këtë dokument specifikohet se banesa për të cilën ka aplikuar z. S.Sh kufizohet me banesën në pronësi të subjektit të rivlerësimit, e cila është pajisur me certifikatë pronësie me sip. 500 m<sup>2</sup> dhe me leje legalizimi.
- ii. Ky ndërtim ndodhet në parcelën me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sipërfaqe totale 370.15 m<sup>2</sup>. Kjo pasuri, bazuar në urdhrin nr. \*\*\*, datë 3.8.201523, të regjistruerit të ZVRPP-së Tiranë, është në pronësi shtet.
- iii. Nga verifikimi i ortofotove dixhitale rezulton se banesa është ndërtuar pas vitit 2015.
- iv. Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me banesën trikatëshe, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar: “*Bërë marrëveshje verbale për shitjen e shtëpisë me shtetasin I.L në vitin 2014. Pjesa takuese: 100%*”. Në këtë deklaratë subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar faktin se banesa është në posedim të shtetasit I.L, si dhe tek seksioni “Përshkrimi i të ardhurave” nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar shumën 50.000 euro të përfituar si paradhënie nga marrëveshja verbale për shitjen e kësaj pasurie.
- v. Në deklaramet periodike të vitit 2014/2015 nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar pakësimin e pasurisë banesë, por ka deklaruar vetëm të ardhurat e marra paradhënie.
- vi. Në DPV/2015 subjekti e ka deklaruar këtë banesë si shtesë pasurie dhe jo pakësim.
- vii. Në DPV/2017 subjekti deklaroi shitjen e kësaj shtëpie dhe pakësimin e saj si pasuri.
- viii. Në kontratën e shitblerjes së banesës trikatëshe nuk rezulton që kjo banesë i është lënë në dorëzim shitësit përpara lidhjes së kontratës dhe kryerjes së plotë të pagesës.

**60.** Komisioni, pasi analizoi provat e administruar gjatë hetimit dhe shpjegimet e subjektit, konstaton se:

- a. Parcela ku është ndërtuar shtëpia për të cilin ka aplikuar për legalizim babai i subjektit nuk është e njëjta parcelë e cila i është shitur shtetasit I.L me kontratën nr. \*\*\*.

<sup>22</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2022, të ASIG-ut.

<sup>23</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2020, e ASHK-së Tirana Veri.

- b. Nuk rezulton asnjë dokumentacion provues që ky ndërtim të jetë kryer nga shtetasi I.L apo që të përdoret prej tij.
- c. Aplikimi për legalizimin e kësaj pasurie është bërë nga babai i subjektit të rivlerësimit, i cili në momentin e aplikimit ka qenë i verbër<sup>24</sup>, duke qenë e paqartë mënyra e nënshkrimit të tij në formularin e vetëdeklarimit pranë ALUIZNI-t.
- d. Në formularin e vetëdeklarimit pranë ALUIZNI-t është vendosur numri i telefonit të subjektit të rivlerësimit. Ky numër telefoni është vendosur edhe në dokumentin skicë fushore të datës 17.2.2016.
- e. Ndërtimi rezulton i kryer pas vitit 2015, për rrjedhojë, shtetasi I.L nuk kishte asnjë arsye për të kontaktuar babain e subjektit në vitin 2015 dhe t'i kërkonte të kryente aplikimin pranë ALUIZNI-t, për sa kohë ndërtimi nuk ekzistonte.
- f. Subjekti, deri në momentin e aplikimit të babait të tij pranë ALUIZNI-t për këtë ndërtim, ka qenë pronar dhe posedues i banesës trikatëshe, pasi ai vetëm në vitin 2017 ka kryer shitjen e saj, si dhe e ka deklaruar si pakësim në deklaratat periodike.
- g. Subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit asnjë dokumentacion provues që shtetasi I.L ka komunikuar me babain e tij në vitin 2015.
- h. Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues që banesa është marrë në posedim nga shtetasi I.L në vitin 2014.
- i. Subjekti, aktualisht, si rrjedhojë e trashëgimisë ligjore (e cila sipas deklarimeve të subjektit nuk është çelur ende), gëzon të drejta mbi këtë aplikim.

Bazuar në konstatimet e mësipërme lindin dyshime për një pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

**61.** Pas kalimit të barrës së provës<sup>25</sup> subjekti sqaroi se<sup>26</sup> deklarata për përfshirjen e kësaj banese në procedurat e legalizimit është plotësuar në emër të babait, pa dijeninë e tij. Ai ka pretenduar se ndoshta punonjësit e ALUIZNI-t i kanë kërkuar ndonjë numër telefoni dhe ai ka deklaruar telefonin e tij. Subjekti ka këmbëngulur se nuk ka asnjë lidhje me këtë ndërtim.

**62.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe nuk janë mbështetur në prova, por vetëm në deklarata noteriale, vlera provuese e të cilave është e kufizuar, për sa kohë nuk shoqërohen me dokumentacion provues. Veprimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, duke bërë një deklaratë për t'u tërhequr nga legalizimi i banesës, tregojnë që subjekti ka pasur ligjërisht të drejta reale mbi këtë banesë që në momentin e deklarimit të deklaratës *Vetting*, si dhe gjatë procesit të rivlerësimit, të drejta të cilat janë mohuar nga subjekti, duke pretenduar se banesa ishte ndërtuar nga z. I.L. Për shkak të deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimeve e dokumentacionit të përcjellë në lidhje me këtë pasuri gjatë hetimit administrativ, është e pamundur të verifikohet pasqyrimi i situatës së vërtetë lidhur me ndërtimin e kësaj ndërtese dhe, për rrjedhojë, pamundësi objektive për të kontrolluar pronësinë dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit të saj. Në këto rrethana, deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

<sup>24</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2022 dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2022 “Kthim përgjigjeje Njësia Administrative Nr. \*\*\*”. Nga shkresa nr. \*\*\* rezulton se babai i subjektit është pajisur me librezë verbërie, pasi është konsideruar si i verbër i grupit të parë. Libreza ka pasur afat të përhershëm.

<sup>25</sup> Subjekti ka depozituar: deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 6.6.2022, të shtetasit I.L; aktverifikim për përcaktimin e kohës së ndërtimit të banesës. Në seancë subjekti depozitoi disa dokumente të firmosura nga shtetasi I.L; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 20.6.2022, të shtetasit Q.L; vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. \*\*\*, datë 22.6.2022, sipas së cilit subjekti së bashku me familjarët e tij përfitojnë 1/6 pjesë të pasurisë trashëgimore; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 23.6.2022, sipas së cilës subjekti dhe familjarët e tij deklarojnë se nuk kanë pretendime pronësie mbi banesën 1-katëshe dhe tërhiqen nga legalizimi i kësaj banese në emrin e tyre. Procesi i legalizimit të kësaj banese të vazhdojë në emër të shtetasit I.L si pronar i kësaj pasurie të ndërtuar në vitin 2015.

<sup>26</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022 dhe në seancë.

**63. Apartament banimi<sup>27</sup> me sipërfaqe 128.1 m<sup>2</sup>**, lidhur kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 23.6.2008, me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., në rrugën “T.T”, Tiranë. Vlera e apartamentit: 94.830 euro. Detyrimi i palikuiduar ndaj firmës “\*\*\*\*” sh.p.k. 13.915 euro. Pjesa takuese: 50%.

**Burimi sipas deklaratës Vetting:** kredi në NBG Bank në vlerën 46.000 euro, në datën 29.7.2008, të ardhurat ndër vite, përfshirë edhe marrjen paradhënie të shumës 50.000 euro për shitjen e banesës në K-K. Kredia e shlyer përfundimisht në datën 7.11.2014 me të ardhurat ndër vite dhe një pjesë nga shuma e marrë paradhënie për shitjen e banesës në K-K.

#### **Konstatimi i ILDKPKI-së:**

- i. Deklarimi i subjektit është i njëjtë me konfirmimin e ardhura nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. lidhur me pagesat e kryera dhe detyrimin e mbetur për apartamentin në rrugën “T.T”, Tiranë, gjithsesi është i dyshimtë mosplotësimi i kushteve të kontratës së sipërmarrje lidhur me pagesat dhe kohën e kryerjes së tyre, e cila parashikon penalitete respektive për palët. Gjithashtu është i dyshimtë bllokimi i pronës private të palës shitëse, si garanci për shlyerjen e kredisë së marrë nga pala blerëse, për rreth 6 vjet.
- ii. Nuk është i qartë shkaku i moslikuidimit të çmimit total të blerjes së apartamentit dhe afati i pagesës së fundit, duke krahasuar që referuar kontratës, pagesat do të kryheshin gjatë periudhës 2008 – 2010, ndërsa *de facto* përfshijnë periudhën 2008 e në vazhdim. Subjekti ka deklaruar deri në vitin 2013 si adresë banimi K-K.
- iii. Është i dyshimtë deklarimi për marrjen paradhënie në shumën 20.000 euro në vitin 2014 dhe 30.000 euro në vitin 2015, me deklaratë të thjeshtë, jashtë sistemit bankar, nga blerësi i ardhshëm i pronës në K-K, përdorur si burim për pagesë likuidimi kredie në NBG Bank dhe pagesë kësti pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Marrëveshja e shitjes, bërë midis palëve, sipas deklaratimit të subjektit është verbale.

#### **Hetimi<sup>28</sup> dhe analiza financiaro-juridike e kryer nga Komisioni**

**64.** Në datën 23.6.2008, subjekti ka lidhur kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\* me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për blerjen e një apartamenti me sipërfaqe totale 128.1 m<sup>2</sup>, në rrugën “T.T”, Tiranë. Apartamenti ndodhet në katin e pestë nr. \*\*\*, në objektin \*, që është ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

**65.** Çmimi i përcaktuar në kontratë është 94.830 euro dhe pagesa do të kryhej si vijon:

- i. kësti i parë 50.000 euro do të shlyhej brenda muajit korrik;
- ii. kësti i dytë 20.000 euro do të shlyhej brenda muajit nëntor;
- iii. kësti i tretë 15.000 euro do të shlyhej brenda muajit mars 2009;
- iv. kësti i katërt 9.830 euro do të shlyhej në momentin e dorëzimit faktik të apartamentit.

**66.** Bazuar në planimetrinë e apartamentit rezulton se ai është me sip. 82 m<sup>2</sup> dhe ka një verandë prej 38.3 m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja e përbashkët është 7.8 m<sup>2</sup>. Nga hetimi ka rezultuar se kjo pasuri është e regjistruar me leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 1.10.2020, me nr. pasurie \*\*\*, me sip. 120.4 m<sup>2</sup>. Në lidhje me këtë sipërfaqe, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 13.1.2022, ka sqaruar se *sipërfaqja 120.4 m<sup>2</sup> është*

<sup>27</sup> Subjekti ka depozituar: kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 23.6.2008; kontratë kredie nr. \*\*\*, datë 29.7.2008; vërtetim datë 22.1.2015, e NBG Bank; deklaratë e thjeshtë dore (olografe) datë 1.10.2014, ndërmjet shtetasit I. L dhe z. Arben Sharra për shumën e dhënë 20.000 euro si paradhënie për blerjen e banesës në K-K; deklaratë e thjeshtë ndërmjet shtetasit I.L dhe z. Arben Sharra për shumën e dhënë 30.000 euro si paradhënie për blerjen e banesës në K-K; si dhe vërtetim datë 24.1.2017, i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

<sup>28</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2021, drejtuar ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Veri; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2021, e ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Veri; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020, e “Union Bank”; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\*, datë 27.1.2020, e ABI Bank; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2021, drejtuar ABI Bank; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2021, e ABI Bank; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” sh.a.; shkresë kthim përgjigjeje nr. K-\*\*\* prot., datë 3.2.2020, e UKT-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2020, e OSHEE-së.



sipërfaqja totale e apartamentit dhe jo sipërfaqja e brendshme. Komisioni i kërkoi subjektit që të provonte me dokumentacion që sipërfaqja 120.4 m<sup>2</sup> përfshinte edhe verandën.

Pas kalimit të barrës së provës subjektit provoi me dokumentacion provues, konkretisht shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.5.2022, të ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Veri, sipas së cilës sipërfaqja 120.4 m<sup>2</sup> përfshin edhe sipërfaqen e verandës.

### **Në lidhje me burimin e deklaruar**

**67.** Subjekti, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar si burim: (i) kredi në vlerën 46.000 euro në NBG Bank në datën 29.7.2008; (ii) të ardhurat ndër vite, përfshirë edhe marrjen paradhënie të shumës 50.000 euro për shitjen e banesës në K-K<sup>29</sup>.

### **68. Kredia e marrë në NBG Bank**

Subjekti, në datën 29.7.2008, ka lidhur kontratë kredie<sup>30</sup> nr. \*\*\* me NBG Bank, duke marrë hua shumën 46.000 euro me afat 20 vjet, me qëllim blerjen e një apartamenti në rrugën “T T”, Tiranë. Në nenin 1.06 përcaktohet se banka do të derdhë shumën e kredisë në numrin e llogarisë së shitësit të pasurisë së paluajtshme, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., për blerjen e së cilës merret kredia në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*. Subjekti, së bashku me pyetësorin standard, ka depozituar dokumentin “kërkesë për transferim fondesh”, datë 1.8.2008, për transferimin e shumës 45.968 euro në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në Bankën Amerikane. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në NBG Bank vërtetohet se në datën 1.8.2008 ka kryer transferimin e shumës 46.000 euro, me emërtim “për blerje apartamenti sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 23.6.2008”.

### **Në lidhje me shlyerjen e kredisë**

**69.** Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në NBG Bank, rezulton se:

- Në datën 28.5.2009 është depozituar shuma 15.000 euro, e cila ka shërbyer për shlyerjen pjesore të kredisë.

Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.10.2021, ka deklaruar se burimi i këtyre të ardhurave kanë qenë kursimet *cash* që kishte bërë ndër vite nga paga e tij dhe e bashkëshortes, si dhe të ardhurat nga toka bujqësore, kursime të cilat i ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore që ka dorëzuar në ILKDPKI. Subjekti, në DPV/2009, ka deklaruar pakësim të shumës 2.000.000 lekë nga kursimet deri në datën 31.12.2008 për shlyerjen pjesore të kredisë.

**70.** Komisioni ka kryer një analizë financiare si vijon për mundësinë e subjektit për kursime *cash* deri më 31.12.2008. Nga verifikimi i deklarimeve periodike të subjektit konstatohet se:

- në DPV/2005, në rubrikën shtesa/pakësime, deklaroi *likuiditet i krijuar në vitin 2005, shuma 600.000 lekë dhe likuiditet nga shfrytëzimi i tokës bujqësore 300.000 lekë*;
- në DPV/2006, në rubrikën shtesa/pakësime, deklaroi *likuiditet i krijuar në vitin 2006, shuma 600.000 lekë dhe likuiditet nga shfrytëzimi i tokës bujqësore 100.000 lekë*;
- në DPV/2007, në rubrikën shtesa/pakësime, deklaroi *likuiditet i krijuar në vitin 2007, shuma 550.000 lekë dhe likuiditet nga shfrytëzimi i tokës bujqësore 200.000 lekë*;
- në DPV/2008, në rubrikën shtesa/pakësime, deklaroi *gjendje cash krijuar për vitin 2008, shuma 400.000 lekë*;
- në DPV/2009, në rubrikën “pakësime në vlerën 2.000.000 lekë nga kursimet e bëra deri më 31.12.2008”, deklaroi *gjendje cash 500.000 lekë krijuar për vitin 2009*.

### **Tabela nr. 3.**

|         | <b>Viti 2005</b> | <b>Viti 2006</b> | <b>Viti 2007</b> | <b>Viti 2008</b> |
|---------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Pasuria | 604,815.44       | 863,494.87       | 338,817.52       | 12,754,770.46    |

<sup>29</sup> Në lidhje me këtë burim, referohuni te pasuria e parë, pikat 47-49.

<sup>30</sup> Për këtë kredi është lidhur kontratë hipotekimi nr. \*\*\* midis NBG Bank dhe shtetasve M.T, V.T dhe Dh.T, duke u hipotekuar në favor të bankës për sigurimin e pagimit të kredisë apartament me sip. 42.8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*-N\*, z. k. \*\*\*.

|  |                   |                    |                   |                    |
|--|-------------------|--------------------|-------------------|--------------------|
| Ndryshim likuiditeti (shtesa/pakësime) | 604,815.44        | 863,494.87         | 338,817.52        | 395,870.23         |
| Cash                                   | 600,000.00        | 1,200,000.00       | 1,750,000.00      | 2,150,000.00       |
| Detyrime                               | 0.00              | 0.00               | 0.00              | 11,430,104.18      |
| Pasuria <i>neto</i>                    | 604,815.44        | 863,494.87         | 338,817.52        | 1,324,666.28       |
| Të ardhura                             | 1,145,795.00      | 1,093,156.00       | 1,029,704.00      | 1,623,856.00       |
| Shpenzime                              | 438,228.00        | 438,228.00         | 547,212.00        | 550,907.48         |
| <b>Mundësia për kursime</b>            | <b>102,751.56</b> | <b>-208,566.87</b> | <b>143,674.48</b> | <b>-251,717.75</b> |

Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të krijuar gjendjen *cash*, përkatësisht për vitin 2006 në vlerën 208.566,87 lekë dhe për vitin 2008 në vlerën 251.717,75 lekë.

Për rrjedhojë, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 460.444,62 lekë për shlyerjen pjesore të kredisë.

71. Në vitin 2011 subjekti rezulton të ketë shlyer shumën 7.256 euro.

**Tabela nr. 4.**

|   | <i>3,290 euro cash dep., datë 1.8.2011</i> | <i>2,060 euro cash dep., datë 30.12.2011</i> |
|---|--|--|
|   | 1.1.2011 – 1.8.2011                        | 1.8.2011 – 30.12.2011                        |
| <b>Pasuria</b>                                  | <b>-606 875,39</b>                         | <b>757 516,02</b>                            |
| <i>Ndryshim likuiditeti (shtesa/pakësime)</i>   | <i>-606 875,39</i>                         | <i>757 516,02</i>                            |
| <b>Detyrime</b>                                 | <b>-652 776,00</b>                         | <b>-384 934,54</b>                           |
| Shlyerje e kredisë në NBG 46,000 euro           | -652 776,00                                | -384 934,54                                  |
| <b>Pasuria <i>neto</i></b>                      | <b>45 900,61</b>                           | <b>1 142 450,56</b>                          |
| <b>Të ardhura</b>                               | <b>1 013 322,00</b>                        | <b>506 661,00</b>                            |
| Të ardhurat e subjektit                         | 628 245,33                                 | 314 122,67                                   |
| Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit        | 385 076,67                                 | 192 538,33                                   |
| <b>Shpenzime</b>                                | <b>704 505,00</b>                          | <b>182 160,00</b>                            |
| Shpenzime jetike                                | 364 320,00                                 | 182160                                       |
| TIMS  | 338 835,00                                 | 0  |
| Shpenzime për taksat vendore të tokës bujqësore | 1 350,00                                   | 0  |
| <b>Mundësia për kursime</b>                     | <b>262 916,39</b>                          | <b>-817 949,56</b>                           |

Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 817.949,56 lekë për shlyerjen e kredisë.

72. Në datën 7.11.2014 është depozituar shuma 15.550 euro, e cila ka shërbyer për shlyerjen e plotë të kredisë. Subjekti, bazuar në procesverbalin e datës 25.1.2016<sup>31</sup> “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive” në ILDKPKI, ka deklaruar se një pjesë të shumës 20.000 euro të marrë parapagim nga shtetasi I.L e ka përdorur për të shlyer kredinë në NBG Bank. Subjekti, për të provuar këtë deklaram, në datën 7.11.2014 ka depozituar mandatarkëtimin e shumës 15.550 euro në NBG Bank. Bashkëlidhur mandatit është deklarata e subjektit, i cili deklaron se *burimi është shitja e banesës së tij në K-K*. Ky fakt konfirmohet edhe nga shkresa nr. \*\*\*, datë 14.1.2022, e “ABI Bank”.

<sup>31</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2021, e ILDKPKI-së.

## Në lidhje me kryerjen e pagesave të apartamentit

73. Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në datën 14.7.2017 (gjendur në dosjen e ILDKPKI-së) ka vënë në dispozicion pagesat e kryera nga subjekti, si më poshtë vijon:

- Në datën 1. 8.2008 është paguar shuma 46.000 euro<sup>32</sup> nëpërmjet sistemit bankar në NBG Bank.
- Në datën 19.10.2012 është paguar shuma 5.000 euro<sup>33</sup>.
- Në datën 31.5.2013, me mandatin nr. \*\*\*, është paguar shuma 4.285 euro<sup>34</sup>.
- Në datën 91.6.2015 në “Union Bank” është paguar shuma 24.400 euro, ku si burim i saj është deklaruar *marrë paradhënie nga marrëveshja verbale për shitjen e banesë në K-K*<sup>35</sup>.
- Në datën 30.12.2015<sup>36</sup> është paguar shuma 5.000 euro në “Intesa Sanpaolo Bank”.
- Në datën 13.11.2015, me mandatin nr. \*\*\*, është paguar shuma 230 euro.

Në total, deri në plotësimin e deklaratës *Vetting*, është paguar shuma 80.883 euro. Në DPV/2017 subjekti ka deklaruar se ka shlyer edhe shumën 788 euro ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Deri në fund të vitit 2017, subjekti ka shlyer 81.621 euro nga vlera prej 94.830 euro.

74. Detyrimi ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. ka mbetur i pashlyer edhe pas regjistrimit të pasurisë me leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 1.10.2020, pasi subjekti, së bashku me pyetësorin e datës 13.1.2022, ka depozituar vërtetim të kësaj shoqërie, sipas së cilës konfirmohet fakti se deri në datën 31.1.2022 detyrimi i pashlyer i subjektit është në shumën 13.127 euro.

75. Në lidhje me këtë detyrim, Komisioni nuk e ka pasur të qartë se pse ka mbetur i pashlyer, për sa kohë:

- apartamenti është i regjistruar në ASHK në emër të subjektit të rivlerësimit dhe, rrjedhimisht, ligjërisht nuk ka asnjë detyrim ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.;
- shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka mbuluar të gjitha shpenzimet për legalizimin e apartamentit;
- subjekti nuk ka depozituar asnjë dokument të nënshkruar prej tij që konfirmon detyrimin që ka ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.;
- kontrata e sipërmarrjes është lidhur në vitin 2008 dhe ende pas gati 14 vjetësh subjekti nuk ka shlyer vlerën e plotë saj.

## 76. Analiza financiare

- Në datën 1.8.2008 subjekti ka paguar shumën 46.000 euro nëpërmjet sistemit bankar në NBG Bank. Si burim për kryerjen e kësaj pagese ka shërbyer kredia e marrë në “Credins Bank”, për rrjedhojë, subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kryerjen e kësaj pagese.
- Në datën 19.10.2012 është paguar shuma 5.000 euro.

### Tabela nr. 5.

|  | <b>Periudha 1.1.2012 – 19.10.2012</b> |
|--|---------------------------------------|
| <b>Pasuria</b>                                 | <b>-270 515,11</b>                    |
| <i>Ndryshim likuiditeti (shtesa/pakësime)</i>  | <i>-270 515,11</i>                    |
| <b>Detyrime</b>                                | <b>-1 344 106,40</b>                  |
| Shlyerje e kredisë në NBG Bank 46.000 euro     | -645 506,40                           |
| Shlyerje detyrim ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. | -698 600,00                           |
| <b>Pasuria neto</b>                            | <b>1 073 591,29</b>                   |

<sup>32</sup> Deklaruar në DPV/2008.

<sup>33</sup> Deklaruar në DPV/2012.

<sup>34</sup> Deklaruar në DPV/2013.

<sup>35</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2021, të ILDKPKI-së dhe shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020, të “Union Bank”.

<sup>36</sup> Në DPV/2015 subjekti ka deklaruar shlyerjen në shumën 29.630 euro.

|  |                     |
|--|---------------------|
| <b>Të ardhura</b>                        | <b>1 307 280,83</b> |
| Të ardhurat e subjektit                  | 819 813,33          |
| Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit | 487 467,50          |
| <b>Shpenzime</b>                         | <b>465 160,00</b>   |
| Shpenzime jetike                         | 465 160,00          |
| <b>Mundësia për kursime</b>              | <b>-231 470,46</b>  |

Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 231.470,46 lekë për të paguar këstin prej 5.000 euro.

iii. Në vitin 2015 subjekti ka likuiduar në total shumën 4.078.569 lekë. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për shlyerjen e kësteve në këtë vit.

**77.** Në përfundim të hetimit në lidhje me këtë pasuri, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit si më poshtë vijon:

- i. Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme:
  - në shumën 231.470,46 lekë për të paguar këstin e apartamentit në vlerën 5.000 euro;
  - për të krijuar gjendjen *cash*, përkatësisht për vitin 2006 në vlerën 208.566,87 lekë dhe për vitin 2008 në vlerën 251.717,75 lekë;
  - në shumën 460.444,62 lekë për shlyerjen pjesore të kredisë në vitin 2008;
  - në shumën 817.949,56 lekë për shlyerjen pjesore të kredisë në vitin 2011.
- ii. Është e paqartë se pse subjekti ka mbetur pa shlyer shumën 13.127 euro ndaj shoqërisë “\*\*\*.” sh.p.k., për sa kohë legalizimi dhe regjistrimi i pasurisë është kryer në emër të tij dhe jo të shoqërisë.

**78.** Pas kalimit të barrës së provës<sup>37</sup> subjekti prapësoi<sup>38</sup> se nëse në analizë përfshihen të ardhurat nga toka bujqësore ai ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e likuiditetit të gjendjes *cash*. Subjekti pretendoi se analiza financiare për burimin e të ardhurave për pagesat për shlyerjen e kredisë në këtë vit në shumën 7.256 euro duhet të bëhet për të gjithë vitin 2011 dhe jo në datat e pagesës, sepse ka pasur gjendje të likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2010, duke i përdorur në momentin e kryerjes se transaksionit dhe me të ardhurat nga pagat dhe prodhimet bujqësore i ka zëvendësuar deri në fund të vitit. Sipas subjektit, në fund të vitit 2011 rezulton një bilanc negativ në shumën 305.641 lekë si pasojë e një pasaktësie në deklarimin e ndryshimit të gjendjes së likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2011, duke mos deklaruar se kishte pakësuar gjendjen *cash* në fund të këtij viti për vlerën 305.641 lekë. Subjekti ka parashtruar se detyrimi 13.127 euro ndaj shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. ka mbetur pa shlyer jo për shkaqe që lidhen me aftësinë e tij paguese të kësaj shume, por për shkaqe ligjore dhe objektive që nuk varen prej tij. Llogaritë bankare të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. janë të bllokuara, pasi kjo shoqëri ndodhet në një proces gjyqësor civil në Gjykatën e Lartë dhe, si rrjedhojë e këtij fakti, shoqëria i ka kërkuar të mos e bëjë shlyerjen e detyrimit të mbetur deri në përfundimin e gjykimit të kësaj çështjeje dhe çlirimin e llogarive bankare të shoqërisë nga çdo lloj barre.

**79.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë raportin e vlerësimit të depozituar nga subjekti, pasi në të janë përfshirë të ardhurat nga toka bujqësore (në këtë raport subjekti konsiderohet si i vetëpunësuar në bujqësi<sup>39</sup>) dhe huanë në shumën 4.000 euro.

i. Në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore, Komisioni nuk do t'i përfshijë ato në analizë financiare, pasi nuk rezulton e provuar krijimi i tyre dhe pagimi i detyrimeve tatimore, për sa kohë subjekti nuk

<sup>37</sup> Subjekti ka depozituar: raport vlerësimi; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 30.5.2022, të shtetasit Dh.T; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 30.5.2022, të shtetasit Dh.T.

<sup>38</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022 dhe në seancë.

<sup>39</sup> Faqe 21-22 e raportit.

rezulton të ketë qenë i pajisur me kartën e fermerit dhe më pas, me ndryshimin e legjislacionit, të ketë qenë/të jetë i regjistruar si fermer pranë organeve tatimore<sup>40</sup>.

- ii. Në lidhje me pretendimin e subjektit se ai thjesht nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* në vlerën 305.641 lekë në vitin 2011, Komisioni nuk do ta marrë në konsideratë këtë pretendim, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>41</sup>. Nga shqyrtimi i deklaramëve ndër vite rezulton se subjekti ka qenë gjithmonë i saktë, për rrjedhojë, krijohet bindja se ai e ngre këtë pretendim, me qëllim rregullimin e rezultatit negativ në analizë financiare pas kalimit të barrës së provës.
- iii. Në lidhje me kryerjen e analizës financiare për të gjithë vitin 2011 dhe jo pjesore për shkak të përdorimit të gjendjes *cash*, Komisioni vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi analiza financiare është bërë për të gjithë vitin 2011.
- iv. Komisioni ka korrigjuar analizën financiare në lidhje me pagat e përfituar nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, duke iu referuar pagave të përfituara nga nxjerrja e llogarisë dhe jo nga vërtetimet e depozituara nga vetë subjekti.
- v. Në lidhje me moslikuidimin e shumës 13.127 euro, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi nuk ka asnjë pengesë ligjore që kjo shumë të depozitohet në bankë. Fakti që llogaritë bankare janë të bllokuara nuk pengon depozitimet e shumave në llogari, por vetëm përdorimin e tyre nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Subjekti nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore për depozitimet e kësaj shume në bankë, por dhe për nënshkrimin e një dokumenti ku të rezultonte se ai i detyrohej kësaj shoqërie ende shumën 13.127 euro.

Referuar shkresës nr.\*\*\* prot., datë 1.6.2022 të “Raiffeisen Bank” rezulton se mbi llogaritë bankare të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. është vendosur sekuestro konservative me urdhër të një shoqërie përmbarimore për një kredi të pashlyer kundrejt “Raiffeisen Bank”.

Vendosja e sekuestros mbi llogaritë bankare bazuar në udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2014 të Bankës së Shqipërisë “Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumatat e llogarive në bankë”, i cili ka dalë në zbatim të nenit 600 të Kodit Civil, nuk pengon depozitimet e shumave në llogari, por vetëm përdorimin e këtyre shumave nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Subjekti nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore për depozitimet e kësaj shume në bankë, por dhe për nënshkrimin e një dokumenti ku të rezultonte se ai i detyrohej kësaj shoqërie ende shumën 13.127 euro.

Në vlerësim të Komisionit, dhe sikur të merret i mirëqenë fakti që pagesa nuk është kryer për shkak të bllokimit të llogarive të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ky veprim i subjektit nuk është në përputhje me etikën e prokurorit, pasi në syrin e qytetarit duket se ai në mënyrë indirekte mund të ketë ndihmuar shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k për të mos ekzekutuar veprimet përmbarimore në lidhje me shlyerjen e kredisë që kjo shoqërisë ka ndaj “Raiffesien Bank”. Komisioni vlerëson se mospagimi i shumës 13.127 euro për shkak të bllokimit të llogarisë bankare të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k duhet të jenë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi subjektit duket se së paku në mënyrë indirekte mund të ketë ndihmuar këtë shoqëri për të mos deklaruar të ardhurat e saj reale, duke u bërë pengesë për mosekzekutimin e veprimeve përmbarimore.

**80.** Në përfundim, në lidhje me këtë pasuri, Komisioni vlerëson se edhe pas korrigjimit të analizës financiare, subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme, si më poshtë vijon:

- në shumën 221.845,46 lekë për të paguar këstin e apartamentit prej 5.000 euro;
- në shumën 170.173,87 lekë për të krijuar gjendjen *cash* në vitin 2006 dhe në shumën 179.415,75 lekë për vitin 2008;
- në shumën 349.589,62 lekë për shlyerjen pjesore të kredisë në vitin 2008;

<sup>40</sup> Për më shumë në lidhje me këto të ardhura referohuni në pikat 91-111 të vendimit.

<sup>41</sup> Shihni vendimet: nr. \*/2018; nr. \*/2018; nr. \*/2018; nr. \*/2018; nr. \*/2018; nr. \*/2018; nr. \*/2019; nr. \*/2019; nr. \*/2019; nr. \*/2019; nr. \*/2020; nr. \*/2020; dhe nr. \*/2020.

- në shumën 817.949,56 lekë për shlyerjen pjesore të kredisë në vitin 2011.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

**81. Garazh<sup>42</sup>, me sipërfaqe 45 m<sup>2</sup>**, në rrugën “Tefta Tashko”, Tiranë. Vlera: 11.000 euro. Detyrimi i palikuiduar: 1.000 euro. Pjesa takuese: 50%.

**Burimi sipas deklaratës *Vetting***: të ardhurat ndër vite, marrë hua babait 4.000 euro<sup>43</sup>.

**Konstatimi i ILDKPKI-së**: mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me huamarrjen e deklaruar nga babai në shumën 4.000 euro për blerjen e garazhit në vitin 2013, si dhe mosdeklaram i burimit të huadhënësit.

#### **Hetimi<sup>44</sup> dhe analiza financiaro-juridike e kryer nga Komisioni**

**82.** Në datën 13.4.2013 subjekti, me kontratën e premtimshitjes nr. \*\*\*, ka blerë garazh me sip. 45 m<sup>2</sup> për shumën 11.000 euro. Bazuar në nenin 3 të kontratës përcaktohet se është paguar shuma 10.000 euro, ndërsa shuma 1.000 euro do të paguhet me regjistrimin e garazhit në ZVRPP-në Tiranë. Në lidhje me shlyerjen e shumës 1.000 euro, gjatë hetimit subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit mandatin e datës 10.11.2021, të “Raiffeisen Bank”, për shlyerjen e shumës 1.000 euro. ASHK-ja ka konfirmuar se pasuria është në pronësi të subjektit të rivlerësimit, me nr. pasurie \*\*\*/ND-G\*\*, z. k. \*\*\*, por sipërfaqja është 69.6 m<sup>2</sup>. Kjo pasuri është regjistruar me leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 1.10.2020.

**83.** Komisioni, gjatë hetimit, konstatoi se sipërfaqja e garazhit ishte më e madhe se ajo e deklaruar në deklaratën *Vetting*, duke i kaluar barrën e provës subjektit.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, vuri në dispozicion të Komisionit shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.5.2022, të ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Veri, sipas së cilës sipërfaqja 69.6 m<sup>2</sup> është llogaritur së bashku me pjesën e mureve dhe pjesën e traut të pilotave për efekt konfigurimi, duke qenë se në sipërfaqe është përfshirë edhe pjesa e mureve. Në bazë të llogaritjeve pjesa pa mure do të rezultonte 47.5 m<sup>2</sup>.

**84.** Në lidhje me burimin e shumës 4.000 euro të marrë hua nga babai i tij, subjekti, gjatë hetimit<sup>45</sup>, sqaroi se në vitin 2013 është marrë shuma 4.000 euro nga babai dhe në vitin 2017 është marrë shuma 2.000 euro nga nëna. Huat janë marrë dorazi, pa akt noterial, bazuar në marrëdhënien prind-fëmijë. Burimi i të ardhurave kanë qenë kursimet e tyre. Për të provuar burimin e të ardhurave të prindërve të tij subjekti ka depozituar deklaratë noteriale<sup>46</sup> të nënës së tij H.Sh.

**85.** Burimi i ligjshëm i të ardhurave të prindërve të subjektit është trajtuar në pikat 167-169 të këtij vendimi, ku nga hetimi ka rezultuar se babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e shumës 4.000 euro, për rrjedhojë, kjo shumë nuk është përfshirë në analizën financiare.

#### **86. Analizë financiare**

**Tabela nr. 6.**

|                                  | <b>Datë 13.4.2013</b> |
|----------------------------------|-----------------------|
| <b>Pasuria</b>                   | <b>1,164,373.07</b>   |
| Garazh me sip. 45 m <sup>2</sup> | 1,542,310.00          |
| <i>Ndryshim likuiditeti</i>      | -377,936.93           |
| <b>Detyrime</b>                  | <b>2,623.84</b>       |

<sup>42</sup> Subjekti ka depozituar kontratë premtimshitjeje nr. \*\*\*, datë 13.4.2013.

<sup>43</sup> I njëjti deklaram është bërë edhe në DPV/2013.

<sup>44</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2021, drejtuar ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Veri; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2021, e ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Veri; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2021, drejtuar noterit publik A. M; shkresë kthim përgjigjeje datë 25.10.2021, e noterit publik M.M.

<sup>45</sup> Subjekti ka depozituar deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 20.10.2021, të znj. H.Sh.

<sup>46</sup> Shihni deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 7.3.2020.

|   |                     |
|---|---------------------|
| Shlyerje e kredisë në NBG Bank 46,000 euro      | -97,586.16          |
| Shlyerje detyrim ndaj shoqërisë “***” sh.p.k.   | -40,000.00          |
| Hua nga babai 4,000 euro, viti 2013             | 0.00                |
| Detyrim për garazhin                            | 1,542,310.00        |
| Shlyerje detyrim për garazhin                   | -1,402,100.00       |
| <b>Pasuria neto</b>                             | <b>1,161,749.23</b> |
| <b>Të ardhura</b>                               | <b>504,857.33</b>   |
| Të ardhurat e subjektit                         | 305,931.33          |
| Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit        | 198,926.00          |
| <b>Shpenzime</b>                                | <b>261,952.14</b>   |
| Shpenzime jetike                                | 164,528.00          |
| TIMS  | 0.00                |
| Shpenzime për taksat vendore të tokës bujqësore | 1,520.50            |
| Shpenzime për shkollimin e E.Sh, shkolla “F.K”  | 95,903.64           |
| <b>Mundësia për kursime</b>                     | <b>-918,844.04</b>  |

Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 918.844,04 lekë për të blerë pasurinë garazh, duke iu kaluar barra e provës.

**87.** Pas kalimit të barrës së provës<sup>47</sup> subjekti sqaroi se shuma 4.000 euro i është dhuruar nga babai në vitin 2013, fakt i pasqyruar saktësisht në deklaratën *Vetting*. Ai ka pretenduar se në analizën financiare të kryer nga Komisioni janë konsideruar të ardhura financiare të prindërve të tij vetëm të ardhurat e 3 muajve të parë të vitit 2013 nga pensionet e tyre, duke mos marrë në analizë asnjë periudhë tjetër të mëparshme. Në këtë mënyrë Komisioni ka përlllogaritur analizën financiare të tyre sikur të ishte dita 0 (zero) e të ardhurave dhe e kursimeve, data 1.1.2013, kur ndërkohë prindërit e tij nuk kanë qenë asnjëherë subjekte të deklarimit vjetor periodik të pasurisë së tyre, në mënyrë që të bëhet llogaritja mbi bazë vjetore me kapital fillimviti 0 (zero) lekë. Nga viti 2007, kur është bërë shpenzimi i fundit i tyre për blerjen e një pasurie (të luajtshme apo të paluajtshme), deri në vitin 2013, kur është dhënë kjo hua, ata rezultojnë me një bilanc pozitiv në vlerën 781.008 lekë, rreth 223.000 lekë më e lartë se shuma prej 4.000 euro e dhënë hua. Përveç sa më sipër, nga informacioni i marrë nga Komisioni nga “Raiffeisen Bank” sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, rezulton se babai i subjektit në datën 22.8.2007 ka depozituar vlerën 100.000 USD, e cila është tërhequr pas rreth 1 viti, në vitin 2008. Në momentin e maturimit të depozitës ai ka përfituar interesa, në total në shumën 4.981 USD, që e konvertuar në monedhën euro me kursin e vitit 2013 rezulton në shumën 3835 euro. Në këto kushte, konkludon subjekti, analiza financiare për burimin e të ardhurave për blerjen e garazhit duhet të bëhet për të gjithë vitin 2013 e jo në datën e blerjes së garazhit sepse ai si subjekt ka pasur gjendje të likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2012, duke i përdorur në momentin e blerjes së garazhit dhe me të ardhurat nga pagat dhe prodhimet bujqësore i ka zëvendësuar deri në fund të vitit, duke mos pasur kështu ndryshim në gjendjen *cash* të likuiditeteve për vitin 2013.

**88.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e vëna në dispozicion nga subjekti, vlerëson se ato nuk janë bindëse, për sa më poshtë:

i) Në lidhje me huan në shumën 4.000 euro, subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të tij. Komisioni konstaton se edhe sikur kjo shumë të përfshihet në analizë financiare, ajo nuk e ndryshon rezultatin negativ.

ii) Në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore, sikundër është sqaruar më lart, ato nuk do të përfshihen në analizën financiare.

<sup>47</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022 dhe në seancë.

iii) Për sa i përket pretendimit të subjektit që të merret i gjithë viti kalendarik, Komisioni konstaton se në këtë rast pozita e tij do të rëndohej me rezultat negativ në vlerën 1.191.401,07 lekë.

**89.** Në përfundim në lidhje me pasurinë garazh, Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 918.844,04 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

**90.** Në lidhje me pasuritë:

**i. Llogari bankare<sup>48</sup> në vlerën 451.733,02 lekë** në “Raiffeisen Bank”. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura të kursyera nga paga deri në datën 24.1.2017.

**ii. Llogari bankare<sup>49</sup> në vlerën 810.043,92 lekë** në BKT. Pjesa: takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura të kursyera nga paga e bashkëshortes deri në datën 24.1.2017.

Nga hetimi ka rezultuar se subjekti ka qenë i saktë në deklaramin e tij.

**91. Në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore të deklaruara në deklaramin *Vetting***

**Konstatimi i ILDKPKI-së: a)** Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e deklaruara nga shfrytëzimi i tokës bujqësore në shumën 4.220.000 lekë. Institucionet e specializuara QKB, Tatime, ISSH nuk konfirmojnë të ardhura/aktivitet të regjistruar me drejtim bujqësor në emër të subjektit dhe të personave të lidhur me të. Në vitin 2016 Bashkia Tiranë konfirmon arë me sip. 5.240 m<sup>2</sup> në Njësinë Administrative Shëngjergj, të regjistruar në emër të subjektit Arben Sharra; b) lidhur me kursimet *cash* nga të ardhurat nga puna dhe shfrytëzimi i tokës bujqësore, subjekti ka deklarime të pasakta, konstatim bazuar në gjendjen e deklaruar vit pas viti me deklaramin në rivlerësim.

**Hetimi<sup>50</sup> dhe analiza financiaro-juridike e kryer nga Komisioni**

**92.** Subjekti ka deklaruar në deklaramin *Vetting* të ardhura nga shfrytëzimi ndër vite i banesës në K-K dhe të tokës bujqësore në emër të babait në fshatin Shëngjin të Njësisë Administrative Shëngjergj, në shumën 4.220.000 lekë<sup>51</sup>. Për të provuar këto të ardhura, të deklaruara ndër vite, subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion provues.

**93.** Nga hetimi ka rezultuar se në datën 11.8.1992, me AMTP-në nr. \*\*, babai i subjektit S.Sh ka përfituar 5.240 m<sup>2</sup> tokë bujqësore në fshatin Shëngjin. Bazuar në certifikatën familjare të datës 16.2.2016 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e trungut familjar të babait të tij në datën 1.8.1991, duke përfituar rrjedhimisht pjesë takuese nga kjo pasuri.

Nuk rezulton që kjo pasuri të jetë deklaruar në deklaramin *Vetting* nga subjekti.

**94.** Në lidhje me këtë konstatim, subjekti, në pyetësorin e datës 7.10.2021, ka sqaruar se e ka shprehur përdorimin e saj në të gjitha deklaramat periodike që ka depozituar çdo vit pranë ILDKPKI-së dhe në deklaramin *Vetting*. Për shkak se toka nuk është e regjistruar ende pranë ASHK-së dhe nuk është bërë ndarja e pjesëve takuese, ai e ka deklaruar çdo vit (si përdorues) si pronë të babait të tij të ndjerë, duke qenë se ai ishte kryefamiljar i familjes bujqësore në kohën kur u përfitua sipërfaqja e tokës. Në deklaramin *Vetting*, në

<sup>48</sup> Nxjerrje llogarie në “Raiffeisen Bank”.

<sup>49</sup> Subjekti ka depozituar nxjerrje llogarie në emër të shtetasve F.L dhe Arben Sharra në “Alpha Bank”, për periudhën 1.1.2016 – 23.1.2017.

<sup>50</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2020, e DPT-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, drejtuar QKB-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2020, e QKB-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2021, drejtuar Njësisë Administrative Shëngjergj; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2021, e Njësisë Administrative Shëngjergj; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2021, drejtuar Bashkisë Tiranë; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2021, e Bashkisë Tiranë.

<sup>51</sup> Subjekti i ka deklaruar të ardhurat e pretenduara nga toka bujqësore në deklaramat periodike vjetore që nga viti 2005 e deri në vitin 2016.



rubrikën “Përshkrimi i të ardhurave”, subjekti ka deklaruar të ardhura nga shfrytëzimi i tokës bujqësore në emër të babait, ndër vite, në shumën totale 4.220.000 lekë, pasi prindërit e tij, për shkak të moshës, ishin në pamundësi për ta shfrytëzuar tokën bujqësore dhe nga viti 2005 ia kanë lënë atij që ta shfrytëzojë.

**95.** Deklarimi i subjektit në lidhje me tokën bujqësore nuk përputhet me të dhënat e hetimit administrativ, pasi një pjesë e kësaj toke rezultoi e regjistruar në ASHK dhe nuk rezultoi që kjo pasuri të jetë deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike si në pronësi të babait të tij, sikundër pretendohet, por ka deklaruar vetëm të ardhurat e pretenduara të përfituara nga kjo tokë.

**96.** Organet tatimore<sup>52</sup> nuk konfirmojnë pagesën e detyrimeve tatimore apo regjistrimin e subjektit dhe familjarëve të tij.

**97.** QKB-ja<sup>53</sup> nuk konfirmon se subjekti apo familjarët e tij të jenë të regjistruar për ushtrimin e aktivitetit të shitjes së produkteve ushqimore apo për ushtrimin e ndonjë aktiviteti tjetër tregtar.

**98.** Komisioni i ka kërkuar informacion të detajuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në lidhje me shitjen e produkteve bujqësore dhe detyrimet tatimore për shitjen e këtyre produkteve. Në përgjigjen e saj nr. \*\*\* prot., datë 17.3.2022, DRT-ja Tiranë sqaron se:

- Bazuar në ligjin nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 4 citon: *“Veprimtari ekonomike është çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra ose shërbime, përfshirë veprimtarinë nxjerrëse, bujqësore dhe aktivitetet profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet gjithashtu shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm”.*
- Bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 4.1 citon: *“Në administratën tatimore regjistrohen personat juridikë, fizikë dhe individët e mëposhtëm: germa dh) fermeri...”.*
- Duke u nisur nga të dhënat e dërguara mbi qarkullimin në shumën 4.200.000 lekë për periudhën 2005 – 2016, detyrimet tatimore që duhet të paguajë subjekti janë sipas kërkesave të ligjit nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008”, Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 5 parashikon: *“Mosregjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore”.*

**99.** Për sa më sipër rezultoi se subjekti ka kryer veprimtari ekonomike, për të cilat duhet të paguante detyrime tatimore si më poshtë vijon:

- a. Bazuar në nenin 9, pika 1 e ligjit nr. 9632/2006 subjekti kishte detyrimin për të paguar taksën vendore për biznesin e vogël, e cila me ndryshimet e bërë në këtë ligj në vitin 2013 është emërtuar si tatim i thjeshtuar mbi biznesin e vogël. Ky detyrim është i ndryshëm nga detyrimi i parashikuara nga pika 3 e nenit 9 të po këtij ligji, që lidhet me detyrimet për taksat për pasuritë e paluajtshme ku përfshihet edhe toka bujqësore.
- b. Bazuar në nenin 9 të ligjit nr. 9136 subjekti, si i vetëpunësuar, kishte detyrimin për të paguar kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

**100.** Njësia Administrative Shëngjergj informon se familja e z. S.Sh ka përfutur tokë nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1992, me nr. akti \*\*, datë 11.6.1992, në masën 5240 m<sup>2</sup>. Nga verifikimi në terren dhe deklarimi i familjes bujqësore rezultoi se nga viti 2005 e në vazhdim kjo sipërfaqe toke është punuar dhe kultivuar me kultura bujqësore nga djali i tij Arben Sharra. Për vitet 1992 - 2007 toka bujqësore nuk ka qenë objekt i tatueshëm nga ish-komuna. Për vitet 2007 - 2015 subjekti ka paguar të gjitha detyrimet për taksën

<sup>52</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2020, e DPT-së.

<sup>53</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2020, e QKB-së.

bujqësore dhe taksën mbi ndërtesë<sup>54</sup>. Për vitin 2016 e në vijim, në mbështetje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe vendimeve nr. 59, datë 30.12.2015 dhe nr. 158, datë 26.12.2019, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” të Këshillit Bashkiak, ka bërë të gjitha likuidimet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, sipas vërtetimeve nr. A-\*\*\*, datë 28.1.2020 dhe nr. A-\*\*\*, datë 15.10.2021.

**101.** Bashkia Tiranë informon se subjekti Arben Sharra rezulton i regjistruar në programin e tyre informatik, me kodin vendor nr. \*\*\*, për llojin e pasurisë “arë” me sip. 5240 m<sup>2</sup>. Prona është në pronësi të z. S.Sh, por detyrimet vendore të pronës janë likuiduar dhe vazhdojnë të likuidohen nga z. Arben Sharra, prandaj regjistrimi i kësaj prone është kryer në emër të tij në programin informatik.

**102.** Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2022, të ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, rezulton se në emër të babait të subjektit janë regjistruar pasuritë e mëposhtme:

- pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit “arë” me sip. 520 m<sup>2</sup>, në Shëngjin, Tiranë;
- pasuri nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit “arë” me sip. 810 m<sup>2</sup>, në Shëngjin, Tiranë.

**103.** OSHEE-ja<sup>55</sup> konfirmon se në emër të babait të subjektit të rivlerësimit rezulton e lidhur kontratë energjie elektrike për një banesë përdhese me adresë Shëngjin, Shëngjergj, hapur më 2.4.2002. Nga historiku i pagesave rezulton se kjo banesë përdoret disa muaj në vit.

**104.** Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore, ka kryer deklaratimet e mëposhtme:

- i. Bazuar në procesverbalin e datës 25.1.2016<sup>56</sup>, “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaratimit të pasurive”, ka deklaruar se: *“Në Shëngjergj është toka e përfituar nga ligji nr. 7501 në emër të babait. Unë kam 1/7 pjesë... Përveç tokës së marrë me AMTP është edhe një sipërfaqe e konsiderueshme e babait e peregjistruar që shfrytëzohet pjesërisht. Toka shfrytëzohet nga unë, familja ime dhe babai, gjatë gjithë këtyre viteve. Kultivojmë rrush, kumbulla, misër, jonxhë dhe një pjesë perime. Këto prodhime i shesim në treg të lirë në Tiranë, unë dhe prindërit, pa dokument, vetëm me pagesën e taksës së vendit ku tregtohen. Edhe në tokën në Kamëz është e njëjta gjë...”*
- ii. Në pyetësin standard ka deklaruar se *taksat vendore të tokës bujqësore janë paguar nga ana e tij. Datat e shitjes së produkteve bujqësore janë të ndryshme për arsye se prodhimet bujqësore të përfituara si fruta të ndryshme (arra, gështenja, thanë, shegë qersh, rrush, kumbulla, ftonj, mollë etj.) raki, mjaltë, kanë periudha të ndryshme gjatë stinëve të vitit. Shitja e tyre është bërë në varësi të tregut dhe sasisë së prodhuara ndër vite dhe tatimi është paguar në momentin e shitjes së tyre në tregun ku bëhej shitja.*

Subjekti, së bashku me pyetësin standard, ka vënë në dispozicion:

- vërtetim nr. \*\* prot., datë 28.1.2020, të Njesisë Administrative Shëngjergj, ku deklarohet se: *“S. Sh ka përfituar me ligjin nr. 7501 një sipërfaqe toke prej 5240 m<sup>2</sup>, për të cilën është pajisur nga Njësia Administrative Shëngjergj, Tiranë, me aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. \*\*, datë 11.8.1992. Nga viti 2005 e në vijim kjo sipërfaqe është përdorur nga djali i tij Arben Sharra, ku ai ka likuiduar të gjitha detyrimet, konfirmuar kjo me vërtetimin nr. A-\*\*\* prot., datë 28.1.2020, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e aksave dhe tarifave vendore, Bashkia Tiranë”;*
- vërtetim nr. A-\*\*\* prot., datë 28.1.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, ku si subjekt rezulton z. Arben Sharra dhe deklarohet se: *“Subjekti ka likuiduar detyrimet vendore për vitin 2019 për pronën tokë arë me sip. 5240 m<sup>2</sup>, në adresën Njësia Administrative Shëngjergj, fshati Shëngjin”;*
- vërtetim nr. A-\*\*\* prot., datë 30.1.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, ku si subjekt rezulton z. Arben Sharra dhe deklarohet se: *“Subjekti ka*

<sup>54</sup> Për vitet 2007 - 2009 mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 24.9.2009; për vitet 2010 - 2011 mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 3.9.2011; për vitin 2012 mandatarkëtimi nr. \*\*, datë 12.10.2012; për vitet 2013 - 2014 mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 20.10.2014; për vitin 2015 mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 13.11.2015.

<sup>55</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2021, e OSHEE-së.

<sup>56</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2021, e ILDKPKI-së.

*likuiduar detyrimet vendore nga data e regjistrimit 1.1.2016 deri më 31.12.2019 për pronën tokë arë me sip. 5240 m<sup>2</sup>, në adresën Njësia Administrative Shëngjergj, fshati Shëngjin”.*

- iii. Në përgjigje të pyetësorit datë 7.10.2021, subjekti ka sqaruar se *të ardhurat që ka përfituar nga toka bujqësore nga viti 2005 deri në deklaratën Vetting janë në shumën 4.220.000 lekë. Pas deklaratës Vetting (2016) deri në vitin 2020 ka përfituar shumën prej 1.085.000 lekësh. Deri në plotësimin e deklaratës Vetting i ka shitur këto produkte në treg të lirë pa fatura, pasi ekonomia ishte në pjesën më të madhe informale. Pas vitit 2017 i ka shitur produktet në biznese të regjistruara, për të cilat ka marrë edhe kopje të faturave të lëshuara nga këto subjekte... Referuar legjislacionit tatimor, të ardhurat e përftuara nga shitja e produkteve bujqësore apo blegtorale nga individët fizikë (fermerët të cilët nuk janë të regjistruar dhe nuk janë të detyruar të regjistrohen në organin tatimor), janë të ardhura të cilat nuk i nënshtrohen pagesës së detyrimeve tatimore.*

Subjekti, për të provuar të ardhurat nga toka bujqësore, ka vënë në dispozicion të Komisionit:

- procesverbal datë 18.10.2021, të Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë (AREB), ku përcaktohet se në sipërfaqen 5240 m<sup>2</sup> të tokës bujqësore të subjektit janë mbjellë kultura bujqësore, duke cituar llojin dhe sasinë;
- shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2021, të Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë, ku jepet një vlerësim për prodhimet bujqësore të subjektit, duke iu referuar tokës bujqësore si fermë. Sipas kësaj shkrese totali i fitimit të fermës së subjektit është 988.728 lekë;
- dëftesë tatimore/faturë të thjeshtë tatimore të viteve 2018 - 2021 të subjekteve të ndryshme të cilëve subjekti iu ka shitur fruta të ndryshme si rrush, gështenja, arra.

**Nëpërmjet këtyre dëftesave provohet që subjekti i rivlerësimit ka kryer aktivitet tregtar, për të cilin nuk figuron të ketë qenë i regjistruar si fermer.**

**105.** Komisioni i ka kërkuar AREB-it të vendosë në dispozicion dokumentacionin e regjistrimit si fermer të subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e depozituar prej tij për të provuar të ardhurat nga toka bujqësore. Ky institucion, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 22.2.2022, ka informuar se:

i) Subjekti nuk është i pajisur me kartën e fermerit.

Ky fakt konfirmohet edhe nga DRT-ja Tiranë, e cila, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2022, deklaron se referuar të dhënave të sistemit individit Arben Sharra nuk rezulton të jetë regjistruar si fermer.

ii) Të dhënat me treguesit agroteknikë janë përlllogaritur nga kontot që përpilohen për çdo kulturë dhe vlera i referohet vitit bujqësor 2020 - 2021.

Lidhur me prodhimtarinë e produkteve bujqësore dhe fitimit të mundshëm të z. Arben Sharra për periudhën 2005 – 2016, AREB shprehet se nuk mund të bëjnë vlerësim, jo thjesht për faktin se z. Arben Shara nuk është pajisur me kartë, por në praktikën e punës së këtij institucioni, në të gjitha llojet e vlerësimit, kryen vlerësim vetëm për vitin bujqësor në momentin ku paraqitet kërkesa e të interesuarit.

iii) Në lidhje me shpenzimet, në po të njëjtën shkresë, ky institucion shprehet se në zërin shpenzime në masë 40% janë përfshirë shpenzimet agroteknike, të cilat listohen, ku ndër të tjera, përfshihet edhe energjia elektrike që përdoret për ujitje, mjetet motorike dhe nafta për mjetet motorike për punimin e tokës, etj. Referuar sipërfaqes së tokës dhe gjendjes faktike të fermës, sugjeron se këto shërbime mund të kryhen normalisht nga vetë pjesëtarët e familjes bujqësore, pa kërkuar fuqi punëtore.

**106.** Nga hetimi rezulton se subjekti nuk ka deklaruar të ketë në pronësi mjete motorike për punimin e tokës, si dhe nuk ka kontratë me OSHEE-në për furnizimi me energji elektrike në tokën bujqësore. Duke marrë në konsideratë faktin se prindërit e subjektit kanë qenë në pamundësi për të punuar tokën bazuar në shkresën e AREB, subjekti e ka pasur të pamundur të kryejë i vetëm të gjitha shërbimet e tokës bujqësore<sup>57</sup>.

<sup>57</sup> Vetëm për rrënjët e rrushit që janë 457 copë, për një rrënjë, bazuar në shërbimin agroteknik të pjergullës të vënë në dispozicion nga AREB, duhet spërkatje me pompë krahu 4 herë, ujitje 5 herë, plehërim 2 herë, krasitje 2 herë.

Nga verifikimi i deklaratave periodike, por edhe i deklaratës *Vetting*, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë se posedon tokë bujqësore apo se është bashkëpronar në këtë tokë bujqësore me 1/5 pjesë takuese. Në këto deklarata, por edhe në deklaratën *Vetting*, ai ka deklaruar vetëm të ardhurat e përfituara nga shfrytëzimi i kësaj toke.

**107.** Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, si më poshtë vijon:

- i. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* posedimin e pasurisë tokë bujqësore me sipërfaqe 5240 m<sup>2</sup>, si dhe bashkëpronësinë e tij me 1/5 pjesë takuese mbi këtë pasuri.
- ii. Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore, si dhe pagimin e detyrimeve tatimore përkatëse për këto të ardhura.
- iii. Duket e paqartë se si subjekti ka mundur të kryejë i vetëm të gjitha shërbimet e tokës, duke marrë në konsideratë faktin se në të njëjtën kohë ka qenë i punësuar si prokuror në Dibër e më pas në Durrës.

Për rrjedhojë, të ardhurat e deklaruar nga subjekti si të përfituara nga shitja e produkteve bujqësore nuk do të përfshihen në analizë financiare.

**108.** Pas kalimit të barrës së provës<sup>58</sup> subjektit parashtrori<sup>59</sup> se vlerëson se e ka deklaruar përdorimin e tokës bujqësore sepse në çdo deklaratë vjetore periodike, duke filluar nga viti 2005, por edhe në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar të ardhura nga nga shfrytëzimi i tokës bujqësore në emër/pronësi të babait... Shërbimet e nevojshme për shfrytëzimin e tokës bujqësore nuk janë kryer vetëm prej tij, por edhe me ndihmën e familjarëve (bashkëshortes dhe fëmijëve) dhe të afërmeve. Për të krijuar një bindje më të plotë nga Komisioni, ai ka paraqitur edhe foto të prindërve në vitet 1995 - 2000, ku duket qartë se gjatë kësaj periudhe ata janë marrë me bujqësi dhe blegtori. Subjekti ka parashtruar se, referuar legjislacionit tatimor, të ardhurat e përfituara nga shitja e produkteve bujqësore apo blegtorale nga individët fizikë (fermerët të cilët nuk janë të regjistruar dhe nuk janë të detyruar të regjistrohen në organin tatimor) janë të ardhura të cilat nuk i nënshtrohen pagesës së detyrimeve tatimore, bazuar në parashikimet e pikës 11 të nenit 8/1 “Të ardhura të përjashtuara” të ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimi mbi të ardhurat”.

**109.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e depozituar nga subjekti, vlerëson se ato nuk janë bindëse, për sa kohë subjekti nuk plotësonte kriterin parësor të kualifikimit si fermer. Organet shtetërore kanë konfirmuar faktin se subjekti nuk ka qenë asnjëherë fermer, për rrjedhojë e gjithë baza ligjore dhe të gjitha vendimet analoge të cituara nga subjekti nuk mund të zbatohet në rastin e tij. Subjekti gjatë hetimit, por dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit nuk ka depozituar asnjë dokument provues, që të vërtetojë se ai apo familjarët e tij kanë përfituara të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore si dhe të kenë paguar detyrimet tatimore përkatëse. Në lidhje me aktin e ekspertimit të depozituar nga subjekti, Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë për arsyet e trajtuara në pikën 53.

**110.** Në lidhje me shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të depozituar nga subjekti, Komisioni vlerëson të mos e marrë në konsideratë, pasi në këtë shkresë trajtohet tatimi mbi të ardhurat personale, duke mos iu referuar situatës faktike të subjektit, i cili nuk rezulton të ketë qenë i regjistruar si fermer, si dhe të ketë paguar kontributet si i vetëpunësuar në bujqësi. Në këtë shkresë citohet se të ardhurat nga aktiviteti bujqësor nuk trajtohet si të ardhura nga veprimtaria ekonomike bazuar në ligjin nr. 9632/2006. Ndërkohë, Komisioni, në shkresën dërguar Drejtorisë Rajonale Tiranë, ka cituar situatën faktike të subjektit, i cili rezulton të mos ketë qenë/jetë i regjistruar si fermer. Në përgjigjen e saj DRT-ja Tiranë, bazuar në të ardhurat e pretenduara nga subjekti, duke iu referuar ligjit nr. 92/2014, ku në nenin 4 veprimtaria bujqësore konsiderohet si veprimtari ekonomike dhe nenit 4.1 të ligjit nr. 9920/2008, sipas së cilit në administratën

<sup>58</sup> Subjekti ka depozituar dokumentacion të ri: certifikatë familjare të tij dhe të familjarëve; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2022, të Njesisë Administrative Shëngjergj, sipas së cilës shtetasi M dhe M.L janë banorë të Njesisë Administrative Shëngjergj; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2022, të Njesisë Administrative Shëngjergj, sipas së cilës shtetasi B dhe I.D janë banorë të Njesisë Administrative Shëngjergj; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2022, të Njesisë Administrative Shëngjergj, sipas së cilës shtetasi F, R, F dhe Xh.K janë banorë të Njesisë Administrative Shëngjergj; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2022, të Njesisë Administrative Shëngjergj, sipas së cilës shtetasi N, Q, E dhe I.K janë banorë të Njesisë Administrative Shëngjergj; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2022, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

<sup>59</sup> Për më shumë, referohuni në rapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022 dhe në seancë.

tatimore regjistrohen fermerët, është shprehur se subjekti duhet të paguajë detyrime tatimore sipas ligjit nr. 9632/2006.

**111.** Në përfundim, Komisioni, duke u bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>60</sup>, vlerëson se pretendimet, prapësimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për krijimin e të ardhurave nga kultivimi i kulturave bujqësore mbetën në nivel deklarativ dhe nuk gjetën mbështetje në dokumentacion, për rrjedhojë, ato nuk do të përfshihen në analizën financiare. Në këtë konkluzion Komisioni bazohet edhe në faktin që subjekti nuk provoi të ketë qenë i regjistruar si fermer, si dhe të ketë paguar detyrimet përkatëse tatimore për shitjen e produkteve bujqësore në treg të lirë (për sa kohë nuk ka qenë i regjistruar si fermer).

**112.** Në lidhje me argumentimin e subjektit për mosdeklarimin e posedimit të tokës bujqësore dhe pronësisë së saj në deklaratën *Vetting*, Komisioni vlerëson se shpjegimet e tij nuk janë bindëse dhe se, bazuar në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, kishte detyrimin ligjor për të deklaruar saktë pasurinë tokë bujqësore, 1/5 e të cilës e kishte fituar nëpërmjet AMTP-së dhe pjesën tjetër e kishte në posedim.

**113.** Për sa më sipër rezulton se në lidhje me tokën bujqësore dhe të ardhurat e krijuar prej saj subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, referuar parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 . Në këto kushte, të ardhurat nga toka bujqësore nuk janë përfshirë në analizë financiare.

**114.** Bazuar në shkresën e Njësisë Administrative Shëngjergj rezulton se subjekti ka paguar taksën vendore për tokën bujqësore, si dhe për një ndërtesë, për të cilën OSHEE-ja konfirmon kontratën e furnizimit me energji elektrike në emër të babait të subjektit të rivlerësimit. Në lidhje me këtë ndërtesë, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 13.1.2022<sup>61</sup>, ka sqaruar se banesa për të cilën ka paguar taksë pranë kësaj njësie është banesa e vjetër e gjyshërve dhe prindërve të tij. Këtë taksë ai ka qenë i detyruar për ta paguar, pasi pagesa e taksës së tokës bujqësore që ka në përdorim dhe taksa e ndërtesës bëhej në të njëjtin mandatarkëtim. Banesa është ndërtuar rreth vitit 1964 nga gjyshërit, xhaxhai dhe babai i tij. Ajo është një shtëpi dykatëshe, e ndarë në dy pjesë, ku gjysma e saj i është dhënë xhaxhait të tij (të ndjerit) R.Sh dhe gjysma tjetër babait të tij (të ndjerit) S.Sh. Kjo banesë nuk është poseduar prej tij dhe, ashtu siç ka shpjeguar në pyetësorin nr. 1, në tokën bujqësore që ka në posedim nuk ka ndërtim. Shtëpia e vjetër është jashtë gjurmës së tokës bujqësore, pasi është ndërtuar shumë vite përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 dhe ndarjes së tokës bujqësore (në dijeninë e subjektit rreth vitit 1964).

**115.** Nga verifikimi i ortofotove dixhitale në portalin ASIG të kësaj banese, si dhe nga verifikimi në *google maps* rezulton se ajo ndodhet në parcelën nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ngjitur me tokën bujqësore të subjektit të rivlerësimit. Nga të dhënat e administruara nga sistemi i ASHK-së rezulton se parcela me nr. \*\*\* është e regjistruar si pemëtore me sip. 200 m<sup>2</sup> dhe si truall me nr. pasurie \*\*\* me sip. 300 m<sup>2</sup>. Nga pamjet në *google maps* duket se përveç banesës në truallin me sip. 300 m<sup>2</sup> ndodhen edhe disa ndërtime të tjera. Duke iu referuar pamjeve të viteve 2007, 2015 dhe 2022 konstatohet se banesa, së bashku me tokën bujqësore të subjektit, duket se përbëjnë një pasuri të vetme, tek e cila është investuar vazhdimisht. Fillimisht, në vitin 2007 banesa nuk ka qenë në të njëjtën formë si në vitin 2022, ku nga pamjet në *google maps* rezulton se ajo është zgjeruar. Toka bujqësore dhe ndërtime rreth banesës duket se kanë pësuar ndryshime, pasi në vitin 2015 ka ndryshim të sipërfaqes së ndërtimit dhe të tokës bujqësore. Në vitin 2015 duket se është hapur edhe rruga, e cila në vitin 2007 nuk ka qenë. Në vitin 2022, pra aktualisht, ka sërish ndryshime në të gjithë sipërfaqen e pasurisë.

**116.** Subjekti, në lidhje me konstatimet e mësipërme, në përgjigje të pyetësorit të datës 24.3.2022, ka sqaruar<sup>62</sup> se objektet në krahun e poshtëm të majtë të banesës (pjesë e sipërfaqes takuese të xhaxhait të tij

<sup>60</sup> Vendimet nr. \*\*/2021, nr. \*/2020 dhe nr. \*\*/2020.

<sup>61</sup> Subjekti ka vënë në dispozicion: (i) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 31.1.2022, të znj. H.Sh; (ii) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2022, të Njësisë Administrative Shëngjergj; (iii) vërtetim nr. A-\*\*\*prot., datë 26.1.2022, të Bashkisë Tiranë, sipas së cilit subjekti është regjistruar vetëm për pronën tokë “arë” me sip. 5.240 m<sup>2</sup>; (iv) foto të banesës ku konstatohet se është e rikonstruktuar.

<sup>62</sup> Subjekti ka vënë në dispozicion: (i) foto të kësaj pasurie, por të cilat nuk janë të plota dhe nuk janë bërë sipas kërkesave të dërguara në pyetësor; (ii) planrilevim të pasurive në z. k. \*\*\*, nr. \*\*\*, me sip. 1160 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*, me sip. 110 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*, me sip. 1240 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, me sip. 400 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*, me sip. 610 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\*, me sip. 520 m<sup>2</sup>; dhe nr. \*\*\*, me sip. 1200 m<sup>2</sup>;

të ndjerë) janë objekte ekzistuese të hershme (kasolle bagëtish), të cilat kanë pësuar ndryshime në formë për shkak të rinovimeve të tyre. Çdo ndryshim i dukshëm në foto ka të bëjë me sistemime oborri, riparime të mureve të gurit, si dhe rinovime të çatisë dhe soletës së vjetër. Të gjitha punimet (sistemimi i oborrit, riparimi i mureve rrethues të gurit, rifreskimi i fasadës së jashtme të banesës dhe riparime të pjesëve të çatisë dhe soletës) janë bërë në periudha të ndryshme në vitin 2017 e në vijim dhe për të cilat nëna e tij H.Sh (për riparimet dhe sistemimet në pjesën takuese të babait të ndjerë) ka bërë njoftimin e Njesisë Administrative Shëngjergj për kryerje punimesh që nuk kërkojnë leje ndërtimi. Subjekti ka sqaruar se nuk ka dijeni se sa ka qenë kostoja totale e tyre dhe as nëna e tij nuk ka ruajtur dokumentacion provues (fatura) për koston e punimeve, pasi janë bërë në periudha të ndryshme kohore në vazhdimësi. Burimi i ligjshëm i të ardhurave për kryerjen këtyre punimeve të jashtme nga nëna e tij në banesën e vjetër të babait ka qenë një pjesë e shumës së marrë nga shitja e banesës në K-K.

**117.** Në përfundim në lidhje me këtë banesë, por edhe të gjithë sipërfaqen e tokës bujqësore përreth saj, e cila pjesërisht i është dhënë babait të subjektit me AMTP, duke marrë në konsideratë faktet e mëposhtme:

- i. toka bujqësore posedohet dhe shfrytëzohet nga subjekti i rivlerësimit;
- ii. banesa, së bashku me ndërtimet e tjera dhe tokën bujqësore në posedim të subjektit, duket se përbën një pasuri të vetme në të cilën është investuar vazhdimisht;
- iii. nga verifikimi i bërë në sistemin e ASHK-së *online* duket se një pjesë e tokës bujqësore të pretenduar nga subjekti në posedim të tij, për të cilët ka depozituar planrilevimet e mësipërme, është e regjistruar në emër të shtetasve të mëposhtëm:
  - pasuria nr. \*\*\*, me sip. 500 m<sup>2</sup> dhe nr. \*\*\*, me sip. 1000 m<sup>2</sup>, në emër të shtetasit I.Sh;
  - pasuria nr. \*\*\*, me sip. 640 m<sup>2</sup>, në emër të z. R.S;
  - pasuria nr. \*\*\*, me sip. 650 m<sup>2</sup>, në emër të z. Sh.T;
- iv. subjekti ka refuzuar të paraqesë foto të plota të kësaj pasurie ku të dilte qartë sipërfaqja e brendshme dhe e jashtme e çdo ndërtimi, si dhe foto panoramike të gjithë pasurisë ku të dilnin qartë të gjithë ndërtimet nga jashtë dhe pozicionimi i tyre me rrugën. Gjithashtu, duke iu referuar pamjeve të ASIG, duket se në krahun e banesës së pretenduar në pronësi të nënës së subjekti ka ndërtime në pjesën anësore dhe ballore të saj;
- v. bazuar në historikun e pagesave të energjisë elektrike konstatohet se kjo banesë është përdorur, pasi rezulton konsum i energjisë elektrike;
- vi. subjekti nuk ka depozituar dokumentacion nga ASHK-ja për të provuar bashkëpronësinë e babait të tij me shtetasin I.Sh;
- vii. subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues që një pjesë e banesës i përket z. I.Sh;
- viii. OSHEE-ja ka konfirmuar se për këtë banesë kontrata është e lidhur z. S.Sh;
- ix. detyrimet vendore për këtë banesë deri në vitin 2015 janë paguar nga subjekti i rivlerësimit;
- x. banesa rezulton e rikonstruktuar me materiale izoluese të kohës;
- xi. bazuar në deklaratimet e subjektit, por edhe në dokumentacionin e administruar, rezulton që kjo banesë është në funksion të tokës bujqësore të poseduar nga subjekti;
- xii. burimi i përdorur për rikonstrukcionin e kësaj banesa ka qenë shuma 75.000 euro e përfituar nga shitja e banesës së subjektit të rivlerësimit;

---

(iii) shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2021, e Njesisë Administrative Shëngjergj, ku njofton nënën e subjektit se në objektin e saj njësi shërbimi nuk është e nevojshme pajisja me leje ndërtimi apo deklaratë paraprake punimesh për riparimin e murit mbajtës në pjesën e oborrit; (v) shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2017, e Njesisë Administrative Shëngjergj, ku njofton nënën e subjektit se për të kryer punime për sistemim oborri dhe riparim muri rrethues në objektin shtëpi banimi këto punime nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi.

- xiii. moshën e thyer të prindërve të subjektit dhe mungesën e burimeve të ligjshme të të ardhurave për mbulimin e shpenzimeve të rikonstruksionit;
- xiv. mosdeklarimin në mënyrë të saktë dhe të plotë të pasurisë tokë bujqësore gjatë hetimit administrativ;
- xv. mosdeklarimin në deklaratën *Vetting* të posedim të tokës bujqësore;
- xvi. subjekti nuk ka çelur ende trashëgiminë ligjore të babait të tij, duke përjashtuar nga posedimi trashëgimtarët e tjerë ligjorë, tri motrat e tij dhe vëllain,

Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, me dyshimin se duket se kjo banesë, së bashku me ndërtimet e tjera dhe tokën bujqësore, kanë qenë në posedim të subjektit të rivlerësimit, i cili ka kryer edhe investime të vazhdueshme. Për rrjedhojë, subjekti duket se ka kryer fshehje të pasurisë, duke mos deklaruar posedimin e banesës dhe tokës bujqësore, një pjesë e të cilës nuk përfshihet në AMTP, si dhe të investimeve të kryera ndër vite për këto pasuri.

**118.** Pas kalimit të barrës së provës<sup>63</sup>, subjekti<sup>64</sup> paraqiti kryesisht të njëjtat shpjegime si gjatë hetimit administrativ, duke shtuar se edhe djali i xhaxhait të tij I.Sh ka një kontratë aktive energjie në këtë banesë, që provon faktin se ½ i përket atij, i cili jeton gjatë gjithë kohës atje. Punimet për rinovime janë kryer nga bashkëshorti i motrës së tij. Subjekti ka theksuar se banesa në Njësinë Administrative Shëngjergj nuk është në posedim të tij.

**119.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e depozituar nga subjekti, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti ka tentuar të paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri, si dhe nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit foto të pamjes së brendshme dhe të jashtme të ndërtimeve që ndodhen përreth banesës dhe foto panoramike të të gjithë pasurisë ku të dilnin qartë ndërtimet nga jashtë dhe pozicionimi i tyre me rrugën, duke u bërë pengesë për Komisionin për një vlerësim të gjendjes faktike të banesës dhe tokës bujqësore përreth saj në posedim të subjektit. Trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti ka pasur për qëllim që procesi i kontrollit të verifikimit të pasurisë, duke mos depozituar fotot e kërkuara, të prodhojë një rezultat në favor të tij. Kjo mungesë bashkëpunimi e ka vendosur Komisionin në kushtet e pamundësisë për kryerjen e plotë dhe të detajuar të procesit të rivlerësimit. Nga hetimi i Komisionit është provuar që subjekti ka paguar detyrimet përkatëse për këtë banesë deri në vitin 2015. Gjithashtu, sipas vetë deklarimeve të subjektit, si burim për rikonstruksionin e kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e banesës në pronësi të tij në K-K. Subjekti, gjatë hetimit, por edhe pas kalimit të barrës së provës, ka pretenduar se nëna e tij është marrë me rikonstruksionin e banesës, duke deklaruar se punimet janë kryer nga burri i motrës së tij, ndërkohë ka pranuar që rrugën për aksesin në këtë banesë e ka hapur ai në vitin 2015, pasi kjo rrugë shërbente për kalimin edhe në tokën bujqësore të tij. Nga verifikimi i fotove të depozituar nga subjekti, edhe pse nuk janë të plota, duket qartë që kjo banesë është brenda murit rrethues të tokës bujqësore në posedim të subjektit, e cila nuk rezulton e deklaruar në deklaratën *Vetting*. Nga pamjet në *google maps* duket se banesa ka pësuar ndryshime ndër vite, si dhe pranë saj ndodhen edhe disa ndërtime të tjera.

**120.** Në lidhje me këtë pasuri, referuar konstatimeve në pikën 117 të këtij vendimi, Komisioni vlerëson se banesa, së bashku me ndërtimet e tjera dhe tokën bujqësore në posedim të subjektit, përbën një pasuri të vetme në të cilën është investuar vazhdimisht. Kjo banesë është brenda murit rrethues të tokës bujqësore

<sup>63</sup> Subjekti ka depozituar: aktverifikimin sipas së cilit objekti shtrihet në z. k. \*\*\* dhe ka numër pasurie \*\*\*; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 30.5.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1; vërtetim debiti nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2022, të FSHU-së në lidhje me kontratën e energjisë elektrike për banesën në Shëngjergj; vërtetim debite nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2022, të FSHU-së, sipas së cilës shtetasi I.Sh ka një kontratë të hapur në Njësinë Administrative Shëngjergj, Tiranë; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2022, e Njësisë Administrative Shëngjergj, sipas së cilës shtetasi I.Sh është banor i fshatit Shëngjin të Njësisë Administrative Shëngjergj dhe së bashku me familjen e tij ka një shtëpi që ndodhet në zonën kadastrale \*\*\*, e cila ka kullm të përbashkët me shtëpinë e shtetasit S.Sh. mure ndarëse të përbashkëta dhe ndodhet në të njëjtin truall; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2022, e Njësisë Administrative Shëngjergj; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2022, e Njësisë Administrative Shëngjergj; foto të cilat nuk pasurojnë një panoramë të qartë të kësaj pasurie.

<sup>64</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022 dhe në seancë.

të subjektit të rivlerësimit dhe, rrjedhimisht, pjesë përbërëse e saj. Në këto kushte, duke marrë në konsideratë: (i) faktin që kjo pasuri është rikonstruktuar me të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës në K-K të subjektit; (ii) moshën e thyer dhe pamundësinë e nënës së subjektit; (iii) refuzimin e subjekti për të dhënë shpjegime të qarta dhe të plota në lidhje me të gjitha ndërtimet e ndodhura në truallin ku ndodhet kjo banesë; (iv) refuzimin e subjektit për të deklaruar vlerën e investimeve të kryera nga nëna e tij dhe për të depozituar dokumentacionin përkatës, duke qenë se koha e kryerjes së tyre është viti 2021; si dhe (v) faktin se ai është sjellë si pronar me këtë banesë duke paguar detyrimet deri në vitin 2015, rrethuar tokën bujqësore së bashku me këtë banesë, si dhe duke hapur rrugën, Komisioni krijon bindje se kjo pasuri është në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

Për sa më sipër, subjekti ka kryer fshehje të pasurisë, në kuptim të nenit 33/5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

**121.** Në lidhje me shitjen në treg të produkteve bujqësore personalisht nga subjekti, Komisioni ka kryer vlerësimin bazuar në: (i) nenin 149/ç të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; (ii) nenin 39 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizuar me ligjin nr. 96/2016; (iii) nenin 12 të urdhrin nr. 141, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Mbi miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”; (iv) nenin 9 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Nga analiza e dispozitave të mësipërme konstatohet se deri në vitin 2016 nuk lejohej dypunësimi për prokurorët, ndërsa me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016 duket se magjistrati ka të drejtë të shkruajë, të publikojë, të japë leksione dhe mësimdhënie për çështjet ligjore dhe të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me çështje ligjore, sistemin ligjor, administrimin e drejtësisë dhe çështje të tjera të lidhura me to, edhe jashtë orarit të punës, por ai nuk mund të ushtrojë aktivitet ekonomik duke shitur produkte bujqësore. Për sa më sipër, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi duket se ushtrimi i veprimtarisë ekonomike të shitjes së produkteve bujqësore prej tij është në papajtueshmëri me detyrën e prokurorit.

**122.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti<sup>65</sup> sqaroi se përdorimi i tokës bujqësore dhe shitja e produkteve të prodhuara nga pemët e mbjella mbi tokën bujqësore, kur janë në një masë të vogël, nuk konsiderohet veprimtari ekonomike e mirëfilltë. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në interpretimin që ka bërë për tatueshmërinë e të ardhurave nga toka bujqësore, ka shpjeguar legjislacionin, duke theksuar se legjislacioni fiskal specifikon se “për shitjen e produkteve bujqësore deri në 5.000.000 lekë fatura lëshohet nga blerësi, i cili është ushtrues i veprimtarisë tregtare”. Pra, blerësi i mallrave bujqësore është ushtrues i veprimtarisë tregtare dhe jo personi fizik që shet mallra bujqësore.

**123.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Shkresa e DPT-së e referuar nga subjekti i rivlerësimit lidhet me ushtrimin e veprimtarisë nga ana e fermerëve të regjistruar rregullisht në organet tatimore dhe jo të shitësve në tregun e lirë, sikundër ka deklaruar subjekti. Komisioni vlerëson se shitja e produkteve bujqësore në treg<sup>66</sup> nga një prokuror i Republikës së Shqipërisë (i cili nuk ka paguar detyrimet tatimore përkatëse, për sa kohë nuk ka qenë i regjistruar si fermer), jo vetëm që është në papajtueshmëri me detyrën e prokurorit, por është sjellje joprofesionale dhe joetike, e cila diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit, si dhe dëmton besimin e publikut në sistemin e prokurorisë.

Për sa më sipër, Komisioni do ta konsiderojë këtë vlerësim si pjesë të vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

**124.** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.10.2021, ka deklaruar se ka në posedim edhe një sipërfaqe prej 5336 m<sup>2</sup> që nga viti 2005, të cilën e posedon në tagrin e përdoruesit. Pas vitit 1944, me reformat e kryera nga qeveria e asaj kohe, u hoq drejta e pronës private dhe prej asaj kohe ajo figuron si tokë shtet në zyrat e Kadastrës. Në vitin 2020, sipas ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ai ka aplikuar për regjistrimin e kësaj sipërfaqeje toke në emrin tij.

Në lidhje me sipërfaqen e tokës në posedim, subjekti ka depozituar:

<sup>65</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022 dhe në seancë.

<sup>66</sup> Në përgjigje të pyetësorit 1 në pyetjen 2, germa “e”, subjekti ka deklaruar: “Deri në plotësimin e deklaratës Vetting unë i kam shitur këto produkte në treg të lirë pa fatura, pasi ekonomia ishte në pjesën më të madhe informale”.



- planrilevimin e pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ku si përdorues rezulton subjekti me sipërfaqe 1294 m<sup>2</sup>;
- planrilevimin e pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ku si përdorues rezulton subjekti me sipërfaqe 1286 m<sup>2</sup>;
- planrilevimin e pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ku si përdorues rezulton subjekti me sipërfaqe 2142 m<sup>2</sup>;
- planrilevimin e pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ku si përdorues rezulton subjekti me sipërfaqe 614 m<sup>2</sup>.

**125.** Bazuar në përgjigjet e subjektit të rivlerësimit rezulton që ai, duke filluar nga viti 2005, ka poseduar dhe shfrytëzuar një tokë bujqësore, e cila nuk i përket atij apo familjarëve të tij, por i përket pronarit shtet. Kodi Penal, në nenin 200 të tij, pushtimin e tokës e klasifikon si kundërvajtje penale. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit kryen detyrën e prokurorit, duke marrë në konsideratë faktin që ai posedon një pasuri shtetërore prej 5336 m<sup>2</sup>, jo në përputhje me legjislacionin në fuqi, duket se ky veprim vjen në kundërshtim me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, parashikuar nga neni 4, pika 1 e ligjit nr. 96/2016. Gjithashtu, ky veprim i subjektit të rivlerësimit bie në kundërshtim edhe me rregullat e etikës dhe sjelljes së prokurorëve, të cilat, në nenin 10, pika 4, parashikojnë se prokurorët duhet të respektojnë ligjet dhe t'u binden në çdo kohë akteve të organeve ligjzbatuese.

**126.** Në lidhje me këtë fakt, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit: (i) duket se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe as në deklaratat periodike që ka në posedim tokë bujqësore me sip. 5336 m<sup>2</sup> në pronësi të shtetit; (ii) duket se subjekti ka kryer veprime që bien ndesh me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, për sa kohë ka poseduar pa asnjë akt ligjor një tokë bujqësore në pronësi të shtetit.

**127.** Pas kalimit të barrës së provës<sup>67</sup>, subjekti sqaroi<sup>68</sup> se gjyshi dhe paraardhësit e tij kanë jetuar në Shëngjergj dhe kanë pasur në pronësi shumë sipërfaqe toke. Toka kaloi në pronësi të shtetit dhe në administrim të kooperativave bujqësore. Pas vitit 1990, toka bujqësore u nda në bazë të parashikimeve të ligjit nr. 7501/1991, por në disa fshatra si Shëngjergji banorët morën në posedim edhe tokat që kishin në pronësi paraardhësit e tyre para vitit 1944.

**128.** Komisioni, pasi analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit, vëren se ai ka pasur në posedim një pasuri me sip. 5336 m<sup>2</sup>, për të cilën kishte detyrimin ligjor që në zbatim të Aneksit D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 ta deklaronte në deklaratën *Vetting*. Subjekti nuk rezultoi ta ketë deklaruar këtë pasuri dhe të ketë depozituar dokumentacionin përkatës. Për herë të parë kjo pasuri është deklaruar nga subjekti vetëm pas dërgimit të pyetësorit nga Komisioni. Nga hetimi, por edhe nga dokumentacioni i administruar, rezultoi se kjo pasuri në posedim të subjektit ka si pronar shtetin, pavarësisht pretendimeve të subjektit të cilat janë në nivel deklarativ, për sa kohë nuk ka një vendim të organeve kompetente për njohjen dhe kthimin e kësaj pasurie trashëgimtarëve të shtetasit H.Sh. Për rrjedhojë rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit posedon një pasuri shtetërore prej 5336 m<sup>2</sup>, jo në përputhje me legjislacionin në fuqi, veprim i cili vjen në kundërshtim me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit. Komisioni, për të mos rënduar pozitën e subjektit, nuk do të konsiderojë se ai posedon një sipërfaqe prej 58973 m<sup>2</sup>, sikundër është pretenduar prej tij pas kalimit të barrës së provës, por vetëm sipërfaqen prej 5336 m<sup>2</sup>, për të cilën i ka kaluar edhe barrën e provës.

**129.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*, në kuptim të nenit 33/5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, e cila mund të konsiderohet edhe si fshehje pasurie, në

<sup>67</sup> Subjekti ka depozituar: shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\*prot., datë 5.4.2022, e Këshillit të Qarkut Tiranë, sipas së cilës pasuria nr. \*\*\* me emërtimin popullor Z. i Sh, z. k. \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\*, me sip. 58973 m<sup>2</sup> mbivendoset në parcelën pa numër, e cila figuron e regjistruar në zërin kadastral pemëtoje, gjendja deri më 1.8.1991. Sipas planrilevimit bashkëlidhur shkresës rezultoi se përdorues dhe pretendues është shtetasi S.Sh i sipërfaqes 58973 m<sup>2</sup>; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2022, e Këshillit të Qarkut Tiranë, sipas së cilës nga kërkimi dhe verifikimi i kryer në dokumentacionin e vjetër të para vitit 1946 në arkivën e DAMT-së në librin nr. \*, faqe \*\*, nr. \*\*, rezultoi i regjistruar subjekti me emër H.Sh në katundin Shëngjin i Madh me të dhëna pronësie: tokë e punuar 9 dynym, livadhe 2 dynym, gjithsej 11 dynym; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2022, e Njësisë Administrative Shëngjergj, sipas së cilës pasuria me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\* me emërtim popullor Z i Sh, sipas inventarit të miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendim nr. 732, datë 1.9.2010, është e llojit pemëtoje. Sipas gjendjes faktike të vitit 1991 kjo pasuri rezultoi pemëtoje e mbjellë me varietetin kumbull tropojane dhe nga 1991 e në vijim është poseduar dhe përdorur nga shtetasi S.Sh dhe familja e tij, me pretendimin si pronë e vjetër e trashëguar. Kjo pasuri nuk është ndarë me ligjin nr. 7501; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2022, të Njësisë Administrative Shëngjergj.

<sup>68</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022 dhe në seancë.

kuptim të nenit 33/5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti nuk ka deklaruar posedimin e një toke bujqësore me sip. 5336 m<sup>2</sup>, për të cilën nuk ka asnjë të dhënë zyrtare nga organet shtetërore se në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* ka qenë në posedim të subjektit, duke bërë të pamundur evidentimin e kësaj pasurie nga Komisioni me dërgimin e shkresave institucioneve shtetërore. Për më tepër, kjo pasuri rezulton edhe aktualisht me pronësi shtet.

Komisioni vlerëson se përveç sa më sipër, subjekti ka kryer veprime që bien ndesh me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, për sa kohë ka poseduar pa asnjë akt ligjor një tokë bujqësore në pronësi të shtetit për të cilën nuk ka bërë as deklarinimin përkatës në deklaratën *Vetting*. Komisioni do ta konsiderojë këtë vlerësim si pjesë të vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

### **Në lidhje me automjetet<sup>69</sup>**

**130.** Në DPV/2003 subjekti deklaron *automjet tip “Mercedes-Benz”, viti i prodhimit 1988, në vlerën 2.000 euro, blerë në vitin 2003 me kursimet e familjes*. Në datën 9.9.2008 subjekti, me kontratën nr. \*\*\*\*, ka shitur automjetin tip “Mercedes-Benz \*\*”, me targa TR \*\*\*F, për shumën 400.000 lekë<sup>70</sup>.

**131.** Në datën 14.11.2008, me kontratën nr. \*\*\*, subjekti ka blerë automjetin tip “D.C”, me targa AA \*\*\* MF, për shumën 5.500 euro. Në DPV/2008 subjekti deklaron *blerje automjeti në datën 14.11.2008, në shumën 5.500 euro, me burim shitjen e automjetit dhe kursime të krijuara gjatë vitit 2008*. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të blerë këtë automjet.

**132.** Në datën 15.3.2016, me kontratën nr. \*\*\*, subjekti ka shitur automjetin tip “Mercedes-Benz” në shumën 3.800 euro. Shitja e automjetit nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti në DPV/2016, po ashtu, nuk rezulton që të ketë deklaruar kursime *cash* të realizuara nga shitja e tij. Ndërkohë, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* shitjen e këtij automjeti, duke i deklaruar si të ardhura, por nuk rezulton të ketë deklaruar kursime *cash*. Për rrjedhojë, të ardhurat e këtij automjeti nuk mund të shërbejnë për blerjen e automjetit të mëposhtëm.

**133.** Në datën 2.3.2017, me kontratën nr. \*\*\*, subjekti ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz” në shumën 7.000 euro. Në DPV/2017 subjekti nuk ka deklaruar burim. Ky automjet është blerë nga shtetasi B.D (vëllai i bashkëshortes së subjektit) në datën 15.6.2016, me kontratën nr. \*\*\*, për shumën 7.000 euro. Bazuar në deklaratën doganore import 4 të datës 2.6.2016 shitësi i automjetit e ka blerë këtë automjet në vlerën 13.000 euro dhe ka paguar detyrime në vlerën 367.850 lekë. Nga të dhënat e AMF-së rezulton se për këtë automjet është prerë policë sigurimi në emër të djalit të subjektit E.Sh, në cilësinë e përdoruesit, për periudhën 17.6.2016 – 16.6.2017. Nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se subjekti e ka përdorur këtë automjet së bashku me familjen e tij për të dalë nga Shqipëria në datat 2.7.2016, 3.7.2016 dhe 21.1.2017.

**134.** Në përgjigje të pyetësorit të datës 7.10.2021 subjekti ka sqaruar se *ai dhe djali i tij e kanë përdorur këtë automjet në ndonjë rast gjatë kohës që ka pasur në pronësi kunati i tij, i cili banon në Njësinë Administrative Shëngjergj dhe jetën e punën i ka të lidhura atje*. Për shkak të largësisë i ka kërkuar djalit të tij të merret me kryerjen e policës së sigurimit, duke qenë se ky i fundit është nipi i tij më i madh nga të gjithë nipërit e tjerë (të cilët janë të gjithë ende edhe sot minorenë) dhe gjithashtu fëmijët e tij bashkë me bashkëshorten nuk ishin të aftë për ta kryer atë shërbim, pasi nuk kanë leje drejtimi. Djali i tij ishte i vetmi që mund ta ndihmonte nga njerëzit e tij të afërt. Pas shitjes së automjetit gjatë vitit 2016 ai nuk dispononte makinë tjetër personale dhe për nevoja të ndryshme vetjake dhe familjare e ka përdorur në ndonjë rast. Me sa është vënë në dijeni nga kunati, ai e kishte blerë automjetin në shumën 7.000 euro, pasi gjatë transportit drejt Shqipërisë kishte pasur një defekt të rëndë në sistemin kryesor. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 20.10.2021, të shtetasit B.D, i cili deklaroi se: *“...në vitin 2016 ka blerë një automjet tip ‘Mercedes-Benz’ në shumën 7.000 euro... Automjeti, gjatë transportit, ka pësuar një defekt të madh në sistemin kryesor të makinës dhe kur është marrë në dorëzim nga ana e tij është blerë më një çmim tjetër*

<sup>69</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.01.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2020, e DPSHTRR-së.

<sup>70</sup> Deklaruar në DPV/2008.

nga ai që kishin rënë dakord...Gjatë vitit 2016 ia ka lënë herë pas here makinën nipit të tij E.Sh për t'i bërë shërbime të ndryshme makinës kur ishte e nevojshme. Kjo është arsyeja pse polica e sigurimit të makinës në vitin 2016 figuron në emrin e tij”.

**135.** Në lidhje me burimin, subjekti ka sqaruar se në vitin 2016 ka deklaruar gjendje *cash* vlerën 58.000 lekë dhe të ardhura nga toka bujqësore në vlerën 200.000 lekë. Shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” në vitin 2016 në vlerën 3.800 euro, e mospasqyruar prej tij në DPV/2016, është një harresë gjatë plotësimit të deklaratës, por kjo shitje është deklaruar në deklaratën *Vetting* në të njëjtin vit. Burimi i blerjes së këtij automjeti, siç edhe ka shpjeguar në pyetësin standard, kanë qenë të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” (3.800 euro), të ardhurat nga kursimet (nga paga + të ardhurat nga toka bujqësore 2016 - 2017 dhe huaja e marrë nga nëna 2.000 euro në vitin 2017).

**136.** Në pyetësin standard si burim për këtë automjet subjekti deklaron të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” dhe të ardhurat nga kursimet.

**137.** Në analizë financiare nuk do të përfshihet shuma 3.800 euro e përfituar nga shitja e automjetit, pasi nuk rezulton të jetë deklaruar si gjendje *cash* as në deklaratën *Vetting* as në DPV/2016. Subjekti deklaron në DPV/2016 gjendje *cash* në shumën 58.000 lekë dhe në deklaratën *Vetting*, plotësuar në datën 26.1.2017, nuk deklaron gjendje *cash*.

**Tabela nr. 7**

|   | <b>Datë 2.3.2017</b> |
|---|----------------------|
| <b>Pasuria</b>                                  | <b>874,650.00</b>    |
| Automjet “Mercedes-Benz” 2.3.2017               | 930,650.00           |
| <i>Ndryshim likuiditeti (shitesa/pakësime)</i>  | <i>-56,000.00</i>    |
| <b>Detyrime</b>                                 | <b>161,135.40</b>    |
| Detyrim ndaj ***së                              | 0.00                 |
| Shlyerje detyrimi ndaj ***-së                   | -104,764.60          |
| Hua nga nëna 2,000 euro                         | 265,900.00           |
| <b>Pasuria neto</b>                             | <b>713,514.60</b>    |
| <b>Të ardhura</b>                               | <b>552,226.50</b>    |
| Të ardhurat e subjektit                         | 316,092.00           |
| Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit        | 236,134.50           |
| <b>Shpenzime</b>                                | <b>160,224.54</b>    |
| Shpenzime jetike                                | 158,702.70           |
| TIMS  |                      |
| Shpenzime për taksat vendore të tokës bujqësore | 1,521.84             |
| <b>Mundësia për kursime</b>                     | <b>-321,512.64</b>   |

Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në shumën 321.512,64 lekë për blerjen e kësaj pasurie, duke iu kaluar barra e provës.

**138.** Në përfundim, në lidhje me këtë automjet, konstatohet se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka pranuar përdorimin e tij gjatë vitit 2016.
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur automjet gjatë vitit 2016, pasi e ka shitur në mars të vitit 2016.
- iii. Polica e sigurimit është lëshuar në emër të djalit të subjektit E.Sh menjëherë pas blerjes së këtij automjeti.
- iv. Subjekti ka dalë jashtë shtetit me këtë automjet gjatë viteve 2016 - 2017.
- v. Ky automjet është blerë nga shtetasi B.D (vëllai i bashkëshortes së subjektit) në një vlerë shumë më të ulët se vlera reale e blerjes së tij.
- vi. Subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti në pyetësin standard dhe në deklaratën *Vetting*.
- vii. Në vitin 2017, gati një muaj pas plotësimit të deklaratës *Vetting*, subjekti e ka blerë këtë automjet.
- viii. Subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme të të ardhurave për të blerë këtë automjet në vitin 2016 në vlerën e tij reale.

Për rrjedhojë, subjektit iu kalua barra e provës, pasi dukej se automjeti ka qenë në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

**139.** Pas kalimit të barrës së provës<sup>71</sup> subjekti dha të njëjtat shpjegime si gjatë hetimit administrativ, duke shtuar <sup>72</sup> se në DPV-në e vitit 2016 ka deklaruar gjendje *cash* për vitin 2016 në vlerën 56.000 lekë, në analizën financiare të kryer nga Komisioni ndryshimi i likuiditetit është konsideruar vetëm pakësimi i gjendjes *cash* prej 56.000 lekësh. Kjo shumë është gjendje *cash* e shtuar vetëm gjatë vitit 2016 dhe gjendja *cash* në fund të vitit 2016 nuk është 56.000 lekë por 862.310 lekë, e cila ka shërbyer për blerjen e automjetit dhe, si rrjedhojë, në analizën financiare duhet të përfshihet si ndryshim likuiditeti – 862.310 lekë dhe jo – 56.000 lekë. Automjeti ka kaluar në pronësinë e tij vetëm 35 ditë pas plotësimit të deklaratës *Vetting* dhe është deklaruar në DPV-në e vitit 2017. Vlera më e ulët e blerjes së automjetit nga kunati B. D lidhet me defektin që ka pësuar ky automjet gjatë ardhjes nga Gjermania, siç edhe e ka deklaruar në përgjigjet e tij të mëparshme.

**140.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e depozituar nga subjekti, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Në lidhje me deklaratat noteriale, Komisioni e ka shprehur qëndrimin e tij në këtë vendim në pikën 53.

Lidhur me situatën faktike të përdorimit të automjetit prej subjektit të rivlerësimit dhe djalit të tij të rezultuar gjatë hetimit, Komisioni, bazuar në vendimin nr. 12/2021, të Kolegjit<sup>73</sup>, vlerëson se ai kishte detyrimin të deklaronte këtë marrëdhënie në deklaratën *Vetting*, në zbatim të përcaktimeve të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, në të cilën jepet përkufizimi i fjalës “pasuri”, ku parashikohet se: “*Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit*”. Ky parashikim, i parë në harmoni me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, detyronte subjektin e rivlerësimit të deklaronte përdorimin e këtij automjeti si një pasuri në përdorim të djalit të tij (sjell detyrimin e subjektit të rivlerësimit për ta deklaruar si pasuri në përdorim përderisa nga policat e sigurimit, sipas sistemit të AMF-së, djali i tij rezultonte se kishte të drejta përdorimi mbi këtë automjet për periudhën e sigurimit 17.6.2016 – 16.6.2017,

<sup>71</sup> Subjekti ka depozituar: deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 4.6.2022, të shtetasit R.D; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 11.6.2022, të shitësit të automjetit K.B.

<sup>72</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022 dhe në seancë.

<sup>73</sup> Shihni paragrafin 27.10-11.

periudhë e cila përfshin brenda saj kohën e depozitimit të deklaratës së pasurisë *Vetting* në datën 26.1.2017).

Në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* nga aktet e hetimit provohet se djali i subjektit të rivlerësimit ka pasur në përdorim automjetin në fjalë, sikundër edhe rezultoi që të ketë pasur një policë sigurimi të vlefshme në këtë moment kohor. Kjo situatë çon në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në shkelje të detyrimit të deklarimit sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me pasuritë në përdorim. Gjithashtu, nga hetimi është provuar që ky automjet është përdorur nga subjekti për të dalë jashtë shtetit.

Nga sa u analizua më sipër, nga tërësia e rrethanave rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti në deklarimet periodike dhe atë *Vetting*. Përveç sa më sipër, duke marrë në konsideratë faktin se: (i) ky automjet vetëm pak ditë pas plotësimit të deklaratës *Vetting* nga subjekti ka kaluar në pronësi të tij, vlerës së ulët të blerjes së këtij automjeti nga subjekti, pasi, sikundër rezultoi edhe në rastin hipotetik që ky automjet të jetë blerë nga z. D në shumën 7.000 euro, ai ka kryer shpenzime të konsiderueshme për riparimin e tij; (ii) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e automjetit në vitin 2016 në vlerën e tij reale prej 2.153.360 lekësh; (iii) subjekti nuk ka pasur automjet gjatë vitit 2016; (iv) blerjes së këtij automjeti pas shitjes së automjetit të subjektit; (v) mosdeklarimit të përdorimit të këtij automjeti në pyetësonin standard dhe në deklaratën *Vetting* – Komisioni krijon bindje se ky automjet ka qenë në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

**141.** Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në vitin 2017, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi në deklaratën periodike të vitit 2016 ka deklaruar ekzaktësisht gjendje *cash* krijuar gjatë vitit 2016 në vlerën 58.000 lekë, ndërkohë, në deklaratën *Vetting*, nuk ka deklaruar gjendje *cash*. Pra, të ardhurat nga shitja e automjetit të subjektit në vitin 2016 nuk mund të përfshihen si kursime *cash* dhe, rrjedhimisht, nuk mund të jenë pjesë e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit në vitin 2017.

**142.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se në lidhje me automjetin tip “Mercedes-Benz” subjekti:

- i. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e tij, në kuptim të nenit 33/5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
- ii. Nuk ka kryer deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin, në kuptim të nenit 33/5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
- iii. Ka kryer fshehje të pasurisë automjet, në kuptim të nenit 33/5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

### **143. DETYRIME FINANCIARE**

- Detyrim ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 23.6.2008, në shumën 13.915 euro.
- Detyrim ndaj shtetasit A.R, sipas kontratës së premtimshitjes nr. \*\*\*, datë 13.4.2013, në shumën 1.000 euro.
- Detyrim ndaj babait për blerje garazhi në shumën 4.000 euro.

**Të tria këto detyrime janë trajtuar më lart.**

### **144. Në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të prindërve të subjektit**

Komisioni ka hetuar në lidhje me pasuritë që i përkasin prindërve të subjektit, por që lidhen drejtpërdrejt me të.

**145.** Subjekti, në pyetësonin standard, ka deklaruar se ka përdorur në raste të ndryshme të jetesës familjare automjetin në pronësi të nënës së tij nga viti 2017 dhe aktualisht.

Në lidhje me automjetin tip “Volkswagen”, nga hetimi ka rezultuar se bazuar në deklaratën doganore import \*, datë 28.7.2017, nëna e subjektit e ka blerë në Gjermani për shumën 5.750 euro dhe ka paguar detyrime tatimore në shumën 188.187 lekë.

Nga të dhënat e AMF-së rezulton se policat e sigurimit për këtë automjet janë prerë në emër të znj. H.Sh, ndërkohë, për periudhën 23.8.2017 – 22.8.2018 polica e sigurimit është prerë edhe nga djali i subjektit të rivlerësimit në cilësinë e përdoruesit.

**146.** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.10.2021, ka sqaruar se nëna e tij nuk disponon leje drejtimi. Që pas vdekjes së babait të tij në vitin 2016 gjendja e saj shëndetësore ka pësuar rënie graduale vit pas viti. Nisur nga mosha e thyer, aktualisht 82 vjeçe, ajo nuk mund të lëvizte më e vetme për nevojat e saj personale, shëndetësore apo për të vizituar të afërmit e saj, prandaj vendosi të blinte një makinë të vogël me të cilën i kërkoi djalit që ta mbante në përdorim dhe sa herë të kishte nevojë t'i gjendej pranë për t'i plotësuar nevojat e saj. Burimi i ligjshëm i të ardhurave të nënës së tij për blerjen e këtij automjeti ka qenë një pjesë e parave të fituara nga kontrata e shitjes së banesës në K-K, të cilat kanë qenë të depozituara në bankë. Automjetin e ka përdorur në ndonjë rast për nevoja të ndryshme në varësi të lëvizjeve të djalit të tij kur ai nuk ishte i disponueshëm. Automjeti është përdorur nga djali E, që nga momenti që është blerë nga nëna deri në shitjen e automjetit nga ana e saj.

**147.** Subjekti, në datën 7.4.2019, ka bërë aksident me këtë automjet, duke përplasur një këmbësore. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 23.4.2019 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me këtë aksident, pasi, sipas aktekspertimit, janë shkelur rregullat e qarkullimit nga ana e këmbësores.

**148.** Në përfundim, në lidhje me këtë automjet, Komisioni ka konstatuar se:

- i. Ky automjet është blerë me të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës së subjektit të rivlerësimit.
- ii. Ky automjet është përdorur nga djali i subjektit të rivlerësimit, por edhe nga vetë subjekti.
- iii. Duket se nëna e subjektit nuk është në gjendje ta përdorë këtë automjet personalisht.

Për rrjedhojë, duket se ky automjet ka qenë në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

**149.** Pas kalimit të barrës së provës për këto rezultate, subjekti<sup>74</sup> shpjegoi se në lidhje me pasuritë e hetuara nga Komisioni, prindërit e tij nuk mund të konsiderohen si persona të lidhur dhe, për këtë arsye, analiza e këtyre pasurive, në vlerësimin e tij, është kryer nga Komisioni tej objektit të hetimit. Periudha kur është blerë ky automjet nuk është objekt i hetimit të organeve të rivlerësimit. Automjeti është përdorur nga djali i tij E që nga momenti që është blerë nga nëna e tij deri në shitjen nga ana e saj.

**150.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Në lidhje me periudhën e rivlerësimit, subjekti është i saktë kur deklaroi se ajo është deri në plotësimin e deklaratës *Vetting*, por në këtë rast Komisioni e ka shtrirë hetimin pasi, së pari, si burim për këtë automjet kanë shërbyer të ardhurat nga një pasuri e deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe, së dyti, Komisioni dyshon se kjo është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, sepse nga i gjithë hetimi, në më shumë se një rast, subjekti është përpjekur që të justifikojë si pasurinë, ashtu edhe të ardhurat, duke përdorur prindërit e tij. Një ndër këto raste është edhe ky automjet, për të cilin nga hetimi, Komisioni krijon bindjen se ka qenë në pronësi të fshehur të subjektit për t'u përdorur nga djali i tij, sikundër është deklaruar nga subjekti. Ky automjet, së bashku me pasuritë e mëposhtme të prindërve të subjektit, do të jenë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

**151.** Nga hetimi<sup>75</sup> ka rezultuar se në datën 11.10.2007 babai i subjektit ka lidhur me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, duke porositur një apartament me sip. 60.16 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*A, të ndodhur në katin e pestë në objektin nr. \*, në rrugën “Tefta Tashko”, Tiranë. Në kontratë çmimi është caktuar 60.000 euro, i cili është paguar para lidhjes së kontratës në Bankën Amerikane në numrin e llogarisë të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. Paguesa konfirmohet nga nxjerrja e llogarisë<sup>76</sup> së shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. në datën 5.10.2007, në shumën 60.000 euro. Kjo pasuri, nga tabela në formatin *excel* të përdorur nga ASHK Tirana Veri, gjatë procesit të legalizimit rezulton në emër të subjektit të rivlerësimit, ndërkohë, për këtë pasuri është lëshuar

<sup>74</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022 dhe në seancë.

<sup>75</sup> Shihni shkresën nr. K-\*\*\*., datë 3.2.2020, të UKT-së.

<sup>76</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2021, e “Intesa Sanpaolo Bank”.

leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 1.10.2020, me nr. pasurie \*\*\*, me sip. 56.5 m<sup>2</sup>, në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit.

**152.** Është e paqartë se pse kjo pasuri është regjistruar nga ASHK-ja në emër të nënës së subjektit, për sa kohë kontrata është lidhur nga babai i subjektit dhe kjo pasuri duhej t'i nënshtrohej regjimit të trashëgimisë ligjore duke përfituar edhe vëllai dhe motrat e subjektit. Gjatë hetimit subjekti nuk ka depozituar dokumentacion që ka shërbyer për legalizimin e kësaj pasurie në emër të nënës së tij, pavarësisht se i është kërkuar nga Komisioni.

**153.** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.10.2021, ka sqaruar se *burimi i të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti nga babai i tij i ndjerë kanë qenë kursimet gjatë jetës së tij nga të ardhurat nga puna, të ardhurat nga toka bujqësore, nga pemëtaria, blegtoria, bletaria, si dhe një pjesë nga trashëgimia e lënë pas vdekjes nga familja e tij. Ky apartament kufizohet me mur të përbashkët me apartamentin e tij, pasi është në të njëjtin kat, por nuk është i lidhur me apartamentin e tij. Në këtë apartament kanë banuar vetëm prindërit e tij dhe aktualisht, pas vdekjes së babait të tij, banon nëna e tij. Aplikimin pranë UKT-së e ka bërë ai për shkak se nëna e tij, në atë kohë 79 vjeçe, nuk ishte në gjendje të mirë shëndetësore.*

**154.** Nga verifikimi i fotove të vëna në dispozicion nga subjekti, duket se apartamenti i subjektit dhe ai i blerë nga babai i tij janë të lidhura me njëra-tjetrën, pasi: (i) veranda e apartamentit të subjektit dhe ajo e apartamentit të blerë nga babai i tij nuk janë të ndara dhe janë vazhduese; (ii) në pjesën e sipërme të kuzhinës së apartamentit të babait të subjektit konstatohen pllaka xhami, të cilat janë të njëjta me pllakat e xhamit të banjës së subjektit.

Në kushtet kur nga hetimi duket se këto dy apartamente janë të lidhura me njëra-tjetrën, Komisioni ka kryer një analizë financiare për aftësinë e babait të subjektit për të blerë këtë pasuri, e pasqyruar në tabelën si vijon.

**Tabela nr. 8**

|   | <b>Datë 5.10.2007</b> |
|---|-----------------------|
| <b>Pasuria</b>                                | <b>15,557,600.00</b>  |
| Apartament                                    | 7,254,600.00          |
| <i>Ndryshim likuiditeti (shtesa/pakësime)</i> | <i>8,303,000.00</i>   |
| <b>Detyrime</b>                               | <b>0.00</b>           |
| <b>Të ardhura kumulative</b>                  | <b>1,312,827.93</b>   |
| H.B.Sh  | 301,454.56            |
| S.H.Sh  | 1,011,373.37          |
| <b>Shpenzime</b>                              | <b>-314,422.37</b>    |
| Shpenzime jetike                              | -314,422.37           |
| <b>Mundësi për kursime</b>                    | <b>-13,930,349.70</b> |

Nga analiza financiare duket se babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

**155.** Në përfundim, duke marrë në konsideratë faktin se:

- i. babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti;
- ii. subjekti ka kryer aplikim për hapjen e kontratës me UKT-në për këtë apartament (shihni pyetësorin datë 7.10.2021);
- iii. apartamenti është i lidhur me apartamentin e subjektit të rivlerësimit;
- iv. apartamenti është regjistruar në emër të nënës së subjektit, ndërkohë që duhej t'i nënshtrohej regjimit të trashëgimisë ligjore<sup>77</sup>;
- v. subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues për të provuar arsyet e ASHK-së për regjistrimin e kësaj pasurie në emër të znj. H.Sh, ndërkohë që kontrata e sipërmarrjes është lidhur me z. S.Sh dhe, rrjedhimisht, për t'u bërë kalimi i pasurisë duhej të depozitohet dëshmia e trashëgimisë;

<sup>77</sup> Sipas trashëgimisë ligjore, motrat dhe vëllai i subjektit.

- vi. konsiderohet e paqartë se pse në dokumentet e ASHK-së gjatë procesit të legalizimit kjo pasuri ka rezultuar si në posedim të subjektit;
- vii. subjekti nuk ka çelur ende trashëgiminë ligjore të babait të tij, duke u përjashtuar nga kjo pasuri trashëgimtarët e tjerë të tij,
  - duket se ky apartament është në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

**156.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti<sup>78</sup> shpjegoi se kjo pasuri është legalizuar sipas lejes së legalizimi nr. \*\*\*, datë 1.10.2020, me nr. pasurie \*\*\*, me sip. 56.5 m<sup>2</sup>, në emër të nënës së tij. Burimi i të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti kanë qenë kursimet gjatë jetës së tij nga të ardhurat nga puna, të ardhurat nga toka bujqësore, pemëtaria, blegtoria, bletaria, si dhe një pjesë nga trashëgimia e lënë pas vdekjes nga familja e tij. Sa i përket ngjashmërisë së tullave të xhamit në pjesë të ndryshme të apartamenteve, ndërtimet e mureve apo ndarjet e dhomave në të gjitha apartamentet e pallatit kryhen me të njëjtat materiale apo mënyrë standarde për të gjitha katet dhe të njëjtat tulla xhami janë përdorur edhe në apartamentet e fqinjëve të tjerë në pallat. Aplikimin për lidhjen e kontratës së furnizimit me ujë me UKT-në për këtë apartament e ka bërë në shërbim të nënës së tij. Apartamenti është regjistruar në emër të nënës së tij H. Sh pasi babai, me deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.12.2010, ka deklaruar që këtë apartament e ka porositur për bashkëshorten e tij (nëna e subjektit) dhe regjistrimi i këtij apartamenti pranë ZVRPP të bëhet vetëm në emër të saj. Drejtoria Vendore ASHK Tirana Veri, me shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 30.5.2022, referuar relacionit nr. \*\*\* prot., datë 30.5.2022, nga specialisti hartografik, sqaron se kur është kryer printimi i planimetrive të të gjithë apartamenteve të katit të pestë ka ndodhur një ngatërresë emrash dhe apartamentesh në të gjitha apartamentet e ndodhura në objekt dhe në këtë kat. Rrjedhimisht, në formatin *excel*, në të cilën janë dërguar të dhënat, këto gabime emrash nuk u ndryshuan. Drejtoria Vendore ASHK Tirana Veri ka marrë masat mbi korrigjimin e këtyre gabimeve në planimetritë e tjera, si dhe në planimetrinë e katit të pestë ku është korrigjuar emri i poseduesit në H.Sh, bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative, ku citohet se *organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme në një akt administrativ.*

**157.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e vënë në dispozicion nga subjekti, vlerëson se ai nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të tij në lidhje me këtë pasuri. Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin që: (i) ky apartament është në të njëjtin kat dhe i lidhur me apartamentin e subjektit si në verandë, ashtu edhe në sipërfaqe të tjera të tij, pavarësisht faktit se mund të jenë si pasuri të ndara; (ii) prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për këtë pasuri; (iii) ky apartament është vetëm në pronësi të nënës së subjektit, bazuar në deklaratën noteriale të babait të subjektit në vitin 2010; (iv) subjekti ka kryer procedurat për hapjen e kontratës me UKT-në; dhe (v) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti – vlerëson se ky apartament mund të jetë në pronësi të fshehur të subjektit.

Komisioni do t'i trajtojë konstatimet e mësipërme në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

**158.** Nga hetimi ka rezultuar se babai i subjektit ka depozituar në datën 22.8.2007 shumën 100.000 USD në “Raiffeisen Bank”, me emërtim “kursime gjatë jetës dhe trashëguar nga prindërit”.

**159.** Nga nxjerrja e llogarisë së babait të subjektit konstatohet se:

- shuma 100.000 USD ka qëndruar në depozitë me afat njëvjeçar dhe në datën 25.8.2008 është tërhequr shuma 54.483 USD, ndërsa shuma 50.000 është vendosur sërish në depozitë;
- në datën 21.11.2008 është tërhequr shuma 43.136 USD;
- në datën 4.3.2010 është tërhequr shuma 5.086 USD.

---

<sup>78</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022 dhe në seancë.



**160.** Në lidhje me këtë depozitë, subjekti<sup>79</sup>, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.10.2021, ka deklaruar se burimi i kësaj depozite ka qenë një marrëveshje e babait të tij me shtetasin Dh.T për shitjen e një sipërfaqeje toke në fshatin Shëngjin të Njësisë Administrative Shëngjergj.

**161.** Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit sepse është e paqartë se si shtetasi Dh.T i ka dhënë një shumë të konsiderueshme prej 100.000 USD babait të subjektit për një veprim në të ardhmen, pa një akt noterial.

**162.** Deklarata noteriale e shtetasit Dh.T është në nivel deklarativ dhe e pashoqëruar me dokumentacion provues. Kjo deklaratë nuk përputhet me deklaratimet e shtetasit S.Sh në “Raiffeisen Bank”, ku si burim janë deklaruar kursime gjatë jetës dhe trashëguar nga prindërit.

Nëse i referohemi deklaratës noteriale të shtetasit Dh.T, babai i subjektit nuk ka pasur asnjë pengesë për t’ia kthyer menjëherë këtë shumë, për sa kohë shuma 100.000 USD ka qenë në depozitë, e cila kishte përfunduar në datën 25.8.2008. Ndërkohë, babai i subjektit ka vijuar të mbajë në depozitë shumën 50.000 USD, duke e tërhequr në nëntor të vitit 2008. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë faktin se babai i subjekti në këtë vit ka blerë një apartament nga shoqëria e shtetasit Dh.T, ekzistonte mundësia për të shkëmbyer sipërfaqen e tokës me apartamentin, sikundër ndodh rëndom në marrëveshjet e lidhura midis ndërtuesve dhe pronarëve të truallit.

**163.** Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë faktin se babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kryerjen e kësaj depozite, të mungesës së dokumentacionit provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të tij, të dhënies në mënyrë të përsëritur nga të tretë, të shumave të konsiderueshme pa dokumentacion noterial për veprime në të ardhmen, duket se kjo shumë ka qenë në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

**164.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti<sup>80</sup>, përveç sa ka deklaruar gjatë hetimit, sqaroi se babai i tij nuk është person i lidhur për këtë pasuri/depozitë dhe nuk ka asnjë *indicie* që ta lidhë këtë shumë me të. Në këto kushte, kjo depozitë nuk duhet të ishte objekt verifikimi i Komisionit. Në këndvështrim të Kolegjit, një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera, pasuria e personave të tjerë të lidhur duhet të jetë objekt verifikimi, në kontekst të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesave. Për të provuar interesin e shtetasit Dh.T në atë periudhë për blerjen e disa pasurive tokë arë për interesat e tij personale për zhvillimin e bizneseve, ky shtetas, në vijimësi të deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.10.2021, ka bërë një deklaratë tjetër noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.5.2022, ku shprehet se këtë interes personal të tij e ka konkretizuar edhe me blerjen e disa sipërfaqeve të tjera toke në atë periudhë kohe në fshatin P, Njësia Administrative Xhafzotaj, Durrës. Deklarata noteriale e këtij shtetasi është e pashoqëruar me dokumentacion provues, pasi nuk u arrit të bëhej kontrata e shitjes së kësaj pasurie për shkak të pamundësisë në atë kohë për të regjistruar pronën në ZVRPP.

**165.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Interesat e përfituara nga depozita në shumën 100.000 USD janë pretenduar nga subjekti si burim për huan 4.000 euro të dhënë nga babai i tij, kjo ka qenë edhe arsyeja fillestare për hetimin e saj. Më pas, Komisioni, duke marrë në konsideratë se subjekti ka përfshirë pasuri të prindërve të tij më shumë se një herë në interes të tij, e ka zgjeruar hetimin dhe i ka kaluar subjektit barrën e provës për fshehje pasurie. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar dhe të momentit të përfshirjes së kësaj shume në bankë, duke u lidhur edhe me momentin e blerjes së apartamentit nga subjekti në të njëjtin pallat ku babai i tij kishte porositur një apartament, Komisioni dyshon se shuma 100.000 USD ka qenë në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit. Ky pretendim i Komisionit mbështetet në faktin se nëse hipotetikiisht familjarët e subjektit do të kishin krijuar të ardhura nga toka bujqësore, sipas aktekspertimit ato do të kishin të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të justifikuar shumën 100.000 USD. Ndërkohë, subjekti për këtë shumë ka deklaruar se ka pasur si burim një shitje të padokumentuar të një toke, që për më tepër, në bazë

<sup>79</sup> Subjekti ka depozituar deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 19.10.2021, të shtetasit Dh.T.

<sup>80</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022 dhe në seancë.

të deklarimeve të tij gjatë hetimit, por edhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka qenë në posedim të tij dhe jo të babait në vitin 2009. Deklarimet e subjektit në lidhje me të gjithë marrëdhënien e pretenduar të krijuar midis babait të tij dhe shtetasit Dh.T janë në nivel deklarativ dhe të pashoqëruara me dokumentacion provues. Dhënia e një shume prej 100.000 USD një personi tjetër, pa asnjë akt të shkruar, duke marrë në konsideratë edhe faktin e një shoqërie tregtare, është jashtë çdo logjike ekonomike dhe juridike, aq më tepër ku nga ana e shoqërisë kjo tokë bujqësore e pretenduar mund të shkëmbehet me apartamentin e porositur nga babai i subjektit. Në këto kushte, subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të shumës 100.000 USD dhe, rrjedhimisht, edhe interesat e përfutur nga kjo shumë do të konsiderohen si të ardhura jo të ligjshme, për rrjedhojë, nuk do të përfshihen në analizën financiare të babait të subjektit.

**166.** Në përfundim, Komisioni, duke marrë në konsideratë: (i) mungesën e burimeve të ligjshme të babait të subjektit për të justifikuar shumën 100.000 USD; (ii) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me burimin e kësaj shume; (iii) periudhën e depozitimit dhe tërheqjen e kësaj shume në bankë, e cila përkon me momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes së subjektit me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. për blerjen e apartamentit të tij; dhe (iv) përdorimin e interesave të kësaj shume si burim për huan e marrë nga subjekti nga babai i tij – vlerëson se kjo shumë mund të jetë në pronësi të fshehur të subjektit.

Komisioni do t’i trajtojë konstatimet e mësipërme në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

**167.** Subjekti ka deklaruar se i ka marrë hua babait të tij shumën 4.000 euro në vitin 2013. Komisioni ka kryer një analizë financiare për mundësinë e dhënies së kësaj huaje nga babai i subjektit, paraqitur në tabelën si vijon.

**Tabela nr. 9**

|   | <b>Mars 2013</b>   |
|---|--------------------|
| <b>Pasuritë</b>                               | <b>569,537.54</b>  |
| <i>Ndryshim likuiditeti (shtesa/pakësime)</i> | <i>569,537.54</i>  |
| <b>Të ardhura</b>                             | <b>103,054.05</b>  |
| Pagat e znj. H.Sh                             | 29,354.31          |
| Pagat e z. S.Sh                               | 73,699.75          |
| Të ardhura nga interesi i depozitave          | 0.00               |
| <b>Shpenzime jetike</b>                       | <b>70,512.00</b>   |
| <b>Mundësi kursimi</b>                        | <b>-536,995.49</b> |

Nga analiza financiare duket se babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e kësaj huaje.

**168.** Subjekti, në lidhje me të ardhurat e prindërve të tij<sup>81</sup>, përveç sa është trajtuar më lart, ka deklaruar dhe pretenduar se i ka kërkuar një auditues ligjor të përlllogarisë të ardhurat e tij si për blerjen e apartamentit, ashtu edhe për dhënien e shumës 4.000 euro hua. Në analizën financiare të audituesit ligjor për mundësinë e blerjes së këtij apartamenti dhe dhënies së huas në shumën 4.000 euro në mars të vitit 2013 dhe në vazhdim, ka marrë parasysh:

- i. kursimet familjare të babait gjatë gjithë jetës që kanë punuar me pagë shteti, megjithëse kanë jetuar në fshat, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore;
- ii. të ardhurat e znj. H.Sh nga pensioni i pleqërisë, duke filluar nga data 3.7.1994, sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2021, lëshuar nga DRSSH-ja Tiranë;
- iii. të ardhurat e z. S.Sh nga pensioni i pleqërisë për periudhën 7.9.1989 – 30.11.2016, bazuar në vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2021, lëshuar nga DRSSH-ja Tiranë;
- iv. të ardhurat bujqësore deri në vitin 2004 të përfuturara nga sipërfaqja e tokës 5240 m<sup>2</sup>, përfutur si familje bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991;

<sup>81</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022 dhe në seancë.

- v. të ardhurat e siguruara nga administrimi i ekonomisë blegtorale, pasi nga mbarështimi i gjësë së gjallë (dele dhe lopë), duke siguruar të ardhura të vazhdueshme nga shitja, bulmeti dhe gjësë së gjallë, qengja dhe viça (sipas aktekspertimit bashkëlidhur këtyre konkluzioneve);
- vi. të ardhurat nga pagat e motrave dhe pjesëtareve të tjerë të familjes;
- vii. në analizën financiare janë marrë në konsideratë kursimet e akumuluar nga viti në vit për periudhën deri në vitin 2013;
- viii. të ardhurat nga interesat bankare në vitin 2007, të cilat janë tërhequr në vitin 2010.

**169.** Komisioni, pasi analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit, për të mos rënë në përsëritje, në lidhje me të ardhurat e prindërve në analizën e shumës 4.000 euro, ka konsideruar vetëm pensionet e prindërve, të cilat nuk janë të mjaftueshme as për të mbuluar shpenzimet e tyre jetike dhe kjo ka qenë arsyeja që i është referuar vetëm vitit 2013. Në analizë nuk janë përfshirë të ardhurat nga blegtoria dhe bujqësia dhe interesat bankarë, pasi ato janë përfituar nga të ardhura për të cilat nuk u provua burimi i ligjshëm i tyre. Edhe sikur të merret në konsideratë analiza e bërë nga eksperti B.R, në faqen 19 të raportit të tij<sup>82</sup>, prindërit e subjektit, për të gjithë periudhën 2008 – 2013<sup>83</sup>, rezultojnë me një rezultat negativ në vlerën 1.042.207 lekë.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk provoi burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve për dhënien e shumës 4.000 euro.

**170.** Nga hetimi ka rezultuar se adresa e banimit të subjektit në gjendjen civile, por edhe në dokumentet e lëshuara nga institucione shtetërore, rezulton rruga “Q.G”, Njësia Administrative Nr. \*, Tiranë. Kjo adresë figuron si adresë banimi edhe për bashkëshorten dhe fëmijët e tij.

Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar si adresë banimi në Bankën Kombëtare Tregtare, në vitin 2009, Rrugën e Elbasanit, e cila përkon me adresën: rruga “Q.G”.

Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore në lidhje me adresat e banimit, subjekti ka deklaruar si më poshtë vijon:

- i. në vitet 2004 dhe 2006 rezulton se subjekti ka deklaruar si adresë banimi Njësia Administrative Nr. \*, njësi në të cilën bën pjesë edhe rruga “Q.G”;
- ii. në DPV/2005 subjekti deklaroi si adresë banimi rrugën “M.G”, e cila i përket Njesisë Administrative nr. \*;
- iii. në DPV/2007 ka qartësuar se adresa e vendbanimit është në Njësinë Administrative Nr. \*, ndërsa si vendqëndrim ka deklaruar banesën në K-K. Ky deklaram ka vijuar edhe në DPV-të vijuese deri në vitin 2013.

Në lidhje me këtë adresë, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.10.2021, ka mbajtur qëndrim mohues, duke deklaruar se nuk ka banuar asnjëherë në këtë adresë.

**171.** Komisioni, pasi konstatoi se subjekti mohoi faktin e banimit në këtë adresë, ka kryer një hetim të thelluar, nga ku ka rezultuar se:

- i. Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Nr. \*<sup>84</sup>, ka informuar se nga verifikimi i kryer në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 rezulton se shtetasi Arben Sharra, me adresë banimi rruga “Q.G” është vendosur pranë kësaj njësie me transkriptim nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Nr. \*, Tiranë, në datën 3.9.2004, nga regjistri themeltar i shtetasve, libri \*\*-fleta \*\*. Në datën 1.12.2020, me shkresën nr. \*\*\* prot., shtetasi Arben Sharra ka saktësuar adresën nga rruga “Q.G” në rrugën “F. R”, ndërtesa \*, hyrja \*.

Bashkëlidhur shkresës gjendet edhe fotokopje e regjistrit themeltar të shtetasve, sipas të cilit subjekti, së bashku me familjen e tij, rezultojnë me banim në rrugën “Q.G”.

<sup>82</sup> Duke mos përfshirë në këtë analizë të ardhurat nga toka bujqësore dhe blegtoria, si dhe interesat bankare.

<sup>83</sup> E cila është marrë për të mos rënduar pozitën e subjektit, pasi në vitin 2007 prindërit e tij blejnë apartamentin për të cilin nuk kishin të ardhura të mjaftueshme të ligjshme dhe rezultati negativ është shumë i madh.

<sup>84</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2022.

- ii. Njësia Bashkiake<sup>85</sup> Nr. \* ka informuar se referuar regj. \*\* shtetasi Arben Sharra është vendosur në këtë regjistër nga Zyra e Gjendjes Civile Vërrri, Tiranë, në shkurt të vitit 1995 dhe është larguar nga ky regjistër me transkriptim në Njësinë Bashkiake nr. \* regj., “Q. G” nr. \*\*\*, datë 17.5.2004.

Bashkëlidhur shkresës gjendet edhe fotokopje e regjistrimit themeltar të shtetasve, sipas së cilit familja e subjektit me transkript janë vendosur në Njësinë Administrative Nr. \*, në rrugën “Q. G”, \*\*\* në datën 17.5.2004.

Në përfundim të hetimit, duket se subjekti ka pasur një pasuri të paluajtshme në pronësi/posedim të tij në rrugën “Q.G”, për të cilën ka refuzuar të japë shpjegime, duke e fshehur atë.

**172.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi<sup>86</sup> se adresa e banimit në gjendjen civile, deri në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*, rezulton rruga “Q.G”, Njësia Administrative Nr. \*, Tiranë, por ai nuk ka banuar asnjëherë në këtë banesë.

Sipas konfirmimit të dhënë nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative, ai ka lëvizur në adresën e banimit nga Njësia Administrative Shëngjergj në Njësinë Administrative të Zyrës së Gjendjes Civile në shkurt të vitit 1996. Nuk e mban mend se çfarë dokumentacioni mund të ketë përdorur atëherë për regjistrimin në Gjendjen Civile Nr. \*. Këtë transferim e ka bërë në mënyrë që kur të lindnin fëmijët e tij të vendoseshin në këtë gjendje civile që edhe shkollimin e tyre më pas ta bënin po në këtë zonë, duke qenë se ishte zona më e zhvilluar e Tiranës. Kalimi i adresës së banimit nga Njësia Administrative Nr. \* në Njësinë Administrative Nr. \* është bërë vetë nga njësia, ndoshta për shkak të ndarjes territoriale të kryer në këtë kohë. Në vitin 2004, djali i tij E.Sh ka filluar shkollën fillore “F.N” në vitin shkollor 2003 - 2004 deri në vitin shkollor 2011 - 2012 dhe po në të njëjtën shkollë është regjistruar edhe vajza e tij E.Sh në klasën e parë, në vitin shkollor 2008 - 2009 deri në vitin shkollor 2012 - 2013.

**173.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga verifikimi i vetë deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore rezulton se ka deklaruar si adresë banimi Njësinë Administrative Nr. \*. Bashkëshortja e tij ka deklaruar pranë BKT-së si adresë Rrugën e Elbasanit, e cila është një adresë që përputhet me rrugën “Q. G”, pasi këto dy rrugë kryqëzohen me njëra-tjetrën.

Subjekti është përpjekur të fshehë këtë adresë në deklaratën *Vetting*, pasi tek seksioni “adresa e plotë ku jeni të regjistruar në gjendjen civile” subjekti ka deklaruar adresën aktuale të banimit për të cilën ka bërë ndryshimet përkatëse vetëm në vitin 2020.

Zyra e Gjendjes Civile ka konfirmuar faktin se subjekti si adresë banimi ka pasur rrugën “Q.G”.

**174.** Për sa më sipër rezulton e provuar se subjektit ka pasur një shtëpi banimi në Njësinë Administrative Nr. \*, por në lidhje me marrëdhënien e tij me këtë banesë, për shkak të mungesës së bashkëpunimit të subjektit, Komisioni e ka pasur të pamundur për të evidentuar nëse ka qenë në posedim/përdorim apo pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, në kuptim të nenit 33/5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, duke mos deklaruar në deklaratën *Vetting* adresën e banimit rrugën “Q.G”. Duke marrë në konsideratë edhe qëndrimin mohues të subjektit në lidhje me këtë adresë, të pashoqëruar me dokumentacion provues, Komisioni vlerëson se subjekti është përpjekur të fshehë marrëdhënien me këtë pasuri, në kuptim të nenit D/5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 33/5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

### **175. Në lidhje me analizën financiare<sup>87</sup>**

Komisioni, në përfundim të hetimit, ka kryer një analizë financiare në lidhje me subjektin e rivlerësimit, nga ku ka rezultuar se:

<sup>85</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.3.2022.

<sup>86</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimit dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022 dhe në seancë.

<sup>87</sup> Për më shumë detaje referohuni rezultateve të hetimit.

Subjekti, prej fillimit të detyrës deri në deklaratën *Vetting*, është në pamundësi kumulative financiare në vlerën 3.184.168,95 lekë.

- i. Subjekti është në pamundësi kumulative financiare para vitit 2003 në vlerën 4.547.869,40 lekë.

Në total, subjekti rezulton me vlerë negative 7.732.038,35 lekë.

**176.** Pavarësisht se nga ana e subjektit nuk ka pasur shpjegime në lidhje me këtë rezultat negativ, Komisioni, duke marrë në konsideratë prapësimet dhe provat e paraqitura prej tij, si dhe duke pranuar një pjesë prej tyre, e ka reduktuar këtë rezultat negativ të subjektit, si më poshtë vijon:

1. të ardhurat nga pagat e subjektit, të cilat nga marsi i vitit 2005 deri në deklaratën *Vetting* janë nxjerrë nga *statement*-i bankar i llogarisë së pagës pranë “Raiffeisen Bank”;
2. të ardhurat nga pagat e bashkëshortes së subjektit, referuar vërtetimeve dhe nxjerrjeve të llogarive bankare të pagës pranë “Tirana Bank” dhe BKT-së.

Në përfundim:

i. Subjekti, prej fillimit të detyrës deri në deklaratën *Vetting*, është në pamundësi kumulative financiare në vlerën 3.100.202,95 lekë.

ii. Subjekti është në pamundësi kumulative financiare para vitit 2003 në vlerën 4.273.611,685 lekë.

Në total, subjekti rezulton me vlerë negative 7.373.814,637 lekë.

**177.** Komisioni vlerëson të ndalet në lidhje me pasuritë e regjistruara, të paktën formalisht, në pronësi të prindërve të subjektit, për të cilat nga hetimi rezultoi se:

- i. Prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të justifikuar krijimin e tyre.
- ii. Këto pasuri janë përdorur nga subjekti ose personi i lidhur me të.
- iii. Banesa në fshat është në të njëjtën sipërfaqe ku ndodhet toka bujqërore e subjektit dhe është rikonstruktuar me të ardhurat e përfituar nga shitja e banesës në pronësi të subjektit në K-K, si dhe subjekti ka refuzuar të vendosë në dispozicion të Komisionit foto panoramike të të gjithë pasurisë ku të dilnin qartë të gjithë ndërtime nga jashtë dhe pozicionimi i tyre me rrugën.
- iv. Subjekti, në lidhje me llogarinë bankare në shumën 100.000 USD, pretendon se interesat e përfituar kanë shërbyer si burim për dhënien e huas nga babai i tij në shumën 4.000 euro.
- v. Automjeti tip “Volkswagen” është blerë nga nëna e subjektit me të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës së subjektit në K-K.
- vi. Apartamenti i prindërve të subjektit ndodhet në të njëjtin kat dhe është i lidhur me apartamentin e subjektit.

Bazuar në konstatimet e mësipërme rezulton se subjekti ka tentuar të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë këto pasuri, duke deklaruar të dhëna të pasakta ose duke mos i deklaruar fare, me qëllim që procesi i kontrollit dhe verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit. Për sa më sipër, Komisioni krijon bindjen se këto pasuri janë në pronësi/posedim të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

### **Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

**178.** Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludon se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në deklaratën e pasurisë *Vetting*, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

- iii. Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, sipas parashikimeve të pikës 5 të Aneksit D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- iv. Subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurive në pronësi/posedim/përdorim, në kuptim të Aneksit D/5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

**179.** Në këto rrethana, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat, sipas pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

## **B. KONTROLI I FIGURËS**

**180.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja ka dërguar një raport, përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.5.2021, të KDZH-së. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

**Si konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Sharra.**

**181.** Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar<sup>88</sup> në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Sharra, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**182.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

**Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe analiza e Komisionit**

**183. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur:

1. konkluzione përfundimtare për çështjen penale nr. \*\* të vitit 2014;
2. konkluzione përfundimtare për çështjen penale nr. \*\* të vitit 2014;
3. konkluzione përfundimtare për çështjen penale nr. \*\* të vitit 2014.

Në lidhje me tri aktet konstatohen këto gjetje:

---

<sup>88</sup> Për hetimin e kryer nga Komisioni shih dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit.

## **1. Konkluzione përfundimtare për çështjen penale nr. \*\* të vitit 2014, në ngarkim të të pandehurve A.B dhe K.G, akuzuar për veprën penale “heqje e paligjshme e lirisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal**

Nga analizimi i aktit duket se:

- i. subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për të zbuluar personat e tjerë të përfshirë në kryerjen e veprës penale, të cilëve subjekti iu referohet me emërtimin tri persona të tjerë të paidentifikuar të cilët, për më tepër, kanë kërcënuar me armë viktimën;
- ii. është e paqartë se cilat kanë qenë arsyet që nuk është kryer hetimi dhe nuk është marrë si i pandehur shtetasi me emrin T;
- iii. subjekti nuk ka analizuar dhe nuk është shprehur për veprën penale të vetëgjyqësisë, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal;
- iv. subjekti nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale “heqje e paligjshme e lirisë”.

Për rrjedhojë, duket se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore në lidhje me këtë procedim.

Në përfundim, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të shpjeguar dhe depozituar dokumentacionin përkatës lidhur me veprimtarinë procedurale të ndjekur prej tij në dosjen objekt procedimi, së bashku me vendimet e gjykatave.

Pas kalimit të barrës së provës subjekti<sup>89</sup> ka dhënë sqarime të hollësishme në lidhje me veprimtarinë hetimore të kryer prej tij, si dhe ka paraqitur dokumentacion provues, nëpërmjet së cilit provohet se subjekti ka vepruar në përputhje me Kodin e Procedurës Penale. Nga verifikimi i fashikullit penal konstatohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, mbi bazën e materialeve të dërguara nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, për shkak të moskompetencës lëndore, në datën 19.11.2013 ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, për veprat penale “heqje e paligjshme e lirisë” dhe “vetëgjyqësi”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 110/2 e 277-25 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A.B. Në datën 20.1.2014, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur shpalljen e moskompetencës për procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2013 dhe kalimin e akteve të këtij procedimi Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me urdhrin e datës 10.2.2014, mbi bazën e akteve të dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, për veprat penale “heqje e paligjshme e lirisë” dhe “vetëgjyqësi”, parashikuar nga nenet 110/2 e 277-25 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A.B. Sipas akteve që ndodhen në fashikullin e procedimit penal nr. \*\*\*, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin e datës 24.7.2014, ka vendosur të ndajë nga procedimi penal nr. \*\*\* aktet e nevojshme për veprën penale “heqje e paligjshme e lirisë”, parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal, duke zhvilluar hetim në një procedim të ri me nr. \*\*\*, i cili do të regjistrohet në regjistrin e veprave penale pa autor të njohur. Nga aktet e fashikullit të procedimit penal nr. \*\*\* rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin për pushimin e pjesshëm të hetimeve të datës 29.7.2014, ka vendosur pushimin e pjesshëm të procedimit penal nr. \*\*\* për veprën penale “vetëgjyqësi”, parashikuar nga nenet 277-25 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A.B, pasi kjo vepër penale është amnistuar. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin e datës 31.7.2014, ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. \*\*\* në ngarkim të të pandehurve A.B dhe K.G për veprën penale “heqje e paligjshme e lirisë”, parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal, duke ia dërguar aktet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.12.2014, ka dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës kopjen e fashikullit të procedimit penal nr. \*\*\* në ngarkim të të pandehurve A.B dhe K.G për veprën penale “heqje e paligjshme e lirisë”, parashikuar nga neni 110/2 të Kodit Penal, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.12.2014, ka shpallur moskompetencën tokësore për këtë procedim. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, i ka paraqitur gjykatës konkluzionet përfundimtare për deklarimin fajtor të të pandehurve

<sup>89</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022.

A.B dhe K.G. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka dërguar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës aktet e procedimit penal nr. \*\*\* në ngarkim të të pandehurit A.Z, akuzuar për kryerjen e veprës penale “heqje e paligjshme e lirisë”, parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal, akte të cilat i ishin dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.4.2017. Nga aktet e procedimit penal nr. \*\*\* rezulton se me vendimin për ndarjen e procedimit penal të datës 29.12.2015 është vendosur ndarja e çështjes, duke veçuar aktet nga procedimi penal nr. \*\*\* në ngarkim të të pandehurit A.Z dhe numërtimin e kësaj çështjeje, duke e regjistruar në regjistrin e çështjeve penale me nr. \*\*, për veprën penale “heqje e paligjshme e lirisë”, parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin e datës 30.12.2015, ka vendosur pezullimin e hetimeve për procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2015 dhe dërgimin e akteve Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës për ndjekje të mëtejshme deri në zbulimin e autorëve.

## **2. Konkluzione përfundimtare për çështjen penale nr. \*\*\* të vitit 2014, në ngarkim të të pandehurit A.Z, akuzuar për veprën penale “vjedhje me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal dhe të të pandehurit A.Z, akuzuar për veprën penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal**

Nga analizimi i aktit duket se subjekti:

- i. nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për të zbuluar personin e tretë të përfshirë në kryerjen e veprës penale;
- ii. nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale “vjedhje me dhunë”;
- iii. nuk ka argumentuar bazuar në prova se shtetasi A.Z ka kryer veprën penale të “moskallëzim krimi”;
- iv. nuk ka kryer asnjë veprim hetimor në lidhje me armën me të cilën është goditur viktima;
- v. nuk e ka kualifikuar saktë veprën penale të kryer nga i pandehuri A.Z, pasi për sa kohë është përdorur armë ajo duhej të kualifikohej si vjedhje me armë, parashikuar nga neni 140 i Kodi Penal;
- vi. nuk e ka marrë si të pandehur shtetasin A.Z për veprën penale “armëmbajtje pa leje”.

Në përfundim, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të shpjeguar dhe depozituar dokumentacionin përkatës lidhur me veprimtarinë procedurale të ndjekur prej tij në dosjen objekt procedimi, së bashku me vendimet e gjykatave.

Pas kalimit të barrës së provës subjektit<sup>90</sup> ka dhënë sqarime të hollësishme në lidhje me veprimtarinë hetimore të kryer prej tij, si dhe ka paraqitur dokumentacion provues nëpërmjet së cilit provohet se subjekti ka vepruar në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

## **3. Konkluzione përfundimtare për çështjen penale nr. \*\*\* të vitit 2014, në ngarkim të të pandehurve A.T, A.L, R.B dhe R.Gj, akuzuar për veprat penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga nenet 283/2 e 278/2/3 të Kodit Penal.**

Nga analizimi i aktit duket se:

- i. subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për të zbuluar personat të cilëve do t’ju shitej lënda narkotike ku, sipas deklarimeve të të pandehurit A.T, ishin të paktën dy;
- ii. subjekti nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale;
- iii. është e paqartë se cilat kanë qenë arsyet që subjekti nuk ka marrë si të pandehur shtetasin L.T.

Për rrjedhojë, duket se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore në lidhje me këtë procedim.

Në përfundim, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të shpjeguar dhe depozituar dokumentacionin përkatës lidhur me veprimtarinë procedurale të ndjekur prej tij në dosjen objekt procedimi, së bashku me vendimet e gjykatave.

<sup>90</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022.



Pas kalimit të barrës së provës subjekti<sup>91</sup> ka dhënë sqarime të hollësishme në lidhje me veprimtarinë hetimore të kryer prej tij, si dhe ka paraqitur dokumentacion provues, nëpërmjet së cilit provohet se subjekti ka vepruar në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

#### **184. Analiza e pesë dosjeve penale të përzgjedhura me short**

Në vlerësim të këtyre dosjeve penale, Komisioni ka konstatuar problematika vetëm në lidhje me tri prej tyre.

**Dosja 1** – kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë regjistrimi 31.7.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

Objekti i shortit: dokumenti ligjor – vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 10.9.2015, për kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 31.7.2015, për veprën penale “dëmtime të tjera me dashje”, të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal.

Dokumentu ligjor “vendim mosfillimi” është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese dhe dispozitivi.

Subjekti i rivlerësimit paraqet analizën e provave. Në akt përshkruhen provat e administruara, burimet e tyre dhe çmuarja e fuqisë së tyre provuese. Parashtrrohet vlerësimi për faktin penal të referuar. Prokurori konkludon se në rastin konkret ka shkaqe ligjore që nuk lejojnë fillimin e ndjekjes penale.

Fjalitë paraqiten të qarta dhe përmbajnë referenca ligjore. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri dhe teksti paraqitet i kuptueshëm.

Në përfundim, konstatohet se:

- i. Vendimi i mosfillimit të procedimit penal është marrë jashtë afatit 30-ditor i parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, ‘Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale’, i ndryshuar”, i Prokurorit të Përgjithshëm.
- ii. Vendimi i mosfillimit të procedimit penal rezulton se nuk u është njoftuar subjekteve të interesuara sipas afateve të parashikuar në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, pasi u është njoftuar në datën 1.10.2015, gati më shumë se një muaj me vonësë.

Subjektit i është kërkuar të japë shpjegime në lidhje me këto konstatime.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka parashtruar se<sup>92</sup> materiali i kallëzimit penal nr. \*\*\*, datë 31.7.2015 është marrë prej tij në datën 2.9.2015, fakt i cili pasqyrohet qartë në formularin për trajtimin e materialit kallëzues që ndodhet në faqen nr. \* të fashikullit të kallëzimit nr. \*\*\*, pasi periudha 1.8 – 31.8.2015 është periudha e lejeve vjetore. Pas marrjes dhe trajtimit të këtij materiali kallëzues me vendimin e datës 10.9.2015 është vendosur mosfillimi si procedim i kallëzimit nr. \*\*\*, ku rezulton se vendimi është marrë në një kohë shumë të shpejtë, pra rreth 8 (tetë) ditë pas marrjes së materialit. Nga sa më sipër rezulton se vendimi është marrë brenda afatit ligjor të përcaktuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, ‘Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale’”. Koha pas marrjes së vendimit është procedura administrative që ndiqet brenda institucionit me lidhjen e akteve të fashikullit nga sekretaria, kalimi tek drejtuesi dhe më pas në kryesekretari për dërgimin e njoftimeve.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato justifikojnë veprimet e tij, për rrjedhojë, konstatimet e mësipërme nuk mund të klasifikohen si mangësi profesionale.

**Dosja 2** – kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë regjistrimi 23.2.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

<sup>91</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022.

<sup>92</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe propvat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022.

Objekti i shortit: dokumenti ligjor – vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 21.4.2015, për kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 23.2.2015, për veprën penale “punësim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal.

Dokumenti ligjor “vendim” është i strukturuar dhe i ndarë në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese - arsyetuese dhe dispozitivi.

Subjekti pasqyron faktin penal dhe provat e administruara në funksion të hetimit të çështjes. Në akt përshkruhen provat e administruara, burimet e tyre dhe çmuarja e fuqisë së tyre provuese. Subjekti i kushton më shumë rëndësi paraqitjes së hollësishme të provave duke cituar deklaratimet e personave të pyetur dhe përmbajtjen e akteve të administruara në fashikull, duke vështirësuar kuptimin e rrethanave të faktit. Nga ana e tij nuk analizohen elementet e figurës penale.

Kundërshtimi i pretendimeve të shfaqura nga kallëzuesi kryhet duke iu referuar provave në fashikull. Subjekti parashtron disponimin e tij, me arsyetimin se nuk rezulton që Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës të ketë marrë më parë masë administrative ndaj këtij subjekti, çka bën që mos të përmbushen kriteret e parashikuara nga neni 170/ a i Kodit Penal.

Ndërkohë, ky arsyetimi i subjektit nuk përputhet me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, ku sipas së cilës ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me administrator E.Sh, janë dhënë masa administrative për punëmarrës të padeklaruar. Bashkëlidhur shkresës është njoftimi i vlerësimit të detyrimit, sipas së cilës kjo shoqëri është gjobitur dy herë në shumën totale prej 1.100.000 lekësh. Subjekti duhej të kishte vijuar hetimet në lidhje me këtë procedim, pasi rezulton se për punëdhënësin ishin dhënë më parë masa administrative nga organet tatimore.

Për sa më sipër, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit:

- i. Subjekti nuk ka verifikuar deklaratimin e kallëzuesit në lidhje me punonjësit e padeklaruar të shoqërisë, administrator i të cilës ishte shtetasi E.Sh.
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar vendimin e mosfillimit, pasi nga aktet në dosje rezulton se punëdhënësi kishte marrë më parë masa administrative nga organet tatimore.
- iii. Subjekti nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale.
- iv. Në vendim nuk pasqyrohen qartësisht rrethanat e faktit penal.
- v. Vendimi i mosfillimit të procedimit penal rezulton se nuk i është njoftuar subjekteve të interesuara sipas afateve të parashikuara në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, pasi i është njoftuar në datën 26.5.2015, gati më shumë se një muaj me vonesë.

Pas kalimit të barrë së provës<sup>93</sup> subjekti listoi të gjitha veprimet hetimore të ndërmarra prej tij, duke dhënë edhe argumentet përkatëse.

Komisioni, pasi analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit nga ana e tij dhe themelin e çështjes, për rrjedhojë, këto shpjegime do të konsiderohen bindëse. Ndërkohë, subjekti nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale, si dhe nuk pasqyrohen qartësisht rrethanat e faktit penal. Komisioni vlerëson se këto mangësi nuk janë të një shkalle që mund të ndikojnë në vlerësimin nën minimal të subjektit të rivlerësimit.

**Dosja 3** – procedimi penal nr. \*\*\*, regjistruar në datën 27.1.2016, për veprën penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Objekti i shortit: dokumenti ligjor – vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2016”, datë 3.10.2016, hartuar nga subjekti i rivlerësimit.

---

<sup>93</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022.

Dokumenti ligjor “vendim” është i strukturuar dhe i ndarë në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese - arsyetuese dhe dispozitivi.

Në akt pasqyrohen rrethanat e fakti penal, mënyra si është marrë djehni për të, veprimet hetimore të kryera nga policia dhe provat që kanë rezultuar prej tyre. Parashtrahet vlerësimi i subjektit mbi faktin penal të pretenduar. Në vendim argumentohet se përderisa sipas aktit të ekspertimit mjeko-ligjor nr. \*\*\*, datë 9.5.2016, sasia e lëndës së mësipërme konsiderohet sasi (dozë) për përdorim vetjak të menjëhershëm për këtë shtetas dhe sipas aktit mjeko-ligjor nr.\*\*\*, datë 19.9.2016, me grup ekspertësh nga literatura, njihen raste kur një person me cilësitë fizike-klinike si të shtetasit S.H mund ta përdorë në mënyrë të menjëhershme pa shkaktuar dëmtim të rëndë të shëndetit tij, rezulton se ky shtetas nuk ka konsumuar elementet e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Në vendim subjekti shprehet se: *“Sipas aktit të ekspertimit kimik nr. \*\*\*, datë 4.4.2016, të Institutit të Policisë Shkencore Tiranë, ardhur në prokurori në datën 11.4.2016, rezulton se materialet objekt ekspertimi (tre paketime) janë numërtuar nga ekspertët me nr. 1, 2, 3 dhe nga analiza me GC/MS për pluhurin e numërtuar me numrin 1, objekt ekspertimi, tregoi për praninë e paracetamolit dhe kafeinës dhe pesha pa ambalazh e këtij materiali është 41.266 gr.*

*Nga analiza me GC/MS për pluhurat e numërtuara me numrat 2 dhe 3, objekt ekspertimi, tregoi për praninë e heroinës. Peshë pa ambalazh e materialit të numërtuar me nr. 2 është 0,848 gr. dhe peshë pa ambalazh e materialit të numërtuar me nr. 3 është 0,750 gr.”.*

Për sa më sipër, subjektit i kaloi barra e provës, si më poshtë vijon:

- Në lidhje me sasinë 41,266 gram (paracetamol dhe kafeinë), subjekti i rivlerësimit duhet të kishte kryer hetime më të plota, në këndvështrim të nenit 285 të Kodit Penal, pasi duket se kjo lëndë mund të shërbente si përzierje për lëndën narkotike heroinë.

Pas kalimit të barrës së provës subjekti<sup>94</sup> ka dhënë sqarime të hollësishme në lidhje me veprimtarinë hetimore të kryer nga prej tij, nëpërmjet së cilit provohet se subjekti ka vepruar në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

## **TË DHËNAT ARKIVORE (ankesat dhe masat disiplinore)**

**185.** Referuar të dhënave arkivore pranë sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme për prokurorin subjekt rivlerësimi Arben Sharra, rezulton se ndaj këtij subjekti nuk ka masa disiplinore.

Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave në sektorin e protokollit - arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit kalimtar Arben Sharra, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2020, janë paraqitur dy ankesa:

- praktika nr. \*\*\* e vitit 2017, ankesë e shtetasit A.I;
- praktika nr. \*\*\* e vitit 2018, ankesë e shtetasit E.T.

Nga praktikat bashkëlidhur konstatohet se:

1. Shtetasi italian A.I i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me një ankesë ndaj prokurorit Arben Sharra, e cila është administruar në sektorin e marrëdhënieve me publikun me nr. \*\*\*, datë 2.5.2017.

Në ankesën e tij ky shtetas ka shpjeguar se prokurori i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës Arben Sharra e ka pushuar çështjen me vendimin datë 3.12.2016, me arsyetimin se “është plagosje e lehtë”. Gjithashtu e ka nxjerrë edhe fajtor për aksidentin, në kundërshtim me të vërtetën. Eksperti mjeko-ligjor dhe eksperti auto-teknik kanë deklaruar tërësisht konkluzione të pavërteta, për të shpëtuar shkaktarin e aksidentit nga përgjegjësia. Dëshmitari në ngjarje ka deklaruar se ka qenë një fuoristradë e bardhë që ka shkaktuar aksidentin, kurse prokuroria ka këqyruar një Benz gri. Pra, nga ana e prokurorit janë kryer shkelje në hetimin e çështjes.

<sup>94</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022.

Shtetasi A.I ka bërë ankim kundër vendimit të pushimit dhe çështja është duke u gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Është në gjendje shumë të rëndë dhe në vështirësi shumë të madhe ekonomike. Kërkon të merren masa për ta ndihmuar sipas ligjit, që të ndëshkohet fajtori dhe ai të marrë të drejtën e tij për këtë dëm të madh që i është shkaktuar.

Nga verifikimi i denoncimit duket se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme. Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte dhe të depozitonte dokumentacionin përkatës (kopje të fashikullit penale) lidhur me veprimtarinë procedurale të ndjekur prej tij në dosjen objekt procedimi, prej regjistrimit të kallëzimit dhe deri në vendimmarrjen përkatëse, ku përfshihet edhe vendimi i gjykatave në lidhje me këtë procedim.

Pas kalimit të barrë së provës<sup>95</sup> subjekti listoi të gjitha veprimet hetimore të ndërmarra prej tij, duke dhënë dhe argumentet përkatëse.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore, ku përfshihet riekspertimi teknik dhe ai mjeko-ligjor. Këto mangësi në hetim kanë qenë objekt gjykimi edhe nga gjykata e cila ka vendosur kthimin e akteve dhe vijimin e hetimit. Vetëm pas këtij vendimi subjekti ka plotësuar kryerjen e veprimeve hetimore. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, sipas përcaktimeve të nenit 73/2 të ligjit nr. 96/2016.

2. Shtetasi E.T i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me një ankesë, e cila është administruar në sektorin e marrëdhënieve me publikun me nr. \*\*\* datë, 16.1.2018.

Në ankesën e tij ky shtetas ka shpjeguar se ka paraqitur një kërkesë pranë drejtueses së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për zëvendësimin e prokurorit Arben Sharra, për faktin se ka depozituar një kallëzim penal kundër shtetasit A.B për pengim të ekzekutimit të vendimit nr. \*\*\*, datë 25.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (vendim me ekzekutim të përkohshëm) dhe të vendimit nr. \*\*\*, datë 6.3.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës për mospagim page për punën që ka kryer në kompaninë ku ai është administrator i pronave, ku për këtë kallëzim prokurori Arben Sharra ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

Nga verifikimi i denoncimit duket se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme. Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte dhe të depozitonte dokumentacionin përkatës (kopje të fashikullit penale) lidhur me veprimtarinë procedurale të ndjekur prej tij në dosjen objekt procedimi, prej regjistrimit të kallëzimit dhe deri në vendimmarrjen përkatëse, ku përfshihet edhe vendimi i gjykatave në lidhje me këtë procedim.

Pas kalimit të barrë së provës<sup>96</sup> subjekti listoi të gjitha veprimet hetimore të ndërmarra prej tij, duke dhënë edhe argumentet përkatëse.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se nga ana e tij nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore. Këto mangësi në hetim kanë qenë objekt gjykim edhe nga gjykata, e cila ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të subjektit dhe vijimin e hetimit. Vetëm pas këtij vendimi subjekti ka plotësuar kryerjen e veprimeve hetimore. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, sipas përcaktimeve të nenit 73/2 të ligjit nr. 96/2016.

**186.** Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave të prokurorive të rretheve gjyqësore dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda, ka rezultuar se me shkresën nr. \*\*\*, datë 26.2.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë dërguar:

1. kallëzimi penal nr. \*\*\* i vitit 2019, mosfilluar në datën 23.4.2019;
2. kallëzimi penal nr. \*\*\* i vitit 2020, mosfilluar në datën 1.2.2021.

Në përfundim, për të dy këto kallëzime është vendosur mosfillimi i procedimit penal, bazuar në nenin 290, pika 1, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale.

<sup>95</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022.

<sup>96</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022.

**187.** Për subjektin Arben Sharra nuk ka të dhëna apo informacione për cenim të figurës së subjektit të rivlerësimit, që ai të jetë përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, si dhe të dhëna për raste të identifikimit të subjektit të rivlerësimit për kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtar të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale), ku përfshihen edhe biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike.

## **188. Denoncime**

Komisioni ka administruar 5 denoncime<sup>97</sup> nga publiku për subjektin Arben Sharra. Subjektit iu kalua barra e provës për dy prej tyre, si më poshtë vijon:

### **1. Denoncim i shtetasit E.M<sup>98</sup>**

Denoncuesi pretendon se një mikeshë e familjes së subjektit e ka denoncuar për ndërtim pa leje dhe subjekti i ka kërkuar para që të mbyllë hetimi. Denoncuesi deklaroi se nuk ka asnjë provë apo regjistrim audio.

Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte dhe të depozitonte dokumentacionin përkatës (kopje të fashikullit penal) lidhur me veprimtarinë procedurale të ndjekur prej tij në dosjen objekt procedimi, prej regjistrimit të kallëzimit dhe deri në vendimmarrjen përkatëse, ku përfshihet edhe vendimi i gjykatave në lidhje me këtë procedim.

Pas kalimit të barrës së provës<sup>99</sup> subjekti listoi të gjitha veprimet hetimore të ndërmarra prej tij, duke dhënë edhe argumentet përkatës.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, pavarësisht se mund të ketë elemente për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, vlerëson se nuk mund të vijojë më me shqyrtimin e këtij denoncimi, pasi është çështje ende nën hetim.

### **2. Denoncim i shtetasit G.Z<sup>100</sup>**

Denoncuesi pretendon se subjekti nuk ka vepruar drejt duke vendosur mosfillimin e procedimit për një kallëzim penal të bërë prej tij, pa kryer veprimet hetimore të nevojshme. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar rezulton se vendimi i mosfillimit të subjektit është prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, duke u kthyer aktet për hetim të mëtejshëm. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit.

Në përfundim duket se subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore në lidhje me kallëzimin penal nr. \*\*\*, duke iu kërkuar të japë shpjegime.

Pas kalimit të barrës së provës<sup>101</sup> subjekti listoi të gjitha veprimet hetimore të ndërmarra prej tij, duke dhënë edhe argumentet përkatëse.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se prej tij nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore. Këto mangësi në hetim kanë qenë objekt gjykimi edhe nga gjykata, e cila ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të subjektit dhe vijimin e hetimit. Vetëm pas këtij vendimi subjekti ka plotësuar kryerjen e veprimeve hetimore. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, sipas përcaktimeve të nenit 73/2 të ligjit nr. 96/2016.

## **Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional**

**189.** Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, dosjeve të administruara nga Komisioni dhe denoncimeve të depozituara, trupi gjykues konstaton se në tri procedime subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore, të cilat janë plotësuar pas kthimit të çështjes nga gjykata, që tregojnë

---

<sup>97</sup> Dy denoncime kanë ardhur pas dërgimit të rezultateve të hetimit, të cilat nuk janë shqyrtuar nga Komisioni, pasi një denoncim ishte kryer sërish nga shtetasi E.M, kurse në denoncimi tjetër pretendohet se subjekti kishte pasuri të fshehura në emër të prindërve të tij, të cilat janë trajtuar gjerësisht në vendim.

<sup>98</sup> Denoncim nr. \*\*\*, datë 27.7.2021.

<sup>99</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022.

<sup>100</sup> Denoncim nr. \*\*\*, datë 19.3.2018.

<sup>101</sup> Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti në datën 13.6.2022.

mungesë të aftësive profesionale të subjektit. Shkeljet e konstatuara në kriterin e aftësive profesionale nuk janë të tilla që mjaftojnë për të kualifikuar subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

### **Në lidhje me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë**

**190.** Në vlerësimin tërësor të procedurave lidhur me cenimin e besimit të publikut, duke vlerësuar në tërësi kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuar së bashku e të para në harmoni me njëra-tjetrën, tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën, e cila do të ishte e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit, si një funksionar i denjë i këtij sistemi.

**191.** Në këto rrethana, përfshihet problematika e konstatuar në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë, në lidhje me: (i) qëndrimin jobashkëpunues të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016; (ii) mospagimin e shumës 13.127 euro për shkak të bllokimit të llogarisë bankare të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.; (iii) marrëdhënien e tij me tokën bujqësore dhe banesën e prindërve të tij në Njësinë Administrative Shëngjergj; (iv) shitjen e produkteve bujqësore nga ana e tij në treg; si dhe (v) posedimin pa asnjë akt ligjor të një toke bujqësore në pronësi të shtetit, për të cilën subjekti nuk ka bërë as deklarinimin përkatës në deklaratën *Vetting*. Në këtë vlerësim të Komisionit mbahet në konsideratë sjellja e subjektit në lidhje me pasuritë e regjistruara formalisht në pronësi të prindërve të tij, për të cilat nga hetimi rezultoi se subjekti ka tentuar t’i fshehtë ose t’i paraqesë në mënyrë të pasaktë këto pasuri, duke deklaruar të dhëna të pasakta ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të tij dhe, për pasojë, Komisioni ngriti dyshime se këto pasuri mund të jenë në pronësi/posedim të fshehur të subjektit të rivlerësimit, por për shkak se nuk u provua plotësisht ky dyshim i Komisionit, ato do të konsiderohen në tërësi të rivlerësimit të subjektit.

**192.** Në vlerësimin e Komisionit, këto rrethana të cituara më lart do të përbënin mjaftueshëm një bazë të dhënash, mbi të cilën mund të konkludohej se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, edhe sikur të mos ekzistonin rrethanat që kanë bërë të mundur aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke bërë të zbatueshëm në mënyrë autonome paragrafin 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve, konkludon se:

- i. Subjekti ka bërë deklarinim të pamjaftueshëm për kontrollin pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Sharra, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.  
U shpall në Tiranë, në datën 30.6.2022.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**LULZIM HAMITAJ**

**Kryesues**

**SUELA ZHEGU**

**Anëtare**

**GENTA Tafa (BUNGO)**

**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*

*Etmonda Hoxha*